

INSTITUTI KOSOVAR PËR KËRKIME DHE ZHVILLIME TË POLITIKAVE

Seria e kërkimeve politike

STUDIMI # 7

QEVERISJA DHE KONKURRENCA NË ARSIM TË LARTË

Prishtinë, mars 2007

KIPRED

The logo for KIPRED features the word "KIPRED" in a bold, blue, sans-serif font. To the right of the text is a stylized yellow graphic consisting of a curved line that forms a partial circle, with a small yellow dot at its end, resembling a comet or a dynamic element.

QEVERISJA DHE KONKURRENCA NË ARSIM TË LARTË

Prishtinë, mars 2007



Ky projekt është përkrahur nga Rockefeller Brothers Fund.

Mendimet e shprehura në këtë studim janë të autorit dhe jo domosdo të Rockefeller Brothers Fund.

Përgatitur nga Leon Malazogu me kontribute të Ilir Dugollit, Olga Baturës, si dhe me ndihmën e Besnike Jakës, Valmir Ismailit, Shaneel Sharma, Margarita Brovinës dhe Florie Xhemajlit. Përgatiti për shtyp Albert Krasniqi.

Copyright © 2007 KIPRED. Të gjitha të drejtat e riprodhimit janë të rezervuara. Përveç për mesimdhënie apo qëllime tjera jokomerciale, asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet, të ruhet në sisteme ripërtrisëse ose të transmetohet në çfarëdo forme apo mjet elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar, etj., pa lejen me shkrim të autorit. Pjesë të shkurtra të tekstit, që nuk kalojnë dy paragrafa, mund të citohen pa lejen shprehimore të dhënë nga autori me kusht që të njihet burimi i plotë i tekstit. Luteni të kontaktoni: info@kipred.net apo +381 38 555 887.

Botuar nga:



Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave
Kodra e Diellit, Rruga 3, Lam. 39
Prishtinë, Kosovë (UNMIK)
Telefon dhe faks: +381 38 555 887
www.kipred.net

PËRMBAJTJA

Përmbledhje	1
Hyrje	3
Rëndësia e arsimit të lartë	8
Historik i shkurtër	10
Çfarë arsimit të lartë është në dispozicion?	12
Papunësia dhe demografia e rinisë	13
Arsimi para-universitar	14
Kandidatët për student dhe provimet pranuese	15
Mësimdhënia	17
Profesorët	19
Pagat	20
Cilësia	21
Planprogrami	24
Tekstet universitare	26
Kuptimi i reformës	28
Reforma e prindërve dhe studentëve	30
Të drejtat e studentëve	32
Notimi	33
Profili: Aftësitë kundrejt përmbajtjes	35
Aftësitë e reja	36
Teknologjia informative	37
Planifikimi i karrierës	39
Përputhja e rezultateve me ekonominë	40
Konkurrenca në arsimin e lartë	42
Harmonizimi me sistemin ndërkombëtar	45
Ambienti arsimor i rajonit dhe i Bashkimit Evropian	45
Standardet ndërkombëtare të arsimit të lartë	46
Përvojat pozitive	49
Strategjia për arsimin e lartë	50
Administrata: pengesë për ndryshimet	53
Politizimi	57
Përcaktimi i cilësisë	58
Shtytja që institucionet të orvaten vetë për cilësi	58
Kontrolli i brendshëm nga institucionet përkatëse	59
Arsimi i lartë i komuniteteve dhe Universiteti i Mitrovicës	61
Pjesëmarrja dhe pagesat	63
Politika financiare	68
Rekomandimet	75

Përmbledhje

Pas disa dekadave kur kosovarët përparuan tejet shpejt, arsimi i lartë tani ka rënë në një gjendje të mjerueshme. Arsimi i lartë radhitet si një ndër brengat kryesore nëpër sondazhe. Fatkeqësisht, në vend që të shqetësohen nga praktikat negative në arsimin e lartë, politikanët gjejnë interes vetëm në aspektet politike të arsimit. Pasi që Kosova do të garojë në ekonomi të tregut të lirë, do ta ketë të vështirë që të arrijë sukses pa u përafëruar në cilësi me fqinjët e saj. Për më tepër, me përhapjen e teknologjisë dhe me përsosjen e afarizmit, rëndësia e madhe që ka arsimi i lartë do të rritet edhe me tepër.

Që nga kontakti i parë me universitetin, provimi pranues i përforcon përvojat e mëparshme të studentëve: memorizimin dhe truhe të tjera si marrjen e notave të mira në fillim. 'Fatlumët' e paktë që pranohen nuk kanë motivim për të studiuar sepse njohuritë të cilat u ofrohen nuk janë ato që kërkohen në tregun e punës. Shumica janë të interesuar vetëm për diplomë.

Shumica e studentëve përfundojnë studimet pa njohuri të gjuhës angleze, pa aftësi kompjuterike, të paaftë për të shkruar shqip si duhet dhe pa mendim kritik apo aftësi grupore/shoqërore. Çfarë është edhe me keq, etika e tyre varfërohet edhe më tej kur e kuptojnë që shumë nga librat e tyre janë plagjiat nga profesorët, të cilët kërkojnë nga studentët që ta kenë një kopje të re të librit të tyre në ditën e provimit; mënyra e tyre për të siguruar që e drejta e autorit mbrohet në Kosovë.

Tani ka më tepër mundësi për studim, në afër 20 institucione private. Fatkeqësisht, pak prej tyre janë më të mira se UP-ja. Edhe me keq, ata kanë krijuar të njëjtat profile dhe punësojnë me gjysmë orari profesorët e UP-së, që padyshim sjellen më mirë në këto institucione.

Si rezultat, në vend që të jetë një pasuri, duke qenë mjaft e paarsimuar, rinia e Kosovës mbetet barrë për shoqërinë. Udhëheqësia e re është duke luftuar disa dukuri negative, kryesisht plagjiaturën. Por duke u nisur nga parimi se intelektualët e sotëm duhet të kenë disa profesione, arsimi duhet të promovojë më tepër aftësitë e gjithanshme.

Shumica fajësojnë "politizimin", përpjekjet e tepruara nga parti të ndryshme për kontroll të posteve, që nuk dallon nga e njëjta dukuri në institucionet tjera publike. Por, problemi i vërtetë është menaxhimi i dobët dhe klientelizmi. Në vend të përcaktimit të rezultateve të studimeve së pari, mësimdhënia udhëhiqet nga oferta, dhe rrjedhimisht lëndët e reja caktohen duke pasur parasysh shkathtësitë ekzistuese të profesorëve, zakonisht në mospërputhje të plotë me shoqërinë moderne.

Studentët paguajnë një taksë të vogël për studimet e tyre, por shumica e tyre mendojnë se ata i paguajnë plotësisht ato. Do të ishte mirë që kjo t'i shtynte ata që së paku të kërkonin shërbime më të mira, por vetëkënaqësia e tyre tejkalohet vetëm nga arroganca e udhëheqësve të studentëve për të cilët pozicionimi politik është shumë më i rëndësishëm sesa problemet e studentëve. Rrjedhimisht, arroganca e tyre krahasohet me

plogështinë e udhëheqësve të universitetit në të gjitha nivelet, në mënyrë jo të habitshme pasi që institucionet që ata udhëheqin marrin një shumë të caktuar vjetore, e cila varet vetëm nga numri i studentëve. Pasi që ata kanë një lloj monopoli, financimi i secilit departament është relativisht i sigurtë.

Pasi që shkalla e diplomimit është e ulët (p.sh. Kosova prodhon katër herë më pak të diplomuar për kokë banori sesa Bullgaria), një llogaritje e përafërt kur të pjesëtohen të ardhurat e përgjithshme të UP-së me numrin e studentëve të diplomuar nxjerr shifrën se një diplomë kushton rreth 6.000 euro në vit.

Punimi ofron një skemë të përgjithshme për të thithur më shumë para private në arsimin e lartë, për të shpërndarë fondet aktuale në mënyrë që të nxitet konkurrenca për të përmirësuar cilësinë sikurse edhe për të ngritur numrin e studentëve dhe për të zvogëluar numrin e viteve për diplomim. Në vend të financimit të shumicës së studentëve, autoritetet duhet të ndërtojnë një skemë të bursave të plota për më të mirët dhe për më nevojtarët. Për të tjerët, pako të ndryshme financiare duhet të zhvillohen për të nxitur cilësi. Për më tepër, disave u duhen vetëm kredi, që kthimi i tyre do të përkrahte studimet e më shumë studentëve.

Hyrje

Identifikimi, arsimimi dhe ruajtja e talentit brenda tregut të punës ka qenë prioritet i lartë për shumicën e vendeve që tani konsiderohen të zhvilluara. Një nga preokupimet e përhershme për çdo qeveri duhet të jetë gjetja e mënyrave për të siguruar arsim sa më cilësor për sa më shumë studentë. Nëse të rriturit dhe të rinjtë që hyjnë në tregun e punës nuk kanë aftësi adekuate, një gjë e tillë është pengesë e patejkalueshme për zhvillimin e ekonomisë.

Në tërë regjionin, arsimi i lartë është në krizë për shkak të tranzicionit, por në Kosovë është në një gjendje veçanërisht të vështirë. Që nga viti 1969, vetëm më të zgjuarit apo më fatlumët 2,5% (50.000 njerëz) kanë marrë diplomë universitare (bazuar në të dhënat zyrtare të UP-së), apo kanë mbaruar shkollë të lartë, gjithnjë e më shumë në fusha të gabuara dhe duke marrë aftësi joadekuate. Siç e thotë në mënyrë të ashpër një ish-profesor i elektroteknikës, UP-ja është duke nxjerrë “një gjeneratë të degjeneruar të njerëzve që janë mësuar të pranojnë poshtërimin si diç normale dhe mësojnë gjëra jo-relevante dhe shpenzojnë 4 e më tepër vite në diç që nuk ju duhet fare në treg të punës” (Ilazi 2006).

Shumica e kosovarëve mendojnë që arsimi është njëra ndër çështjet kryesore që e ka pllakosur shoqërinë .

Sistemi i kaluar ka pasur efektet e veta pozitive dhe negative. Nga një shkallë e analfabetizmit prej 78% pas Luftës së Dytë Botërore, Kosova ka arritur që të zvogëlojë ngecjen në krahasim me fqinjët e vet në fund të viteve '80, por fatkeqësisht dallimi ka filluar të rritet prapë në këto vitet e fundit. Edhe për arsye ideologjike, arsimi ishte bërë filtri kryesor për të hyrë në mirëqenien e qëndrueshme të byrokracisë shtetërore. Edhe pse është tjetër byrokraci sot, sektori publik akoma është punëdhënësi kryesor, dhe si i tillë përbën stimulimin kryesor që studentët të marrin një diplomë. Duke shpresuar që të ngriten lartë hierarkisë shoqërore, prindërit vazhdojnë t'ju thonë fëmijëve të tyre që mos të punojnë, por të fokusohen vetëm në shkollim. Fatkeqësisht, në një shkallë më të lartë se kurrë, elita e ardhshme kosovare e ka kuptuar se lidhjet, lajkatimi dhe paratë janë mjetet kryesore për sukses në jetë.

Konkurrenca e shtuar ndërkombëtare kërkon transformim të shkathtësive të punës që paraqet ngarkesë për arsimin e lartë, gjithnjë e më i rëndësishëm për ekonominë globale.

Duke ju hedhur një vështrim politikave qeveritare dhe (mos)funksionimit të tregut, ky punim analizon trendet, huan ide nga regjioni e më gjerë, dhe sugjeron një mori idesh si të shkohet përpara në mënyrë pragmatike në

aspektin afatshkurtër dhe në mënyrë strategjike në aspektin afatgjatë. Ky punim i drejtohet qeverisë dhe organeve të saj, institucioneve të arsimit të lartë, organizatave studentore dhe studentëve në tërësi, prindërve, punëdhënësve dhe mbarë shoqërisë.

Për të përmendur disa nga trendet shqetësuese në arsimin e lartë në Kosovë për të cilat

mediat kanë raportuar rregullisht, objektet universitare në mënyrë të paligjshme janë dhanë me qira për qëllime fitimprurëse, shpesh provimet mund të kalohen me pagesë, lëndët riemërohen dhe kjo quhet reformë. Intervenimi për të pranuar një student në universitet është një favor që kushton shumë, dhe ndodh që studentët çuditërisht të shtohen në listë pasi komisioni i pranimit përfundon listën. Profesorët përdorin libra të njëjtë në lëndë të ndryshme, disa ligjërojnë për vite të tëra pa marrë pagë dhe të tjerë paguhen veçantë për angazhime të ndryshme. Profesorët, cilësia e të cilëve në mënyrë të vazhdueshme është duke rënë, bëjnë plagjiat librat e tyre dhe edhe kur ky lajm arrin në media për këtë deri vonë nuk merreshin kurrfarë masash (tani janë bërë disa suspendime për këtë arsye). Studentët duhet të tolerojnë arrogancën e profesorëve, përndryshe me vite mund të mos e kalojnë provimin që është aq i nevojshëm për të diplomuar. Një numër i vogël është duke studiuar dhe shumë më pak janë duke diplomuar. Madje disa nga donatorët janë tërhequr dhe të tjerët kanë shprehur pakënaqësi në punë me UP-në.

Përgjatë historisë së arsimit të lartë, në Kosovë kanë diplomuar sa në Slloveni çdo dy vjet.

Përveç që është çështje me rëndësi në aspektin e zhvillimit shoqëror, arsimit të lartë ka veçori negative që i bën politikanët të tremben – kërkon mobilizim masiv, dhe është investim afatgjatë – kështu që puna e mirë i shpërblen ministrat e ardhshëm dhe jo atë që e bën punën. Për më tepër, ndonëse regjioni përballet me sfidën e tranzicionit dhe përmirësimin e performancës së dobët të shkollave (një problem shoqëror), sfida në Kosovë është shumë më e madhe sepse i tërë sektori i arsimit të lartë është jofunksional, duke përfshirë edhe sektorin privat.

Pavarësisht asaj që problemi është shumë i rëndësishëm, vëmendja që i kushtohet arsimit të lartë si një problem publik është shumë e vogël. Dy debatet e vetme në Kuvendin e Kosovës për arsimin e lartë tregojnë se vëmendja shkon vetëm te aspektet politike¹ dhe se deputetët nuk kanë treguar brengë për cilësinë e ulët të arsimit dhe të shpenzimeve publike për të. Ndonëse politizimi ishte ngritur si çështje nga mediat, kjo nuk është domosdoshmërisht problemi kryesor. Siç e thotë një kolumniste e njohur:

Problemi me Universitetin e Prishtinës, pos që është bërë institucion i politizuar, qëndron edhe në faktin se ne si shoqëri kemi lejuar që ai të humb rëndësinë dhe peshën që ka pasur dhe të shndërrohet në një leckë që fërfëlohet andej-këndej nga kushdo dhe kurdo. Për shkak të rëndësisë së vogël që i është kushtuar institucionit që dikur ishte themel i diturisë, ai është mbushur, me përjashtime, natyrisht, me njerëz që mbajnë tituj akademikë e të cilët mbase kurrë nuk e kanë shkruar as më të voglin tekst universitar dhe me ata që nuk janë në gjendje t'ju tregojnë studentëve se çfarë literature të huaj do të mund të konsultonin, ngase vetë nuk i dinë, sepse pos shqipes jo fort të gdhendur, nuk flasin gjuhë tjetër (Surroi 2006: 10).

¹Kuvendi i Kosovës ka debatuar për arsimin e lartë vetëm kur (1) ligji i ri mbi arsimin e lartë ka sjellur çështjen e Universitetit të kontrolluar nga erbet në Mitrovicë dhe (2) kur kontrolli i njëjës parti mbi UP-në është bërë çështje politike në vetë.

Ministri i Arsimit ka theksuar se:

...edhe sikur UP-ja të kishte kredit të pafund në popullatë, prapëseprapë dëmi i bërë UP-së është dëm i pakthyesëm që i bëhet gjithë shoqërisë dhe vendit tonë. Pra, nuk është në pyetje vetëm dëmi që i bëhet një institucioni, por kemi të bëjmë me dëmtimin e ardhmërisë së tërë shoqërisë dhe vendit tonë, për shkak të mirave të paproduhuara nga ky institucion, si rezultat i ndikimeve për interesa personale, grupe, klanore, por edhe praktike (Veliu 2006: 4).

Ndonëse mediat e kanë trajtuar “politizimin” si problemin më të madh për shkak të kontrollit politik të tyre nga politikanë të ndryshëm, problemi është më afatgjatë. Për shkak të varfërisë dhe një mori faktorësh tjerë, Kosova veçohet me një dinamikë politike tepër konkurruese, duke i vënë shumë institucione publike nën presion për kontroll. Përderisa më parë arsimit i lartë kishte përfituar ‘kujdes’ për qëllime sistematike, sot motivi kryesor është mundësia për të shpërndarë poste për ligjërues, studentë dhe administratorë. Për fat të keq, ky nuk është një problem vetëm në këtë çështje, por sindrom i kulturës politike sot.

Një problem shumë më i vështirë, që shkon kundër instiktit, është sfida për të transformuar universitetin nga një mjet shtet-formues në një institucion meritokurrues. “Të bësh kalimin nga një institucion politik në një institucion krejtësisht akademik ku zhvillohet shkenca do të thotë të dalësh jashtë vetes e të kërkosh rilindje si ajo që i paraprin lëvizjes për pavarësi mes shqiptarëve në shekullin e 19-të. Në diskutimin e sëmurë kjo frymë rilindëse nuk ndihet” (Zeneli 2003: 8). Nga një mision emancipues i '70-ve, në rebelimin e '80-ve dhe rezistencën e viteve '90, universiteti ka dështuar të shpallë këtë si dekadën e meritokracisë.

Sfida kryesore pra është si të transformohet universiteti nga një mjet shtet-formues në institucion meritokurrues.

Ngjashëm me fundin e kohës agrare, kur duhej një raport i ri me ekonominë, sot ekonomia nuk shërben për të dhënë drejtim dhe vizion. Po të kishte zhvilluar UP-ja ndonjë traditë të fortë burokratike me cilësi të lartë të mësimit, edhe pse i pa reformuar, problemi do të ishte vetëm tek tranzicioni. Por problemi sot është më i vështirë se sa thjeshtë tranzicioni, dhe më i vështirë sesa fillimi nga zeroja. Përveç aftësive të vjetruara, politizimit, korrupsionit, universiteti ka nevojë të luftojë edhe paaftësitë e një shtrese të mbledhur rreth universitetit. Është e kuptueshme që kur tradita nuk siguron inercion për cilësi, nuk ka forca të tregut, nuk ka vizion nga udhëheqja aktuale e universitetit publik apo të atyre private, faktori i vetëm që jep drejtim për arsimin e lartë mbeten vetë orvatjet e këtyre institucioneve.

Kosova nuk mund të ecë përpara pa e zënë hapin në arsim të lartë me vendet fqinje.

Politikanët shpesh flasin për vlerën e madhe të rinisë që e disponon Kosova. Mirëpo, rinia ka vlerë vetëm nëse është e arsimuar, përndryshe ajo është barrë. Zhvillimi afatgjatë i Kosovës, si çdokund në botë, drejtpërsëdrejti varet nga cilësia dhe shkalla e përfshirjes

së të rinjve në arsim. Kjo është veçanërisht e vërtetë për Kosovën duke pasur parasysh që ka popullsinë më të re në Evropë (HDR 2002: 20). Kjo nuk ndodh për shkak se studentët apo prindërit e tyre nuk janë duke i vërejtur problemet e përmendura më lartë, por se nuk kanë alternativë tjetër për shkollim.

Në anën tjetër, sukcesi ekonomik gjithnjë e më shumë po varet nga arsimimi. Siç e ilustron Schwab “bota e së nesërme nuk është një botë bazuar në supra-strukturën e kombeve-shtet. Kjo është një botë ku biznesi është formësuesi kryesor jo vetëm për zhvillimin e ekonomisë por gjithashtu edhe për zhvillimet shoqërore; kjo është një botë ku shoqëria civile po ashtu ndjehet e angazhuar” (2005-2006: 16). Jo vetëm që këto objektiva statike nuk janë përmbushur, por pasi që këto kanë filluar të bëhen gjithnjë e më të pakapshme, dështimi i arsimit është veçanërisht dëshpërues.

Tani sfida është se si të kthehet një universitet lokalist, etnik, byrokratik, i politizuar, arrogant, me financa joefikase – në një universitet funksional, kombëtar, meritok që transformon personelin e Kosovës në mënyrë që të shtyjë përpara zhvillimin e vendit. Për më tepër, kjo mund të arrihet vetëm me një proces gjithëpërfshirës, ku problemet definoohen së bashku, duke shpjer në zgjidhje reale që mund të mobilizojnë më shumë shoqërinë në përpjekje të përbashkëta.

“Thjeshtë, vendet të cilat nuk investojnë në aftësi do të dobësohen” (Gerstner 2005 - 2006: 98).

Përveç vëmendjes së lartë retorike, nuk ka dialog mbi atë se kah duhet të drejtohet arsimi. Kjo tregon se përveç çështjes së politizimit, politik-bërësve nuk iu është bërë vonë për aspekte tjera të arsimit. Dialogu është më se i domosdoshëm pasi që arsimi i lartë jo vetëm që është faktor thelbësor për zhvillim, por është edhe një politikë thelbësore sociale që duhet të shoqërohet me politika adekuate që kanë të bëjnë me tregun e lirë të ekonomisë dhe me tregun e punës.

Një diskutim i tillë është i komplikuar dhe përfshin jo vetëm zgjidhje teknokrate por po ashtu edhe vendime politike dhe të vlerave. Si çështje që ka të bëjë me vlerat, nuk ka vendime të drejta dhe të gabuara. Rrjedhimisht, punimi mëton të jetë sa më transparent për mënyrën se si arrin në përfundimet në vijim. Në parim, punimi jo vetëm që është kundër politikave ndërhyrëse por është edhe kundër iluzionit që sektori publik mundet apo duhet që të bartë barrën kryesore të arsimit të lartë. Me përmirësimin e konkurrencës dhe shfrytëzimin e tregut dhe forcave globale (dhe korigjuar ato ku është e nevojshme) për të siguruar menaxhim efektiv të burimeve private dhe publike, qeveria duhet të sigurojë qasje të barabartë dhe mundësi për të gjitha segmentet e shoqërisë.

Edhe pse shpesh pretendohet se Kosova përballet me probleme unike, probleme të tilla ka pasur edhe në vendet tjera të botës. Vizioni i politikave nuk ka nevojë të shpiket. Kosova ka për qëllim që t’i bashkohet shoqërisë evropiane dhe në këtë drejtim, së pari duhet të gjejë hapa praktikë për tu bërë pjesë e Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë, që përkufizohet si:

- një sistem i qartë me tituj të krahasueshëm;
- një sistem i mbledhjes dhe transferimit të kredive;
- bashkëpunim në sigurim të kualitetit.

Edhe pse Kosova është e përkushtuar në lëvizje të tilla integruese në të gjitha fushat, duke përfshirë edhe arsimin e lartë, ndryshimet e gjertanishme kanë qenë kozmetike. UP-ja ka futur kreditë si një mënyrë e “lehtë e njohjes dhe krahasimit të titujve” dhe i është nënshtruar deklaratës së Bolonjës, por këto kanë mbetur retorikë, siç edhe e ilustron punimi.

Mund të përfundohet se politika e deritanishme e qeverisë ka qenë e papërshtatshme dhe burimet e saja të pamjaftueshme dhe joefektive. Mbi të gjitha, kjo politikë nuk e lejon tregun që të prodhojë cilësi apo që të përputhë nevojat e tregut me pritjet e studentëve. Struktura nxitëse e tanishme nuk shpërblen profesorët e mirë por ata të pozicionuar mirë dhe as që ndikon në zgjedhjen e studentit për t’u profilizuar në ato fusha ku Kosova ka nevojë sot apo në të ardhmen. Si rezultat, është e nevojshme që të ri-mendohet arsimi i lartë si sistem, të hyrat dhe të dalat, jo vetëm në kuptimin e parave por në kuptimin e vlerave dhe nevojave të shoqërisë, në aspekt të asaj çka të tjerët mund të ofrojnë dhe të përmirësojnë dështimet e tregut. Si studim i parë i këtij lloji, ky punim vështron sistemin në përgjithësi. Studime të tjera duhet të bëhen për t’u marrë me tutje me çështjet specifike. Ky punim në rend të parë është realizuar përmes përpunimeve të raporteve të ndryshme, me anë të intervistave të rëndësishme dhe me analizë të shkrimeve në media.

Rëndësia e arsimit të lartë

Shumica e vendeve i kushtojnë rëndësi të lartë arsimit në përgjithësi dhe arsimit të lartë në veçanti për një afat të gjatë kohor. Në demokracitë e zhvilluara debatet zakonisht fokusohen në (a) qasje të barabartë, (b) në çfarë niveli duhet të përkrahët nga fondet publike, ose (c) nëse kualiteti të cilin e prodhon është i krahasueshëm me vendet e tjera. Pavarësisht nga niveli i zhvillimit të një vendi, dhe përveç të qenit burim kryesor i aktivitetit intelektual i vendit, arsimi i lartë është i rëndësishëm për tri arsye: është një e drejtë, e zhvillon lirinë individuale, dhe ofron të mira të rëndësishme për zhvillim.

Mosfunksionimi i arsimit të lartë është problem i tërë vendit.

Për shkak të hapjes së shoqërive të mbyllura, çdo garë dhe bashkëpunim ndërkombëtar që është në rritje kërkon transformimin e praktikave. Mjedisi global po bëhet gjithnjë e më konkurrues dhe kërkon një mënyrë shumë dinamike të zhvillimit të afarizmit. Për të pasur sukses kërkohet ndryshim i aftësive në fuqinë punëtore dhe këto priten të ndryshohen shumë më shpejtë në të ardhmen. Në shkallë gjithnjë e më të shpejtë me çdo gjeneratë të re, mjetet që janë të domosdoshme për këtë transformim bëhen gjithnjë e më të ndërlikuara dhe kërkohet që më tepër njohuri të shpërndahet tek më shumë banorë sesa më parë. Siç e thotë një autor, “thjeshtë, vendet që nuk investojnë në aftësi do të dobësohen” (Gerstner 2005-2006: 98). Argumentet e lartpërmendura paraqesin një sfidë të paparë për arsimin e lartë, suksesi i të cilit është çelësi i suksesit në ekonominë globale sot.

Nuk ka ndonjë reçetë të fshehtë për këtë transformim. Kosova nuk do të jetë në gjendje të lëvizë përpara pa u përafuar me fqinjët e saj në disa aspekte, përfshirë arsimin e lartë. Investimet e qëndrueshme dhe qeverisja e mirë në të gjitha aspektet sikurse edhe mësimi gjatë gjithë jetës janë kritike për një përdorim më të mirë të talentit dhe aftësive që gjenden në një vend. Një argument më rëndësi që ti kushtohet vëmendje arsimit është dëshmia empirike se “paratë dhe koha që individët shpenzojnë në kualifikimet univer-

Paratë dhe koha që individët shpenzojnë në kualifikimet universitare paguajnë dividendë që janë më të mëdha se kamatat reale, dhe shpesh shumë më të mëdha (Schleicher 2005 -2006: 96)

sitare paguajnë dividendë që janë më të mëdha se kamatat reale, dhe shpesh shumë më të mëdha” (Schleicher 2005-2006: 96).

Nuk është se kosovarët nuk e shohin rëndësinë e arsimit të lartë, përkundrazi, shumica e kosovarëve mendojnë se arsimimi është një prej çështjeve më të rëndë-

sishme që e shqetëson shoqërinë tonë. Në listën prej 31 gjërave, standardet e arsimit janë konsideruar si prioriteti më i lartë nga 70% e njerëzve, radhitur menjëherë pas statusit final, papunësisë, ekonomisë së dobët dhe korrupsionit (Irwin 3). Ky shqetësim ka gjetur vend edhe në deklaratat e politikanëve, retorika e të cilëve është përplot me klishe lidhur me arsimimin si “bazë e zhvillimit të një shoqërie” apo duke kërkuar “arsimim cilë-

sor në pajtim me zhvillimet bashkëkohore”. Strategjia për Arsimin e Lartë (e punuar nga MASHT-i) pranon që “arsimimi i lartë ka rol të rëndësishëm në kapacitet njerëzore që të ballafaqojnë sfidat e kohës...” (Strategjia e MASHT 2004: 3). Zyrtarët gjithashtu e vërejnë situatën e mjerë, siç ka thënë edhe Ministri i Arsimit:

sulmet dhe dëmet të shumta që i janë bërë prej themelimit e deri sot. ...me gjithë politizimin e skajshëm që i është bërë në periudhën e pasluftës, edhe me gjithë gjendjen e rëndë materiale, edhe me gjithë rënien e cilësisë në punë dhe në shërbimet e veta...Universiteti ynë është katandisur keq dhe, tashmë, ajo që ka mbetur nuk është as hija e një institucioni krenar dhe të fuqishëm nga vitet e shtatëdhjeta, tetëdhjeta, por edhe të viteve të nëntëdhjeta të shekullit të kaluar...Një Universitet që nuk rrezaton ekspertizë, kreativitet, vlera dhe ndikim në rrjedhat shoqërore të një vendi, nuk i plotëson as kushtet themelore për t’u quajtur universitet (Veliu 2005: 10-11).

Disa prej arsyeve për gjendjen në arsimin e lartë duhet të kërkohen në të kaluarën, të cilën e trajton pjesa vijuese e punimit.

Historik i shkurtër

Historia e arsimit të lartë në Kosovë është një nga tregimet mahnitëse të së kaluarës së turbullt. Fillet e arsimit të lartë datojnë nga fundi i viteve '50 kur u krijuan një numër i shkollave të larta dy-vjeçare të mësuësisë, filluar me Shkollën Pedagogjike në Prishtinë në vitin 1958. Programi i parë katër vjeçar ka qenë Departamenti i Filozofisë, themeluar në vitin 1960 që ka përfshirë matematikën, fizikën, filologjinë, kiminë, etj. Tri departamente tjera të arsimit të lartë u themeluan në vitin 1961: (1) mjekësia, (2) juridiku dhe ekonomia, dhe (3) tekniku, të gjitha duke vepruar si degë të Universitetit të Beogradit, me një numër total prej 90 studentëve të regjistruar në vitin e parë. Universiteti i Prishtinës u themelua në vitin 1969 dhe degët ekzistuese u shkrinë në universitetin e ri të themeluar me ligj nga Kuvendi i Krahinës Autonome Socialiste të Kosovës (Gazeta Zyrtare 1969). Në fillim ligjëratat kryesisht mbaheshin në gjuhën serbe për t'u kthyer gradualisht në gjuhën shqipe me shtimin e numrit të profesorëve dhe ligjëruesve shqiptarë. Deri në fund të viteve të '80, organet drejtuese kanë qenë të njëjta për të dy gjuhët dhe për programin mësimor.

Kjo periudhë e shkurtër e arsimit të lartë në Kosovë ka qenë e pasur me zhvillime dramatike. Ndonëse pa dyshim ka pasur momente që kanë merituar lëvdatë dhe admirim, shumica e ndryshimeve kanë lënë trashëgimi të hidhur dhe të dhimbshme. Universiteti i Prishtinës ka filluar nga zeroja në kohën kur autonomia ligjore, kulturore dhe etnike po rritej. Themelimi i tij në masë të madhe është konsideruar si "moment historik për popullin e Kosovës dhe në veçanti për shqiptarët" (UP 2005: 5). Është e qartë se Universiteti ka qenë mjeti kryesor për emancipimin e mëtutjeshëm të kosovarëve dhe të krijimit të elitës intelektuale dhe administrative. Ndërmjet viteve '70 dhe '80, UP-ja ka ofruar mundësi që më parë kanë qenë të paimagjinueshme për mijëra kosovarë, duke përfshirë edhe shqiptarë nga regjione të ndryshme të ish-Federatës Jugosllave, për të marrë shkolim në gjuhën amtare. Kuptohet që një gjë e tillë ka ndikuar në strukturën e tërë shoqërisë, duke i bërë kosovarët të përshtatshëm për pozita më të mira dhe nismë për pjesëmarrje kolektive. Me rrënimin e autonomisë së Kosovës, arsimit të lartë ka qenë njëri nga institucionet e para që është sulmuar. I akuzuar se kishte rënë në dorë të "separatistëve dhe ekstremistëve shqiptarë" (Milanović 1995:19) arsimit të lartë u bë cak i drejtpërdrejtë gjatë fushatës së Millosheviqit për ti hequr Kosovës autonominë në fund të viteve të '80.

Me imponimin e ligjeve dhe planprogrameve serbe në vitin 1991, legjislacioni i Kosovës për arsim u shpall i pavlefshëm. UP-ja humbi autonominë dhe u fut nën kontroll të drejtpërdrejtë të Beogradit. U vendosën "masat e përkohshme" dhe programet serbe si dhe shumica e dekanëve u suspenduan. Pas refuzimit të profesorëve shqiptarë për të punuar në kushte të tilla, mijëra mësimdhënës të të gjitha niveleve u përjashtuan dhe objektet shkollore u mbyllën. Si kundërpërgjigje, profesorët dhe studentët shqiptarë organizuan sistemin e tyre paralel të arsimit të lartë kryesisht nëpër shtëpi private, i cili ka zgjatur gjatë viteve '90 dhe është financuar nga taksa vullnetare e 3%.

Cilësia e mësimdhënies pësoi rëndë. Literatura ka qenë e pamjaftueshme ashtu si edhe kushtet për mësim dhe zbatim praktik i njohurive. Si përfundim, regjistrimi i studentëve të rinj pësoi rënie. “Sidoqoftë, në vitin 1996, 16.000 studentë (të rregullt dhe me korrespondencë) kanë studiuar në Universitetin shqiptar të Prishtinës, duke punuar në disa ndërrime. Personeli universitar përbëhej nga 826 mësimdhënës me orar të plotë dhe 200 bashkëpunëtorë të jashtëm” (Leutloff dhe Pichl 1999). Ky sistem paralel ka funksionuar në afër 220 shtëpi private, objekte biznesi, shkolla fillore dhe ndërtesa të tjera që kanë qenë në dispozicion. Kërcënimi dhe persekutimi i një numri të profesorëve dhe studentëve nga shteti serb ka penguar funksionimin e duhur të organeve drejtuese.

Kjo periudhë gjithashtu u shënuar edhe me një mobilizim të lartë politik të studentëve në funksion të pavarësisë. Kjo forcoi edhe më shumë perceptimin e shqiptarëve për Universitetin e Prishtinës si “bazë dhe simbol i përparimit dhe pavarësisë së Kosovës, si bazë dhe simbol i identitetit kombëtar dhe si panteon i shqiptarëve të Kosovës” (Koliqi 1995:16).

Menjëherë pas përfundimit të luftës në vitin 1999 dhe vendosjes së administratës ndërkombëtare, u emëruan dy bashkëdrejtues të Departamentit të Arsimit (një vendor dhe një ndërkombëtar). Bashkëdrejtuesi ndërkombëtar praktikisht ka ushtruar funksionin e drejtuesit të universitetit duke e shndërruar rektorin legjitim në drejtues marionetë. Periudha e administrimit ndërkombëtar mbi universitet është shënuar me përpjekje të shumta për reforma jashtëzakonisht të nevojshme, megjithatë me rezultate të pakta. Bashkëqeverisja formale ka zgjatur deri me krijimin e institucioneve vendore të dala nga zgjedhjet e para të mbajtura në nivel të Kosovës në vjeshtë të vitit 2001.

Pas disa vitesh mosmarrëveshje për pozitën e rektorit dhe udhëheqjes së paaftë, Universiteti i Prishtinës për disa vite ka funksionuar pa rektor, disa vite me rektorë të përkohshëm, dhe për disa kohë është udhëhequr nga një këshill drejtues dhe ndonjëherë nga emërimet me ndërhyrje nga Ministria e Arsimit. Kjo ka paraqitur një trajektore degjeneruese, nga një institucion relativisht i respektuar tek kriza më e madhe me të cilën ky institucion është ballafaquar në dekadat e fundit. UP-ja sot është një institucion me plan-program të ngurtë, teknika mësimi që inkurajojnë memorizimin në vend të kreativitetit, pa punë në grupe dhe pa fokus në zgjidhje të problemeve, me libra të vjetruar apo mungesë totale të tyre, pa përdorim të kompjuterëve, ku plagjiati konsiderohet e arritur dhe aftësitë janë në një shpërprurje të plotë me nevojat e tregut dhe standardet e BE-së për arsim.

Çfarë arsimit të lartë është në dispozicion?

Ndonëse Kosova sot ka një numër të konsiderueshëm të institucioneve private të arsimit të lartë, UP-ja mbetet institucioni kryesor në Kosovë dhe i vetmi publik për shqiptarët, ashtu siç mbetet Universiteti i Mitrovicës i vetmi publik për serbët. Më parë kanë ekzistuar disa “shkolla të larta profesionale” të cilat kanë ofruar një diplomë profesionale dyvjeçare dhe kryesisht kanë qenë të vendosura jashtë Prishtinës. Kur Universiteti i Prishtinës ka kaluar në sistem trevjeçar, këto janë transformuar në fakultete dhe i janë bashkuar UP-së.

Gjithnjë e më shumë ka institucione private të themeluara nga profesorë, shumica e të cilave ofrojnë cilësi të ngjashme me atë të UP-së. Dy shkollat e para private kanë qenë Shkolla e Teatrit e hapur në vitin 1994 nga Enver Petrovci, aktor profesional dhe shkolla e gazetarisë e hapur në vitin 1996 nga Ramiz Kelmendi, shkrimtar dhe gazetar. Numri më i madh i shkollave private të regjistruara ishte shënuar në vitin 2002 kur Departamenti për Arsim i UNMIK-ut, i ngarkuar për licencim të institucioneve private, licencoi 12 institucione private të arsimit të lartë (IKS 2006). Asnjë universitet i jashtëm nuk ka prani në Prishtinë, qoftë me objekt apo me mësim në distancë, edhe pse disa kanë marrë akreditim nga jashtë siç është Universiteti Amerikan në Kosovë (AUK) përmes Institutit të Rochester-it të Teknologjisë në SHBA.

Publik apo shtetëror, arsimit të lartë është shumë më i rëndësishëm për Kosovën sesa për shumicën e vendeve tjera për shkak të pjesëmarrjes së madhe të rinisë në popullatën e saj, çështje kjo që shqyrtohet në pjesën në vazhdim.

Studentët e rregullt (2004-2005)							
Universiteti	I	II	III	IV	V	VI	Total
F	2.813	3.258	2.753	1.691	394	162	11.071
M	6.349	6.916	6.134	4.331	1.07	326	25.126
Studentët me korrespondencë							
Universiteti	I	II	III	IV	V	VI	
F	645	1.172	112	236	0	0	2.165
M	1.374	1.63	173	529	0	0	3.706

Burimi: www.uni-pr.edu

mekanizmave vetë-rregullues. MASHT-i dhe Ministria e Shërbimeve Publike nëpërmjet Entit Statistikor duhet të krijojnë një sistem më të mirë të mbledhjes së të dhënave, në përshtatje të plotë me sistemin e UNESCO-s të klasifikimit standard për të mundur krahasimin e indikatorëve të arsimit dhe mbledhjen e indikatorëve jo vetëm të thjeshtë por edhe të indikatorëve relevant për të ulur ngecjen e Kosovës në konkurrencën globale dhe rajonale.

Një problem serioz është që të dhënat elementare për arsimin e lartë janë të cilësisë së dobët dhe të shkapërdhura gjithandej. Në mungesë të informatave të duhura, vendimmarrësit dhe zyrtarët nxjerrin rregulla, ligje por çfarë u mungon është formulimi i

Papunësia dhe demografia e rinisë

Kosova ka përqindjen më të lartë të rinisë në Europë. Përderisa shtetet perëndimore europiane lakmojnë të kenë një pasuri të tillë, një përqindje kaq e lartë e rinisë është aktualisht barrë e madhe për Kosovën. Përderisa papunësia e përgjithshme në Kosovë llogaritet të jetë rreth 35-50% (varësisht nga burimi), tek të rinjtë papunësia arrin 63-85%. Siç tregon edhe Raporti i vitit 2004 mbi zhvillimin njerëzor, “duke u nisur nga ajo që një e treta e popullsisë është nën moshën 14 vjeç, kriza e punës me të cilën do të ballafaqohen gjeneratat e ardhshme të Kosovës, është shumë alarmuese” (HDR 2004: 78). Për më tepër, ndonëse papunësia e përgjithshme është gjithashtu e vazhdueshme apo disi në rënie, papunësia e të rinjve “vuan ngritjen më të lartë të papunësisë (14.6%)” (MPMS 2004).

Se arsimiti ka rol në shkallën e papunësisë është gjerësisht e pranueshme. Siç tregon edhe tabela më poshtë, meshkujt me kualifikim më të ulët e kanë më të vështirë për të gjetur punë. Fatkeqësisht, pa marrë parasysh aftësitë e tyre, femrat e kanë të vështirë të gjejnë punë (Observatoriumi i Kosovës për Punësim dhe Aftësi 2004: 21).

Zbërthimi e papunësisë sipas nivelit të edukimit:		Krahësuar me :
- Arsimiti fillor	32.6	49% papunësia e përgjithshme, 73-83% e të cilëve me papunësi afatgjate
- Arsimiti i mesëm	58.5	
- Arsimiti i lartë	7	

Burimi: Tregu i punës dhe Papunësia, Tryezë e rrumbullakët e Forumit Ndërkombëtar, Riinvest, janar 2003.

Situata është veçanërisht e rëndë për shkak se niveli i ulët i arsimimit dhe mospërputhjet në mes arsimimit dhe nevojave të sektorit të punës ndikojnë që shumë të rinj të mbeten të papunë për afat të gjatë. Kjo paraqet forcë strukturale që mban papunësinë e kësaj grupmoshe në shkallë proporcionalisht të lartë, që mund të përmirësohen vetëm me politikë afatgjate të planifikuar tejet mirë.

Siç tregojnë disa studime, gjendja është më alarmuese për femrat. “Femrat kosovare kanë shkallën më të ulët të papunësisë dhe një prej niveleve më të ulta të edukimit në gjithë Europën” (ESI 2006: II). Sipas tyre, rreth 9% e femrave kosovare janë të punësuar (ESI 2006: 22).

Në një vend si Kosova ku popullata është në rritje të shpejtë dhe është e papunësuar, ka energji të madhe të pashpenzuar e cila mundëson shpërthim të dhunshëm për aq kohë sa nuk ka ekonomi të shëndetshme që gjeneron punë për ta. Në vend se të jetë pasuri, siç zakonisht lavdërohen politikanët kosovarë, rinia ka qenë dhe do të vazhdojë të mbetet barrë.

Në vend se të jetë pasuri, rinia relativisht e pashkolluar dhe strukturalisht e papunë është barrë.

Edhe pse ky punim përqëndrohet në arsimin e lartë, disa prej arsyeve për këtë papunësi të skajshme të rinisë mund të gjenden në arsimimin para-universitar.

Arsimi para-universitar

Jo vetëm që pak të rinj kosovarë ndjekin shkollimin, por edhe ata që e bëjnë këtë, pajisen me shkathtësi joadekuate për tregun e punës ose për vazhdimin e studimeve të tyre. Kjo pjesë e punimit gjurmon disa prej problemeve që arsimi i lartë trashëgon nga edukimi para-universitar.

Fëmijët kosovarë dëmtohen qysh nga niveli parashkollor. “Në vitin akademik 2000/2001, vetëm 4,7% e numrit të përgjithshëm të fëmijëve të moshës 1-6 vjeç vijuan nivelet parashkollore. Si krahasim, 37% e fëmijëve pajisen me edukim parashkollor në Shqipëri dhe 20% në Maqedoni” (HDR 2002: 52). Edukimi parashkollor nuk është i detyrueshëm. Ky nivel kryesisht përbëhet nga kopshte private çmimet e të cilave pakkush mund t’i përballojë.

Shkalla e regjistrimit në arsim në Kosovë (%) 2000 (vlerësuar)	Femra	Meshkuj
Fillor	91.2	92.1
Mesëm	54	65
Lartë	16.4	58.4

Burimi: HDR 2002: 54

Megjithëse arsimi fillor është i zhvilluar mirë, janë disa probleme serioze, veçanërisht në disa komuna. Varësisht nga burimi, rreth 91,2-95,4% të fëmijëve të moshës parashkollore të kësaj moshe regjistrohen në arsimin fillor. Përderisa shkalla e regjistrimit në shkollë fillore është relativisht e lartë (edukimi fillor është i detyrueshëm), vetëm 73% e fëmijëve të regjistruar në klasën e parë të shkollës fillore e përfundojnë klasën e tretë. Më pastaj, çdo i katërti që përfundon arsimin fillor vazhdonë shkollimin e mesëm. Prej atyre që regjistrojnë shkollën e mesme, vetëm 45% e përfundojnë këtë nivel. Si përfundim, shkalla e regjistrimit në arsim të lartë është e ulët: 17,3% (HDR 2002: 55).

Nxënësit ballafaqohen me një planprogram të ngjeshur dhe me furnizim të pasigurtë të teksteve mësimore. Përveç kësaj, librat “promovojnë më shumë përvetësim të informatave sesa shkathtësi të të menduarit kritik dhe zgjidhjes së problemeve” (Peffer dhe të tjerët 2005: 16-18). Një numër i madh i nxënësve potencialisht të mirë nuk përfundojnë shkollën për shkak se sistemi arsimor nuk i përgjigjet mënyrave të shumta të të mësuarit, që mund të thuhet edhe për arsimin e lartë.

Mendimi kritik gjithashtu mbetet prioritet i ulët, vihet pak theks në debate, mësimdhënie ndërdisiplinare, punë grupesh, ose në zgjidhjen e problemeve kontekstuale. Përkundër disa përpjekjeve për të trajnuar mësimdhënësit në metoda të reja, përqendrimi në zgjidhjen kontekstuale të problemeve mbetet i ulët (Peffer dhe të tjerët 2005: 17) për dallim nga llogaritjet abstrakte numerike ose shkathtësive procedurale të cilave akoma ju kush-tohet rëndësi. Fatkeqësisht, edhe për më të zellshmit, të mësuarit e shumë informatave vazhdon të mbetet qëllimi primar në arsim, që nuk u jep studentëve aftësi për të aplikuar informatat në situata të ndërlikuara dhe për të zhvilluar shkathtësi të avancuara të të menduarit. Fatkeqësisht, këto ‘shkathtësi’ si memorizimi jo vetëm që u mësohen nxënësve, por pikërisht këto edhe kërkohen nga dita e parë në arsim të lartë, provimi pranues.

Kandidatët për student dhe provimet pranuese

Siç tregon pjesa paraprake, shumë probleme të arsimit të lartë barten nga arsimi paraprak dhe është shkaktar i cilësisë së ulët të studentëve. Para se të pranohen në universitetin publik, studentët duhet të kalojnë provimin pranues që përgatitet nga secili fakultet ose në bashkëpunim me Rektoratin. Të tilla provime marrin parasysh notat nga shkolla e mesme dhe përgjigjet ndaj pyetjeve të nxjerra nga lëndët kryesore. Konkurrenca është aq e madhe sa që shpesh ndodh që më shumë se 10 studentë konkurojnë për një vend në departamentet më të kërkuara.

Provimi pranues në UP nuk matë shkathtësitë e nevojshme që një student të regjistrohet në arsim të lartë. Sikurse arsimi fillor që përqendrohet në të mësuarit përmendësh dhe jo në shkathtësi, provimi pranues kërkon pikërisht këtë memorizim dhe si i tillë e përjetëson këtë qëndrim. Përveç eksperimenteve të rralla, nuk është bërë asnjë përpjekje e organizuar për të matur 'shkathtësitë' në vend të 'diturisë'. Për më tepër, flitet për mungesë të objektivitetit, të njoftësive dhe korrupsionit përgjatë këtij procesi.

Studentët në mënyrë të mistershme futen në lista pasi që komisioni për pranim ta ketë përfunduar punën e tij .

Për shkak të numrit të vogël të studentëve të pranuar çdo vit në UP, studentët kërkojnë zgjidhje tjera si shkuarja jashtë vendit apo në universitete private. Përvoja e disa ligjëruesve në UP tregon që shumë studentë kërkojnë alternativë tjetër për shkaqe si:

- Pamundësia për tu pranuar në Universitetin e Prishtinës;
- Mungesa e drejtimit të dëshiruar;
- Besimi se cilësia është më e lartë në institucione private;
- Përceptimi se studentët trajtohen më i mirë në institucionet private;
- Pakënaqësia me administratën dhe me raportet universitet/profesorë; apo
- Mungesa e vizionit dhe udhëheqja e dobët në UP (bazuar në intervista).

Pavarësisht çmimeve të larta, cilësia e studentëve në institucione private duket e krahasueshme me atë në UP. Disa institucione private kanë arritur të regjistrojnë një numër të studentëve edhe para mbylljes së afatit të pranimit në UP, por zakonisht, vendet në institucionet private plotësohen vetëm pas mbylljes së afatit të dytë të regjistrimit në drejtimet e parapëlqyera në UP.

Florentina Salihu u regjistrua në Rezonancë meqë nuk u pranua në UP. "Ata regjistrojnë me lidhje atje", tha ajo për UP-në. Shumica e të intervistuarve deklarojnë të njejtën gjë. Fatkeqësisht, regjistrimi i studentëve në sektorin privat nuk është më i mirë. Shumë studentë thonë që ata nuk kanë pasur provim pranues fare. "Ne vetëm kemi paraqitur dokumentet dhe kemi dhënë paratë (anonim). Edhe nëse ka provim pranues, ai është sa për 'sy e faqe'. Studentë nga shumë institucione private shprehen që ata nuk dinë për dikë që ka dështuar në proces të regjistrimit.

UP-ja ka përparësi në regjistrim për shkak se mbështetet financiarisht me fonde publike (siç përshkruhet më poshtë në punim) si dhe për faktin se diplomat e saj nuk mund të shpallen të pavlefshme, një luks i madh krahasuar me institucionet e reja private. Siç thekson Ilazi (2006), është e padrejtë që UP-ja me një cilësi të dyshimtë të gëzojë akreditim të padiskutueshëm pa asnjë kontroll të cilësisë ndërsa ato private obligohen të kalojnë nëpë procedura strikte.

Për shumicën e institucioneve private, i vetmi kriter për regjistrim duket të jetë mundësia për të paguar. Në UP, merita është kriter për disa, përderisa për për një numër të konsiderueshëm është gatishmëria për të dhënë mito, sipas disa të intervistuarve. Zgjidhja e këtij problemi kërkon angazhim të shumëanshëm. Së pari, provimi pranues në UP duhet të reformohet. Sipas But Dedaj nga WUS-i, provimi pranues nuk është filter i duhur për përzgjedhjen e studentëve. Ai dhe të tjerë argumentojnë për nevojën e testimit standard për të gjitha institucionet publike. Veç kësaj, shumë pajtohen që ky provim duhet më shumë të theksojë shkathhtësitë dhe më pak informatat. Disa të tjerë argumentojnë që është e nevojshme një përzgjedhje e kujdesshme që teston motivet dhe arsyet për studim.

Në sistemin aktual, ata që kalojnë testin e memorizimit, ballafaqohen me kalimin nëpër arsim të lartë duke ju ekspozuar praktikave të mësimdhënies së vjetruar, planprogrameve të ngurta dhe mungesës së teksteve, temë kjo që trajtohet në vijim.

Mësimdhënia

Praktikat e mësimi mbase përbëjnë faktorin kryesor që ndikon në aftësitë që zhvillon një student. Kur nuk diktohen shënimet, ligjëratat në universitetin publik janë fjalime monotone drejt një audience të gjerë. Shumica e profesorëve nuk kanë orar të konsultimeve, vonohen në ligjërata, apo e bartin ligjërimin tek ndonjë asistent. “Studentët janë të obliguar të presin ligjëruesit e tyre, edhe pse shpesh ndodh të mos vijnë fare” (Kadriu 2006: 4). Debatet janë të rralla, dhe kur ndodhin, nuk kanë të bëjnë me temën që trajtohet por më çështjet e politikës

ditore. Shembujt, rastet studimore dhe situatat reale përdoren pak dhe nuk ka mënyrë të organizuar për të nxitur profesorët që t’i përdorin ato. Teknologjia e avancuar është e pamjaftueshme por nuk përdoret edhe kur ekziston. Projektet dhe hulumtimet grupore ipen si detyra vetëm nga profesorët e jashtëm që paguhen nga donatorët numri i të cilëve ka rënë mjaft. Edhe bashkëveprimi i drejtpërdrejtë në mes mësimdhënësve dhe studentëve për punë praktike është i kufizuar, përderisa këshillimi për karrierë nuk ekziston fare. Shumë institucione, duke përfshirë edhe ato private, zhvillojnë mësimin në grupe prej 50-70 studentësh. Edhe pse disa institucione mburren se mbajnë mësim në grupe të vogla rrallë ka grupe me më pak se 30 studentë.

Përkundër reformave të shumë përfolura, ligjëratat vazhdojnë të jenë njëdrejtimëshe, kryesisht fjalime.

Disa ligjërues kanë filluar të eksperimentojnë teknika të reja, siç është dhënia e materialit për lexim para orës së mësimi. Mirëpo, shumica nuk mund të përdorin risitë për shkak se ata nuk kanë ndryshuar aspekte tjera të domosdoshme (p.sh. ora akoma mbahet si më parë dhe nuk ka diskutim mbi materialin) por edhe për shkak se sistemi në përgjithësi nuk i mirëpret ndryshimet. Shumë studentë marrin tituj universitar pa i fituar aftësitë e të intervistuarit, ndonjë kapacitet analitik apo pa mësuar se si të bëjnë ndonjë hulumtim në internet. Pasi që nuk kërkohen prezantime, “aftësitë e tyre prezantuese janë të dobëta ashtu siç janë edhe aftësitë e tyre analitike” (Gashi, I. 2005). Aftësitë më të mëdha që ata i fitojnë janë marrja e shënimeve në hollësi si dhe aftësia për të transmetuar në mënyrë sa më precize fjalët e profesorëve në mënyrë që të marrin notë më të mirë.

Sipas nenit 193 të Statutit të Universitetit të Prishtinës, personeli akademik i Universitetit është i obliguar të respektojë:

1. Frymën e humanizmit;
2. Autonominë e Universitetit;
3. Lirinë e kreativitetit shkencor dhe artistik;
4. Aktet universitare dhe vendimet e bazuara në to;
5. Parimet e ndershmërise profesionale dhe shkencore;
6. Kodin etik;
7. Reputacionin e universitetit dhe ta përmirësoj atë.

(Statuti i Universitetit të Prishtinës: f. 55/56)

Përshkrimi i mësimdhënies në UP kryesisht vlen edhe për institucionet private, edhe pse në ato private janë duke ndodhur disa ndryshime të vogla. Edhe pse shumica e profesorëve akoma nuk kërkojnë nga studentët që të lexojnë materialin paraprakisht dhe nuk mbajnë konsultime, ata ngadalë po bëhen më tolerantë që të ndërpriten me pyetje të studentëve. Për shkak të pagesës më të mirë dhe grupeve më të vogla, profesorët në institucionet private më së shumti dallojnë në aspekt të mirësjelljes. Ata shpesh janë më serioz dhe me të motivuar, me më pak mungesa në ligjërata apo provime. Liridon Osmani nga “Faik Konica” lavdëron marrëdhëniet e tij të ngushta që kishte me profesorët e tij: “Profesorët na kanë thanë që t’i thërrasim në emër sepse ata na thojnë që ne jemi kolegë”

Edhe pse rralë përdoren, debatet gjatë ligjëratave më shpesh bëhen për politikë ditore sesa rreth mësimi .

(2005). Një tjetër student ka lavdëruar komunikimin përmes postës elektronike me profesorët e tyre. Duket që sektori privat ka krijuar marrëdhënie më të ngushta në raportet profesor-student por edhe kjo ka mbetur në baza individuale. Përveç një apo dy institucioneve private më të mira, në të

tjerat është vështirë të shihet ndonjë përpjekje e organizuar për të vendosur mekanizma për punë më efektive me studentë. Sidoqoftë, konkludohet se arsyeja kryesore e krijimit të këtij dallimi është se studentët që paguajnë janë me këmbëngulës për të marrë cilësi më të mirë për paratë që ata japin. “Niveli i seriozitetit është në maksimum, ka shembuj kur studentët i kanë tërhequr vëmendjen profesorëve që mos të përdorin telefonët mobil gjatë ligjëratave” (Gashi, Y. 2005). Në universitetet më të mira studentët ndjejnë që kanë më shumë pushtet dhe kërkojnë më shumë nga profesorët e tyre. Në ato më të dobtat, pagesa shpesh nënkupton mundësi më të lehtë për të kaluar sepse ashtu e kuptojnë dinamikën biznesore që e mban universitetin.

Ndonëse institucionet private kanë dallim të vogël në mësimdhënie, një epërsi që ato kanë është mungesa e byrokracisë në futjen e lëndëve të reja., përderisa në UP amullia byrokratike e bën një gjë të tillë të vështirë. Sipas një zyrtari nga një organizatë ndërkom-bëtare donatore, “UP-ja është në gjendje dhjetë herë më të keqe. Deri sa në institucionet private kanë në dispozicion teknologji të lartë dhe nuk përdorin diktim, UP-ja bënë të kundërtën. Përndryshe, mësimdhënja është pothuasje e njëjtë” (Dedaj 2005). Edhe burime tjera theksojnë se diktimi rralë përdoret në institucionet private. Dedaj tutje mbivlerëson sektorin privat duke thënë se “Ato universitete private që do të mbijetojnë në pesë vitet e ardhshme kanë me qenë shembull i universiteteve moderne” (Dedaj 2005). Edhe pse mund të thuhet se sektori privat është diçka më mirë në këtë aspekt, akoma lë shumë për të dëshiruar. Praktikisht ata akoma përdorin teknika të ngjashme me ato të UP-së por shpenzojnë më shumë kohë për pyetje-përgjigje në fund të orës dhe i trajtojnë studentët me një respekt më të madh.

**Reformimi i ligjëratave:
- ofrimi paraprak i materialit ;
- ligjërata interaktive dhe debate të bazuara në probleme.**

Disa ndryshime të inicuar, si shkrimi i punimeve, nuk janë mirëpritur nga studentët. Kjo ka qenë veçanërisht pjesë e vështirë e reformave duke pasur parasysh që kjo kërkon më

shumë punë dhe sepse shumica e profesorëve kanë përvojë të pakët në hulumtime dhe shkrim. “Shpesh kërkohet nga studentët e tyre punime seminarike, ndërkohë që ka në mesin e tyre që nuk mbahet mend të kenë botuar ndonjëherë, në mos ndonjë punim shkencor së paku një opinion për një zhvillim a fenomen” (Kupina 2005: 10).

Përfundimi më lartë është fatkeq krahasuar me mundësitë që kanë kolegët e tyre jashtë vendit. Qasja e mënjëhershme në informatat e bollshme “është duke sfiduar format e vjetëra dhe tradicionale të shpërndarjes së njohurisë dhe të edukimit” (Taylor 1999: 118). Studentët dhe profesorët kosovarë rrallë u janë ekspozuar përparësive të mësim-nxënies “në ambientet mësimore me informata të bollshme potenciale” (Taylor 1999: 118). Ja vlen të përmendet se disa nga problemet e reformave në një mënyrë apo tjetrën janë të pranishme në shumicën e institucioneve që i përkasin traditës së Evropës kontinentale. Madje edhe njëra nga vendet më të pasura, Finlanda, në dokumentin e saj strategjik për arsimin e lartë ka pranuar vështirësinë e institucionalizimit të reformave kur këto nënkuptojnë nxitje më të madhe për studentët (Ministria e Arsimit të Finlandës 2001: 22). Megjithatë, qasja ndaj arsimit të lartë në demokracitë e zhvilluara ka shkuar larg përtej përmbajtjes mësimore dhe mësimdhënies në klasë dhe ka arritur në dilema mbi efektin e arsimit në formimin e shoqërisë.

Profesorët

Një arsye pse arrihet në përfundim se mësimdhënia dallon pak ndërmjet institucioneve private dhe publike është fakti se në të dy këta sektorë ligjërojnë të njëjtit profesorë. Numri i profesorëve potencial është aq i vogël sa që të njëjtit duhet japin mësim në disa institucione dhe shpesh ligjërojnë lëndë për të cilat nuk janë kompetentë. Sipas Esat Dautit, këshilltar politik në MASHT, “Kuadri akademik është një ndër problemet kyçe tek institucionet private, pasi që në shumicën e këtyre shkollave japin të njëjtit mësimdhënës” (Rexha 2005: 8).

Sipas nenit 194 të Statutit të Universitetit të Prishtinës, personeli akademik i Universitetit gjatë procesit arsimor është i obliguar t’i përmbush këto detyra:

- 1. Të përgatis dhe ofrojë mësimet, seminarët, ushtrimet dhe format e tjera të ligjëratës;**
- 2. Të përgatitë tekstet universitare dhe literaturën e përshtatshme për studime brenda strukturës së lëndës;**
- 3. Të mbikëqyrë punimet seminarike, punimet e diplomës, punimet e disertacionit e të doktoratës dhe punët tjera kërkimore të studentëve;**
- 4. Të angazhohet në mbikëqyrjen e rregullt me studentët;**
- 5. Të sigurojë mbajtjen pa pengesë të provimeve gjatë afatit të caktuar të provimeve.**

Ky problem është vërejtur dhe shumë instanca pretendojnë se kanë ndërmarrë diçka. MASHT u ka dërguar autoriteteve të UP-së një listë me emrat e mësimdhënësve, të cilët përveç se kanë kontratë të rregullt pune në UP, janë të angazhuar edhe në universitete

private (Epoka e Re 2005: 9). Në mënyrë anonime, zyrtarë të brendshëm përmendin raste kur një njeri mban deri në 14 vende të punës.

Edhe pse punësimi në institucione tjera krahas UP-së është kundër statutit, një gjë e tillë vazhdon për shkak të mungesës së profesorëve. Kuadrot në dispozicion nuk i plotësojnë nevojat e tregut (Rexhaj 2005). Rektori i zgjedhur në korrik të vitit 2006 ka premtuar një ndryshim se dy vende të punës do të lejohen vetëm për “profesorë të lëndëve deficitare” (Hasani 2006: 10). Duke pasur parasysh mungësinë e shumë lëndëve në Kosovë, pothuajse çdo gjë mund të futet brenda konceptit të lëndëve deficitare. Përfundimisht, me vendimin që t’ju lejohet puna me gjysëm orari, situata vështirë që mund të përmirësohet për shkak të pamundësisë së kontrollimit të angazhimeve shtesë.

Pagat

Pagat e personelit arsimor konsiderohen të jenë shumë të ulëta. Për shkak të pagave të vogla shumë të rinj janë të dekurajuar që ta zgjedhin mësimdhënien si karrierë. Në maj të vitit 2002, ishin organizuar demonstrata nga mësimdhënësit për të tërhequr vëmendjen për këtë çështje, e cila nëse nuk do të zgjidhej nga politikbërësit do të mund të shkaktohte dëme afatgjata në cilësinë e arsimit (HDR 2002: 51). Deri në vitin 2005, pagat ishin të pamjaftueshme për të siguruar një standard minimal të jetesës. Si rezultat, një numër i arsimtarëve u angazhuan edhe në punë tjera shtesë ose e lëshuan tërësisht sektorin e arsimit (HDR 2002: 56). Natyrisht cilësia vuajti pasojat. “Tregu e ka vënë në pozitë të palakmueshme Universitetin e Prishtinës. Duhet të ketë një logjikë që sa punon aq edhe paguhesh” (Tahiri 2005). Një nga udhëheqësit e universitetit theksoi se, “Nuk e kisha marrë si problematike mosparaqitjen e profesorëve në ligjërata ndonjëherë, kjo ndodh gjithkund. Ne kemi 5 profesorë që punojnë pa paga” (Thaçi 2005). Edhe vetë studentët e arsyetojnë këtë performancë të ulët, shpesh duke i fajësuar pagat e ulëta që profesorët marrin, vlerësuar rreth 270 deri 300 euro në muaj (para ngritjes) për një doktor shkence dhe shumica prej tyre janë të detyruar të kërkojnë angazhim shtesë jashtë universitetit.

Institucionet private e urrejnë faktin që ata paguajnë më shumë se UP-ja dhe akoma nuk mund të sigurojnë angazhim të plotë të shumicës së profesorëve. Pavarësisht çfarë bën MASHT-i, UP-ja, apo institucionet private, çështja mbetet se, për shkak të numrit të ulët, profesorët mbesin më të fuqishëm. Në sektorin publik ata kanë një fleksibilitet të lartë – ndonëse zyrtarisht të punësuar me orar të plotë, në thelb ata pritet të shfaqen vetëm në orët e tyre të mësimt, dhe pak prej tyre japin më shumë se dy lëndë për një pagë që ata marrin. Në vend të kësaj, ata japin mësim në departamentet tjera ku marrin pagë shtesë. Departamentet rregullisht angazhojnë personel nga departamentet tjera, p.sh. arsimtarët e gjuhëve të huaja nga Fakulteti i Filologjisë, për pedagogji nga Fakulteti i Edukimit, apo për teknologji informative nga Fakulteti i Elektronikës (Elezaj 2006). Faktikisht të gjithë profesorët e Fakultetit të Mjekësisë janë gjithashtu të angazhuar në punë shëndetësore, për çfarë ata mund të marrin 50% si pagë shtesë. Përveç kësaj, ata angazhohen 30% në mësim, 30% në praktikë, dhe 30% në punë shkencore (Dedushaj 2006). Në përgjithësi,

mësimdhënësit paguhen shtesë: për mësim me korrespondencë, provimet që mbajnë, mësimdhënie në huazim fakulteteve tjera, për çdo temë të magistraturës apo doktoraturës që mbikqyrin (250 euro për një temë, dhe mund të kenë deri në dy gjatë vitit), për avancim profesional jashtë vendit, për nostrifikim të diplomave. Pasi që shumë pak prej tyre kanë botuar ndonjë gjë (edhe ata që po, rrallëherë jashtë vendit), mund të arrihet në përfundim se ndonjëri mund të fitojë një pagë prej 150% me më pak se 60% punë.

Mundësia e të hyrave nga pjesëmarrja e studentëve do të përmirësonte pagesën e profesorëve. “Qeveria e Kosovës ka miratuar sistemin e ri të pagave në UP. E veçanta e sistemit të ri të pagave është mundësia ligjore që Qeveria i ka dhënë UP-së për të përdorur për personelin akademik 30 përqind të hyrave vetjake për përmirësimin e pozitës materiale të personelit akademik” (Berisha 2005: 5). Rrjedhimisht pagat janë ngritur gradualisht. “Ne i kemi ngritur pagat dhe jemi në proces të ngritjes së tyre të sërishme,” tha

Pupovci, duke shtuar se pagat, shkojnë deri në 700 euro në rangun më të lartë, mjaft të larta, në një vend ku paga mesatare mujore është rreth 240 euro (Gashi dhe Limani 2006).

Rrogat mujore në rajon në universitete publike dhe private

	Universitetet publike		Universitetet private	
	Nga	Deri në	Nga	Deri në
Maqedoni	250	600	400	1.200
Shqipëri	300	600	25/për orë	50/për orë
Kosovë	170-180	600	20/për orë	30/për orë

Burimi: Hulumtime të KIPRED-it.

Tabela më lartë ilustron që profesorët në Kosovë paguhen ngjashëm sikurse ata në regjion. Për më tepër, ata momentalisht kanë më shumë mundësi për angazhime të shumëfishta dhe kanë shumë më pak konkurrencë nga kolegë të kualifikuar. Ata paraqiten vetëm për disa orë në javë për mbajtjen e atyre lëndëve dhe presin që të paguhen për punë me orar të plotë. Pagat duhet të bëhen në bazë të efektivitetit, për ata që dëshirojnë një punë me orar të plotë, ata duhet që të kenë orar për konsultime, të jenë pjesë e ndonjë grupi punues, shkrimin e projekt-propozimeve për ngritje të fondeve shtesë për fakultetet dhe angazhime të tjera të ngjashme. Mbi të gjitha, është një hap i mirë për të mbajtur rroga bazë të vogla dhe për të ofruar pagesa shtesë në bazë të arritjeve, por deri më tani pagesat shtesë nuk kanë qenë të harmonizuara mirë qoftë me cilësinë apo sasinë e arritjeve, por janë gllabëruar nga ata që kanë lidhje të forta.

Cilësia

Mbi të gjitha, në tërë rajonin, cilësia e mësimdhënësve është në rënie. Sipas një analisti nga Shqipëria, “Niveli i pedagogëve është gjithnjë e më i ulët. Fakultetet dhe departamentet...funksionojnë si feude të shefave...Autonomia e fakulteteve ka shërbyer për forcimin e rretheve dhe klaneve ekzistuese” (Kajsiu 2006: 1). Një gazetar kosovar, Kupina, njëjtë ka ardhur në përfundim se, “I mbyllur hermetikisht për kuadrot e reja, UP-ja është bërë vend i thyerjes së shpresave për profesionistët e rinj që studiojnë jashtë

vendit dhe duan që përvojën e tyre ta bartin në këtë vend që më shumë se asgjë ka nevojë për profesionalizëm”. Pjesë e këtij problemi nuk është vetëm përfundimi që jep Kupina, por gjithashtu edhe mungesa e mësimdhënësve që u përmend më lartë.

Një mënyrë për të tejkaluar këtë krizë është marrja në punë e profesorëve të cilët nuk kanë kredenciale akademike adekuate, por kanë aftësi të kërkuara në tregun e punës. Mjerisht, siç është vërejtur më lartë, mësimi i aftësive nuk është prioritet për menaxhmentin e UP-së, prandaj është logjike që një opcion i tillë shihet si i nevojshëm, edhe pse kjo do të ndihmonte drejt ngritjes së numrit të ligjëruesve potencial, institucionalizimit dhe rregullimit të mësimdhënies me gjysmë orari si dhe do të sjellte mësimdhënie më të mirë të aftësive praktike. Siç ka theksuar një kandidat i magjistraturës në UBT, “Profesori im më i miri ka qenë vetëm inxhinier” (Ejupi 2005). Titujt e lartë kanë mbetur kriteri dominues në dëm të teknikave mësimdhënëse të avancuara. Si rezultat, menaxhmenti sikurse edhe klientët duhet të zgjohen gradualisht nga besimi i verbër në tituj akademikë dhe të vihen në kërkim të aftësive fitimprurëse.

Fatkeqësisht edhe institucionet private kanë vazhduar të fokusohen në tituj të lartë. Zv. drejtori Skënderi nga Universiteti Dardania mburret se aty ligjërojnë rreth 50 doktorë shkencash, prej të cilëve më se 30% kanë kontratë të përhershme pune. Një numër i konsiderueshëm i këtyre profesorëve janë duke punuar në disa institucione. Madje edhe nëse nuk punojnë, emrat e profesorëve të njohur shpesh përdoren vetëm për të tërhequr klientë, një tregues i pasionit të studentëve dhe prindërve pas titujve.

Gjatë dekadës së kaluar ka qenë e vështirë për profesorët dhe ligjëruesit e universitetit që të jenë në dijeni për zhvillimet e reja në fushat e tyre, duke përfshirë mësimdhënien dhe metodat hulumtuese. Për këto arsye, vëmendje e veçantë duhet t’i kushtohet vazhdimi të zhvillimit profesional dhe të personelit aktual të universitetit, sikurse edhe trajnimin e gjeneratës së re të mësimdhënësve të universitetit (HDR 2002: 56). Një student madje thotë se “profesorët duhet të jenë ata që duhet të mësojnë, më shumë se studentët, sepse dija e shumicës prej tyre qartazi ka ngecur në vitet e 80-a”, thotë Arianiti, student i vitit të tretë në Fakultetin Ekonomik.

Mbikqyrja e mësimdhënësve nuk ekziston. “Ibrahim Gashi thotë se sipas rregullores, në bazë të këtij raporti, profesorët që janë vonuar në ligjërata ose kanë munguar, ndëshkohen me heqje të mëditjes.” Mirëpo, sipas një shkrimi deri më tash “nuk është ndëshkuar me zbritje rroge asnjë profesor, meqenëse ishim të kushtëzuar nga pagat e ulëta që merrnin. Por tani e tutje, për çdo vonesë, madje edhe njëminutëshe, do të ndërmerren masa, për shkak se profesorët, pas vendimit të qeverisë për ngritje pagash, paguhën shumë më mirë” (Kadriu 2005: 4). Për më tepër, siç edhe mund t’a dëshmojë autori i këtij punimi, për tri vite, asnjë raport i vetëm nuk është kërkuar nga zyra e Dekanit apo institucion tjetër, qoftë me gojë apo me shkrim, po ashtu asnjë vlerësues nga jashtë nuk ka marrë pjesë në ndonjë ligjëratë. E tepërt të theksohet se edhe në sektorin privat, mbikqyrja e rreptë nuk është edhe aq efektive përderisa ligjëruesit akoma e kanë fjalën e fundit. Fatkeqësisht, shumë pronarë të universiteteve private nuk kuptojnë mirë vështirësitë e

menaxhimit të arsimit të lartë dhe shpesh mbikëqyrin dhe monitorojnë aspekte që nuk kanë të bëjnë me mësimin efektiv.

Edhe avancimi i mësimdhënësve është bërë në mënyrë të gabuar. Se a do të avancohet një profesor apo jo varet nga ajo nëse lënda e vet ligjërohet nga ndonjë profesor tjetër. Dikush mund t'a përfundojë doktoraturën dhe të botojë në revista ndërkombëtare, por përderisa nuk i ipet lëndë të ligjërojë, nuk mund të bëhet profesor dhe paguhet si asistent. Përderisa 5 botime me recension ndërkombëtar kërkohen kërkohen për t'u bërë profesor i rregullt (3 për profesor të asocuar dhe 1 për asistent), pasi të kenë arritur këtë pozitë ata mund të mos botojnë asgjë më tutje. Për fat të keq, botimet nuk llogariten për të përcaktuar shkallën e pagës dhe nuk kërkohen për të ruajtur pozitën e profesorit, siç është praktikë në vende tjera.

Një shembull i bazuar në një përvojë ndërkombëtare ka shpër UP-në në themelimin e një qendre për aftësim të mësimdhënësve (duke ja dhënë emrin e njëjtë si modelit nga Universiteti Shtetëror i Arizonës në të cilin iniciuesi kishte qëndruar një semestër). Një qendër e tillë ka për qëllim që të pajisë profesorët me aftësi të reja, qoftë në aspektin teknik apo në mësimdhënie siç është edhe përdorimi i teknologjive, vlerësimi efektiv, apo promovimi i të menduarit kritik përmes detyrave të shtëpisë. Përkundër faktit se kjo qendër është themeluar (siç thuhet), nuk ka ndonjë dëshmi të ekzistencës efektive të saj. Për të pasur reforma serioze, një qendër e tillë duhet të mundësojë ndryshime thelbësore tek sa më shumë mësimdhënës – duhet të futë mësimdhënie të reformuar e cila duhet të institucionalizohet si praktikë.

Planprogrami

Përderisa më lartë punimi ka trajtuar metodat e mësimdhënies, një çështje tjetër me rëndësi është përmbajtja e përgjithshme dhe lëndët që ligjërohen. Mbi të gjitha, byrokracia dhe inercioni kanë shpër në ngurtësi të planprogrameve, me pak theks në mësimdhënien ndërdisiplinare apo zgjidhje të problemeve kontekstuale. Planprogramet ofrojnë përmbajtje të vjetruar dhe shpërndahen përmes metodave të ligjërimit dhe librave të dala nga përdorimi. Materiali që ligjërohet dhe organizimi i departamenteve nuk pasqyron as kërkesat e forcës punëtore të Kosovës e as interesat e studentëve.

Në UP, shumë lëndë të cilat nuk kanë më vlerë vazhdojnë të ligjërohen. Këto lëndë të panevojshme nga vitet e '70-ta ligjërohen me të njëjtat libra apo skripta të kopjuara nga gjenerata në gjeneratë. Lëndë të tjera vetëm janë riemëruar dhe kjo nuk ka ndodhur vetëm me lëndën Historia e Jugosllavisë e cila është riemëruar në Historia e Ballkanit por gjithashtu edhe me lëndë tjera, si p.sh. të teknologjisë informative. Siç pohon një ish-profesor i Fakultetit të Elektroteknikës, “Shumica e lëndëve e kanë ndërruar vetëm titullin. Disa akoma ligjërohen ashtu siç i kam mësuar unë para 20 vjetëve” (Ilazi 2006).

Probleme të tilla nuk ka vetëm në Kosovë. Madje edhe shtete të zhvilluara si Finlanda përballesh me sfida që planprogramet të kenë “parasysh nevojat e shoqërisë moderne multikulturore, biznesit dhe industrisë ndërkombëtare në aspekt të informatave, aftësive dhe qëndrimeve” (Ministria e Arsimit të Finlandës 2001: 51). Ky është një tregues që këto nuk janë probleme të pazakonshe dhe duhet të zgjidhen si një sfidë shumëvjeçare kundrejt një vizioni (për shkak të ndryshimit të natyrës së afarizmit dhe duhet të jetë nën shqyrtim të përhershëm).

Kur hartohet një planprogram, duhet të kuptohet se me zhvillimin teknologjik, profilet profesionale ndryshojnë gjithashtu –

disa punë të sotme do të zëvendësohen me të tjera nesër. Për t'u përshtatur me një ambient të tillë, madje edhe një plan shumë ambicioz si analizimi i hollësishëm i tregut të sotëm dhe hartimi përkatës i planprogrameve është i pamjaftueshëm. Planprogrami ka nevojë që të reformohet vazhdimisht në mënyrë që të reflektojë ndryshimet në ndërveprimin dinamik ndërmjet arsimit të lartë, shoqërisë dhe tregut. Planprogrami duhet të hartohet në mënyrë që të mundësojë mësimin e aftësive dhe çështjeve që janë të nevojshme dhe “krijimin e bazës së qëndrueshme të dijes që duhet ta zhvillojnë studentët dhe në organizimin e ligjëratave për të bartur këtë në mënyrë të efektshme” (Taylor 1999: 117). I tërë sistemi i arsimit dhe diplomimit duhet të bëhet fleksibil, me përgjegjës ndaj nevojave të tregut dhe të lejojë një përgjigje më të shpejtë ndaj ndryshimeve në tregun e punës. Duhet të përdoren masa nxitëse për shqyrtim të vazhdueshëm të aftësive që ipen. Një hap i tillë paraqet ndryshim të madh nga gjendja e tanishme, por çdo gjë tjetër më e vogël do të ishte tejet e pamjaftueshme dhe humbje e resurseve.

I tërë sistemi i arsimit dhe ai i dhënies së titujve duhet të bëhet me fleksibil dhe të lejojë përgjigje më të shpejtë ndaj ndryshimeve në tregun e punës.

Rezultatet e mësimit duhet të përcaktohen duke listuar aftësi të përgjithshme dhe të veçanta në mënyrë që të sigurohet që një student mesatar i zotëron ato. Një proces i tillë duhet të përfshijë shumë hisetarë, përfshirë punëdhënësit, prindërit, mësimdhënësit, etj.

Për më tepër, planprogrami duhet të bëhet më përgjegjës ndaj forcave të tregut sesa që ka qenë deri më tani. Në këtë drejtim, ndoshta mënyra më e lehtë dhe mjeti më efektiv afatshkurtër për të nxitur ndryshime është futja e lëndëve zgjedhore. Edhe pse me shumë mangësi, UP-ja dhe institucionet e arsimit privat kanë futur konceptin e lëndëve zgjedhore. Në vend që të shërbejnë si nxitës të ndryshimeve, lëndët zgjedhore shpesh lihen në dorë të personelit papërvojë dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm, u ipen më pak kredi dhe praktikisht krijohet një hierarki e lëndëve. Shpesh ekzistojnë vetëm disa lëndë zgjedhore dhe shumica prej tyre janë lëndë obligative që ofrohen nga departamente tjera në të cilat studentët nuk ndjehen të sigurt. Për më tepër, së paku në një departament, drejtuesi i programit të magjistraturës në emër të studentëve ka zgjedhur lëndët zgjedhore, faktikisht duke i shndërruar ato në lëndë obligative.

Një problem tjetër është që informacioni që bartet tek studentët është pothuajse identik. Kjo ndodh për shkak të lëndëve të kufizuara që ofrohen për studim, përdorimit të librave të njëjtë, mungesës së hulumtimit nga studentët, mungesës së praktikave dhe mungesës së lëndëve zgjedhore. Madje edhe shumica e institucioneve private nuk e ka arritur këtë mundësi për zgjedhje, pasi që në përgjithësi vetëm disa lëndë të reja janë shtuar. Mbi të gjitha, këto pak departamente pranojnë numër të madh të studentëve dhe u ofrojnë atyre pak mundësi për tu dalluar nga kolegët e tyre. Si rezultat, mijëra studentë, kopjojnë të njëjtën skriptë, studiojnë të njëjtin material, i tregojnë njëri tjetrit se çfarë i pëlqen profesorit dhe cilat janë pyetjet e mundshme të cilat mund t'u bien në provim. Zakonisht studentëve nuk u kërkohet që të bëjnë projekte hulumtuese. Edhe kur një gjë e tillë ndodh, në mesin e studentëve ekziston përshtypja se këto projekte nuk lexohen dhe që pesha e tyre në notën përfundimtare është shumë e vogël. Projektet grupore janë shumë të rralla ashtu siç janë edhe kërkesat për të bërë praktikë në ndonjë institucion.

Madje edhe studentët të cilëve ju mungojnë aftësitë themelore të dijës për një çështje të caktuar janë të aftë që të përdorin fjalor të avancuar. Ilir Dugolli, ligjërues në Fakultetin e Drejtësisë thotë që shumë studentë përdorin fjalor të avancuar me një logjikë të pakuptimtë. Kur mezi i dha një notë kaluese një studenti të tillë, ai u zemërua. “Siç duket ai ishte mësuar që t’i merrte notat lehtë të profesorë të tjerë, të cilët ndoshta i kanë kush-tuar pak vëmendje dhe përdorimi i fjalorit ka qenë i mjaftueshëm për t’i dhënë atij notë të mirë”, thotë Dugolli.

Mijëra studentë kopjojnë të njëjtën skriptë, studiojnë të njëjtin material, i tregojnë njëri tjetrit se çfarë i pëlqen profesorit dhe cilat janë pyetjet e mundshme në provim.

Tekstet universitare

Mbi të gjitha, politika e tanishme kundrejt teksteve shkollore (gjë që vlen edhe për institucionet private): (a) pranon si normale që studentët nuk mund të lexojnë në gjuhë të huaja, (b) studimi nga një libër i vetëm është i mjaftueshëm, madje edhe për shkencat shoqërore, (c) nuk ka kontroll në përgatitjen e teksteve, (d) pranon studimin në thellësi dhe përmendësh të një materiali të shkurtër. Për më tepër shumë profesorë kushtëzojnë blerjen e librit të tyre përpara se një student të kalojë provimin – libri i përdorur nuk mjafton.

Përdorimi i literaturës së vjetruar është një problem serioz. Përderisa njohja e gjuhës angleze nuk bëhet e obligueshme, profesorët nuk mund të presin që t'i obligojnë studentët që të lexojnë në anglisht. Literatura në gjuhën shqipe është e mangët dhe joadekuate. Për shkak të mungesës së teksteve, shumë profesorë diktojnë materialin e tyre në klasë dhe nëse ky material mësohet mirë një gjë e tillë mjafton për ta marrë një notë të lartë. Ky problem nuk është i pranishëm vetëm në Kosovë por shfaqet në shumicën e vendeve të Ballkanit. Siç e thotë një analist shqiptar “Me përjashtime të pakta, shumica e teksteve të ofruara në shqip janë përshtatje e deformuar e literaturës burimore në gjuhë të huaj. A mund të pretendojmë që jemi universitet kur studentëve u ofrohet diçka e ngjashme si në shkollën e mesme?” (Kajsiu). Për më tepër, në Kosovë, personat që përgatisin tekste të tilla shpesh janë njerëz të afërt me zyrtarë të ndryshëm pranë qarqeve vendimmarëse.

Një rast tjetër fatkeq është se në bazë të statutit, drejtuesit e UP-së insistojnë që profesorët duhet të kenë të botuar librin e tyre dhe pakkush e ka kritikuar këtë aspekt. Një nga dekanët e zgjedhur në vitin 2006, Dekani i Fakultetit të Mjekësisë kërkonte të zbatojë në mënyrë të përpiktë këtë urdhër dhe ka kërkuar që të gjitha lëndët për më pak se një vit të kenë librat e tyre (Dedushaj 2006). Ai tha se, nga 79 kirurgë, është lehtë të shkruhet një libër. Sipas tij, një libër i vetëm është i mjaftueshëm në shumicën e lëndëve. Një dekan tjetër i zgjedhur rishtas, i Fakultetit të Matematikës dhe Shkencave Natyrore, Isa Elezi, beson që tekstet në gjuhën shqipe janë të mjaftueshme dhe të një niveli më se të kënaqshëm (Elezaj 2006).

Kritikët nuk pajtohen. Profesorit nuk guxon t'i imponohet përpilimi i librit, siç parasheh statuti. Për shembull, për rrjetat kompjuterike, një lëndë që do të zhduket bashkë me largimin e të vetmit profesor (Ilazi), 90% të studentëve në botë mësojnë nga dy libra. Nëse profesorit i imponohet hartimi i librit, ai duhet medoemos të bëjë plagjiaturë ose të bëjë një libër shumë më të dobët sesa që do të ishte një i përkthyer. Në një kohë kur ka libra të bollshëm në dispozicion dhe ku për shkencat shoqërore në shumicën e lëndëve një apo dy libra nuk janë të mjaftueshëm, një politikë e tillë është jo logjike.

Vështirësia për të gjetur materialet për lexim është një nga problemet më të mëdha. Kur shumica e studentëve ankohen për mungesë të literaturës, ata nënkuptojnë që libri ose është shumë i shtrenjtë ose është shumë i vjetër sa që shumica e fotokopjeve nuk e kanë atë. Kur studentët thonë që u mungojnë “biblioteka përkatëse” ata nuk kërkojnë shumël-

lojshmëri të materialeve lexuese, por salla leximi. Edhe nëse ka ndonjë libër në departamentet përkatëse, numri i librave është shumë i pakët dhe pakkush ka bërë ndonjë përpjekje të organizuar për t'i vënë ato libra në shërbim të studentëve.

Madje as institucionet private nuk kanë bërë ndonjë përpjekje serioze për të vënë libra në dispozicion të studentëve. Shumica e universiteteve kanë vënë librat kryesor për përdorim në “bibliotekat” e tyre, që në fakt janë salla leximi. Të tjerët u sugjerojnë studentëve që të hulumtojnë në internet, por pak prej tyre japin adresa të caktuara se ku të kërkohet. Shumë pak universitete kanë bërë përpjekje për të siguruar qasje në revistat me pagesë në internet. Disa fakultete janë të pajisura më mirë se të tjerat. Për shembull, Fakulteti i Mjekësisë tani ka një bibliotekë elektronike me libra dhe revista në internet. Ata po ashtu kanë instaluar Laboratorin për Aftësitë Klinike (Dedushaj 2006).

Të tjerët që kanë krijuar biblioteka të specializuara, siç janë Qendra për të Drejtat e Njeriut e Universitetit të Prishtinës, që ofron pajisje moderne pa pagesë, thekson që një numër i vogël i studentëve janë të interesuar që të përdorin burimet e tyre. Disa profesorë kreativ iu kanë dhënë studentëve që kanë njohur gjuhën angleze që të përkthejnë materiale të ndryshme nga anglishtja dhe kanë shpërndarë “skripta” të tilla tek studentët tjerë. Përderisa ka probleme edhe më një praktikë të tillë, kjo së paku ka mundësuar që të ketë në dispozicion literaturë më bashkëkohore dhe ka shmangur diktimin.

Duke ju falënderuar donatorëve të huaj, UP-ja ka vënë një numër të kompjuterëve në shërbim të studentëve, por shumica prej tyre janë bërë të papërdorshëm, janë mbushur me viruse kompjuterike, nuk kanë qasje në internet apo thjeshtë mbahen të mbyllur në mungesë të stimulit për të përdorur ato. Në këtë rast institucionet private kanë shkuar më përpara. Në vitin 2005, AAB-ja ka pasur dy laboratorë me rreth 20 kompjuterë për përdorim nga studentët në çfarëdo kohe, KASHS/Fama 7, Faik Konica 10-12 përdorimi i të cilëve ishte rregulluar me orar.

Menaxhmenti duhet të bëjë një studim të arsyetueshmërisë për këto alternativa: (1) përgatitjen e librave në gjuhën shqipe për të gjitha lëndët, (2) pritjen që studentët të lexojnë në gjuhën angleze nga shkolla e mesme dhe të bëhet njohja e gjuhës angleze kusht për praninë në universitet, apo ndonjë zgjidhje afatmesme e kombinuar. Analiza paraprake këtu tregon se më fitim-prurës do të ishte kushtëzimi i gjuhës angleze sesa përkthimi apo financimi i librave plagjiat. Kështu, njohja e gjuhës angleze në një nivel të mjaftueshëm për të kuptuar materialin lexues do të duhej të bëhej objektiv me prioritet të lartë.

Kuptimi i reformës

Reformat janë gjithmonë të vështira. Ndryshimet sistemore janë gjithmonë të rrezikshme kështu që vijnë në shprehje vetëm në kohë tejet të vështira. Nëse nuk studiohen me kujdes, ndryshimet mund të shkaktojnë dëme të pariparueshme në bazën e tyre të brishtë. Vendet me traditë të lashtë u rezistojnë reformave sepse kanë mendim të lartë për punën që bëjnë, derisa vendet e mëdha u rezistojnë për shkak të shkallës së lartë të problemeve që nënkuptohen dhe resurseve që kërkohen. Reformat më së shumti kanë pasur sukses në vendet si Irlanda apo Malta dhe më pak në Francë dhe Gjermani. Për shembull, Greqia ka pasur probleme serioze me studentët. Në vend të mbajtjes së provimeve, studentët grekë “uzurpuan më shumë se 400 universitete e shkolla teknike dhe vërshuan rrugët me tulla dhe me koktejtë Molotov për të protestuar kundër reformave të propozuara në arsimin e lartë grek”. Fatmirësisht, Kosova është vend i vogël me një universitet publik për të cilin çdonjëri e di fare mirë se në çfarë gjendje të mjerueshme është. Për këtë arsye, këtu nuk është çështja nëse reformat janë të nevojshme por cili është qëllimi i tyre dhe si të zbatohen ato.

Reforma si koncept është pranuar nga UP-ja dhe ka qenë një temë mjaft e përfolur në këto pesë vitet e fundit. Koncepti themelor i reformave ka nënkuptuar zbatimin e Deklaratës së Bolonjës, miratuar nga ministrat evropianë të arsimit, me qëllim përfundimtar harmonizimin e standardeve të titujve akademikë në tërë Evropën. Nga sistemi akademik katërvjeçar ku merrej “diplomë”, UP-ja futi në përdorim sistemin trevjeçar “baçelor”, dhe magjistraturën dyvjeçare.

Përvoja dëshmon se ka shumë studentë dhe profesorë që kanë bindje të gabuar se sistemet e tyre arsimore janë të organizuara pothuajse në mënyrë të përkryer dhe se mungojnë vetëm kushtet materiale (EUA 2002: 10). Edhe në UP është menduar njëjtë se reformat përfshijnë harmonizim me sistemet ndëkombëtare dhe sjelljen e projektorëve në klasë.

Vendet që kanë provuar reforma të vërteta kanë parë kaos dhe pështjellim. “Ishte krejtësisht një rrëmujë. Fakulteti i menaxhimit dhe i biznesit ndryshoi krejtësisht planprogramin dhe sistemin e kredive. Disa lëndë me bazë të njëjtë ishin shkruar në një të vetme; disa ishin anuluar; disa kishin ndryshuar kriteret për të kaluar provimin” (Eddy 2006: 3). Rrëmuja e përmendur më lartë ka ndodhur vetëm në vendet që kanë dashur reforma të vërteta. Në vendet që zgjodhën rrugë graduale apo më të lehtë, reformat janë bërë pa probleme por shumë aspekte kanë mbetur të pandryshuara, siç është dështimi për aplikimin e notimit kumulativ në Slloveni, ku akoma ofrohet mundësia e afateve të shumta për të kaluar një provim. Pasi që në vitin 1999 sistemi i UP-së ngrihej pothuajse nga zeroja, hasi në vështirësi madje vetëm për të rikrijuar sistemin e vjetër, përderisa cilësia dhe reformat janë akoma në nivel retorik.

Si vend i vogël dhe pa traditë në arsim të lartë, reformat në Kosovë nuk ballafaqohen me sfidë politike, por vetëm me atë se si të implementohen .

Ka mjaft kritika mbi vizionin dhe zbatimin e reformave. Një numër i hisedarëve të ndryshëm kanë shprehur pakënaqësi me reformat. Sipas Berim Ramosaj, profesor në Fakultetin Ekonomik, “Universiteti nuk ka arritur të transformohet sipas Kartës së Bolonjës. Përpjekjet e strukturave udhëheqëse të UP-së për reformim kanë qenë shumë

**Reformat e nevojshme siç
përceptohen: kohëzgjatja e
studimeve, ndarja në grupe për
mbajtjen e ushtrimeve, caktimi i
detyrave praktike, sallat e
internetit etj.**

të natyrës kozmetike. Nuk ka pasur reformë rrënjësore. Është bërë vetëm një ndërrim i emërtimeve të kurikulave, ndërsa ka munguar gasja rationale e kuptimit të reformës” (Kadriu 2006: 3). Një këshilltar i kryeministrit ngjashëm ka konstatuar se “UP-ja ka arritur të përmbushë pjesërisht vetëm njërën nga 6 objektivat e këtij procesi e kjo është organizimi

mi i studimeve në dy cikle: cikli universitar dhe cikli pasuniversitar” (Pupovci 2006: 6).

Është interesant të shikohet se çfarë nënkuptojnë hisedarë të ndryshëm të UP-së me fjalën ‘reformë’, si e kuptojnë atë si proces dhe si rezultat përfundimtar. Planprogrami më i shkurtër është menduar të reflektojë studim prej tri vjetëve. Në vend të kësaj, sipas disave në Prishtinë nuk është bërë ndryshim nga planprogrami pesëvjeçar, duke in ngarkuar studentët me një barrë shumë të madhe (Gashi dhe Limani 2006).

Reformat në UP janë shfaqur në një nga mënyrat më të këqija. Pak ose asnjë mendim nuk është marrë qoftë nga politikanët, prindërit, studentët apo profesorët. Përderisa në Evropë reformat kryesisht u nxitën nga politikanët, në UP ato fillimisht ishin nisur nga administratorët ndërkombëtar, të cilët me dorë të hekurt shtynin ndryshimet strukturore, për t’ju lënë këto në dorë pikërisht administratës e cila frikësohej se do të margjinalizohet. Ata nuk e kanë pasur idenë se çfarë të bëjnë dhe kanë bërë pak ndryshime thelbësore. Kjo ndjenjë simbolike e reformës fillimisht ka ardhur nga administrata, ndryshimi i studimeve nga katër në tri vjet, futja e testeve si trend i sistemit të notimit dhe këtu ka përfunduar reforma. Për më tepër, UP-ja nuk ka ofruar fare apo pak, sa i përket aspektit të trajnimit dhe zhvillimit profesional të mësimit, duke i kushtuar pak kujdes reformës së vetë profesorëve. Siç është cekur më lartë, nuk ka pasur reformë në zhvillimin e orëve të mësimit dhe në dhënien praprake të materialeve për lexim.

**Katër lloj studentësh
akoma presin të
diplomojnë sipas
planprogramit të kohës
së tyre nga vitet:**

- ⇒ ‘80,
- ⇒ ‘90,
- ⇒ ‘99-03
- ⇒ **Bolonja.**

Një arsyetim i shpeshtë ka qenë se implementimi i Deklaratës të Bolonjës është në proces e sipër por problem paraqesin resurset. “Gjenerata e parë që kanë diplomuar me reforma, sistemi është zbatuar por ka mungesë të literaturës, mbajta e ligjëratave dhe ushtrimeve është në rregull” (Fetahu 2005). Sipas Sejdi Hoxhës probleme tjera janë “kohëzgjatja e studimeve, ndarja e studentëve në grupe për mbajtjen e ushtrimeve, caktimi i disa detyrave praktike për studentë, krijimi i sallave të internetit e çështjet të tjera” (2005).

Tjetër gjë thuhet në letër por “fakultetet nuk po i përcjellin vendimet e reja, si p.sh. që çdo fakultet të ketë nga një ekspert për marrëdhënie me jashtë” (Tahiri 2005). Shumë artikuj të gazetave arsyetojnë “reformofobinë” për shkak të zhvillimeve të reja, rrogave të vogla, dhe për atë se personeli i universitetit nuk është i “pajisur” që të jetë në trend me zhvillimet bashkëkohore. Madje edhe Ministri Veliu konsideron si pengesë për zbatimin e reformave “mentalitetet që nuk e ndjejnë nevojën për të evoluar në mënyrë pozitive dhe kreativisht” (Rexha 2006: 39).

Ndërkombëtarizimi i arsimit:

- **ligjërimi në gjuhë të huaja**
- **themelimi dhe përmirësimi i administrimit të marrëdhënieve me jashtë**

Mund të thuhet se reformat në rend të parë shfaqen në aspekt të gjatësisë së studimeve duke ju përcaktuar lëndëve vlerën e kredive pa ndonjë analizë të sasisë së angazhimit të studentit në lëndë.

Siç thekson Dekani i Fakultetit të

Mjekësisë, “në mjekësi mesatarja e studimeve 6 vjeçare shkon në 13 vjet. “Për më tepër, për 36 vjet askujt nuk i është marrë e drejta për studim” (Dedushaj 2006). Me qëllim të harmonizimit të sistemit me ato të Evropës, puna është duke u fokusuar kryesisht në letra dhe në perceptimin nga jashtë. Fatkeqësisht, në mësimdhënie nuk po ndikohet fare. Përveç se reformat lënë shumë për të dëshiruar, gjithashtu ka mungesë të komunikimit, që pjesërisht nxitet nga drejtuesit e universitetit të cilët kanë tendencë që të shesin gjithfarë si pjesë të Bolonjës. Pengesa tjera për reforma kanë qenë: rrogat, çështje që pjesërisht është rregulluar, si dhe numri i madh i studentëve. Shkaqet për këtë janë të shumta, por në mes tjerash, janë mungesa e reformave, organizimi joadekuat i ligjëratave, ushtrimeve, ofrimi i mundësive të pakufizuara për të hyrë në provim, përkushtimi i pamjaftueshëm i studentëve në mësim, i ligjëruesve ndaj studentëve, vijimi jo i obligueshëm, si dhe planprograme hutuese.

Reforma e prindërve dhe studentëve

Çuditërisht, studentët së bashku me prindërit e tyre gjithashtu janë pengesë për reforma. Të mësuar me shumë mundësi për të kaluar provimin dhe mekanizma të bollshëm për përmirësim, shumë studentë parapëlqejnë vetëm disa aspekte të reformave, më së shumti shndërrimin në studime 3-vjeçare si dhe testet ku profesorët ndikohen më pak nga tiparet personale të studentëve. Disa ligjërues që janë përpjekur të bëjnë reforma të mirëfillta kanë dështuar. “Kam provuar ti inkurajoj studentët për leximin e mësimëve para ligjëratave por nuk funksionon, studentët nuk lexojnë as 300 faqe në javë” (Gashi 2005). Kjo nuk do të ndryshojë përderisa motivi për të ardhur në universitet mbetet ai jo-akademik. “Për shumicën e studentëve ardhja në universitet është ardhje në kryeqytet – një mundësi për punë, një mundësi për tu larguar nga fshati, etj, etj.” (Zeneli 2003: 8). Për profesorët, Zeneli ka përfunduar se motivimi parësor i tyre është që të kenë “një status të ri në shoqërinë e sëmure nga titujt”.

Studimet mesatare në Mjekësi: 13 vjet. **“Mësim gjatë gjithë jetës” apo “në fakultet gjatë gjithë jetës”?**

Prindërit po ashtu mbajnë pjesën e tyre të përgjegjësisë. Për shkak të nivelit të lartë të obsesionit me arsimin e lartë, në veçanti me diplomat, me qëllimet më të mira, shumë prindër këshillojnë fëmijët e tyre që të mos punojnë dhe të fokusohen vetëm në mbarimin e studimeve të tyre, që është e kuptueshme duke pasur parasysh që studimet shpesh zvarriten pafundësisht. Përfundimisht, ajo që nevojitet është identifikimi i qëllimeve afatmesme dhe afatgjata, skalitja e reformave si pjesë e misionit dhe përgatitja e udhëzimeve të qarta ku dhe si të shkohet përpara si dhe të kuptohet reforma si një proces që nuk përfundon kurrë.

Të drejtat e studentëve

Unioni i Pavarur i Studentëve të Universitetit të Prishtinës (UPS) është organizata më e vjetër studentore, për 17 vite që nga themelimi i saj ajo ka qenë organizata e vetme që ka marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes në fakultete dhe në Senatën e UP-së. “Në Senat ne jemi të përfaqësuar me 7 anëtarë dhe aty ne përfaqësojmë kërkesat e studentëve në fusha të ndryshme akademike, kërkojmë reforma të vërteta, kualitet më të mirë të mësimdhënies dhe përmirësim të infrastrukturës në Universitet” (Hoxha 2005). Tani ka edhe organizata tjera. “Organizata e Re Studentore (ORS) merret me problemet e studentëve, jetën kulturore, argëtimin dhe sportin” (Fetahu 2005). Një tjetër asociacion, Asociacioni Kosovar i Studentëve të Psikologjisë (KOAPS) që ka shtrirje vetëm brenda një departamenti është më i veçantë. “Ne kemi një mori punësh me kërkesa të studentëve. Ne kemi një bashkëpunim të mirë me profesorët e departamentit tonë, ne përcaktojmë orarin e ligjëratave, të provimeve, dhe përdorim sallën e mbledhjeve të profesorëve” (Thaçi 2005). Roli primar i Asociacionit Kosovar të Studentëve të Shkencave Politike (ASSHP) është informimi i studentëve me zhvillimet më të reja në Departamentin e Shkencave Politike, reformat në universitet dhe zhvillimet politike në Kosovë. Kjo organizatë poashtu shpërndan artikuj për të drejtat e studentëve, bazuar në Statutin e UP-së, veçanërisht sa i përket sjelljeve në provime, etj. (Gashi, E. 2005).

Gjatë hulumtimit për këtë punim, shumica e studentëve të intervistuar preferonin të mbesin anonim, duke përfshirë edhe ata që studiojnë në institucione private. Kjo dëshmon një strukturë të ç'ekuilibruar të fuqive ku studentët e rëndomtë kanë shumë pak fuqi. Në anën tjetër, unionet e superfuqishme të studentëve bëjnë më shumë politikë sesa fushatë për të drejtat e studentëve dhe për shërbime më të mira. Kur është intervistuar një përfaqësues i UPS-së, problemi i parë që është përmendur nga ai ka qenë zgjedhja e rektorit. Është bërë si rregull që këto organizata të merren më shumë me problemet makro-politike të UP-së dhe ngurrojnë të merren me probleme praktike (Shala 2005:6).

Ky politizim dhe “mision i lartë” i arsimit të lartë fatkeqësisht është mjaft i pranishëm në mesin e udhëheqësve të studentëve. Kjo është më të vërtetë për të të ardhur keq, sepse me 7 anëtarë në Senat, studentët janë tejet të fortë (krahasuar me 2 për çdo fakultet). Pasi që kishin pushtet, arritën të shndërrohen në votë vendimtare për të zgjedhur rektorin. Përderisa arritën të bëhen faktor vendimtar për politikë universitare, ata dështuan që të përdorin këtë fuqi për të shtyrë reforma të mirëfillta. Se studentët janë bërë një grup me ndikim të madh tregon edhe kërkesa e fundit e Parlamentit të Studentëve për 39.300 euro për shpenzime të katër anëtarëve të personelit, kërkesa për 370.000 euro për shpenzime të të gjithë anëtarëve të Parlamentit të Studentëve dhe kërkesa për të menaxhuar të gjitha kafeteritë e studentëve. Sipas z. Elezaj, Dekan i Departamentit të Shkencave Matematiko-Natyrore, një rektor që është zgjedhur me votat e studentëve nuk mund të zbatojë statutin e UP-së. Ai ka përmendur këtë arsye për shkak të dështimit të Rektorit Bajrami për të zbatuar statutin e UP-së dhe ka shprehur dyshime se një shkallë kaq e lartë e fuqisë së studentëve do t'ia pamundësojë edhe rektorit të ri që t'ë zbatojë plotësisht

statutin. Për të pasur reforma kuptim, ndoshta zvogëlimi i ndikimit të përfaqësuesve të studentëve është gjëja e parë që duhet bërë.

Notimi

Ngjajshëm me provimet pranuese dhe planprogramin, notimi është një aspekt tjetër madhor që ndikon në aftësitë dhe vlerat që barten tek studentët. Në vend të matjes (dhe nxitjes) së aftësive, ajo në rastin më të mirë matë mësimin përmendësh, dhe në rastin më të keq edhe plagjiaturën, njoftësitë, dhe shërbime tjera. Notimi është një nga përfituesit kryesorë të reformave që praktikohen individualisht nga profesorët. Disa profesorë kanë hequr nga përdorimi mënyrën e papërshtatshme të notimit tradicional me copa letre “me tri pyetje” duke e zëvendësuar atë me teste. Natyrisht që kjo është një lëvizje përpara dhe është konsideruar si e qëlluar nga studentët. Megjithatë, kjo akoma nuk ka arritur që të krijojë përqendrimin tek aftësitë dhe ta ndryshojë mënyrën e punës së studentëve.

Mungesa e evidencës së pjesëmarrjes dhe formave tjera të përfshirjes së studentëve ka bërë që fakultetet të mendojnë për filtra të ndryshëm. Fakulteti i Mjekësisë ka tri faza për notim: (a) praktikën, (b) testin, (c) provimin me gojë, secili nga këto mund ta rrëzojë studentin nga provimi. Një sistem i tillë lë peshë të madhe tek provimi final, siguron pak nxitje për punë dhe shumë mundësi për dështim. Gjatë kohës kur i ndjekin ligjëratat, shumë studentë janë akoma duke mësuar për ti kaluar provimet ligjëratat e të cilëve i kanë dëgjuar dy vite më herët. Disa ditë pasi që ishte zgjedhur dekan i ri i Fakultetit të Mjekësisë, në kohën kur u intervistua ishte në shqyrtim të mundësisë së futjes në përdorim të lëndëve modulare bllok sistem – të cilat zgjasin një muaj dhe provimet mbahen menjëherë pas përfundimit të ligjëratave (Dedushaj 2006).

Në këto aspekte, gjendja në institucione private duket pak më e mirë edhe pse disa institucione private janë formuar sipas model-it të UP-së, ku i tërë notimi varet në një provim të vetëm. Disa institucione private janë munduar të bëjnë reforma përmes futjes së sistemit të ndërtimit të notës (provimet mes-semesterale dhe punimeve me shkrim), ndërsa e kanë ruajtur mundësinë tradicionale për studentët që janë me pak të disiplinuar. But Dedaj, një ndër profesorët e rinj të reformuar, pohon se provimi në kolegjin “FAMA” mbahet në bazë të sistemit të grumbullimit të notës dhe provimi i fundit ka vetëm 20% peshë të notës përfundimtare. Sidoqoftë, provimet gjithëpërfshirëse pastaj ju ofrohen atyre që nuk e kanë kaluar pjesën e parë – praktikisht ata kalojnë pa u dënuar.

Një model i sugjeruar për notim:

- | | |
|---------------------------|-----|
| (a) Pjesëmarrja: | 5% |
| (b) Prezantimi | 5% |
| (c) Punimi 1: | 10% |
| (d) Punimi 2: | 20% |
| (e) Detyrat e shtëpisë: | 15% |
| (f) Provimi i mesëm: | 20% |
| (g) Provimi përfundimtar: | 25% |

Shënim: nuk funksionon me më shumë se një afat të të provimeve.

Se sistemi i ndërtimit të notës është meritë individuale tregon fakti se shumica e profesorëve të cilët e kanë përdorur këtë metodë thonë se kanë bërë një gjë të tillë me nismë të tyre, e jo sepse u është imponuar nga drejtuesit. Pasi që këto metoda nuk janë institucionalizuar, shumica e profesorëve nuk i praktikojnë ato. Është e çuditshme se si as vendi

Studentët që dështojnë në ndërtimin e notës, e kanë privilegjin për të hyrë prapë në provim, këtë radhë me vlerë 100%.

më i zhvilluar i ish-Jugosllavisë, Sllovenia, nuk ka guxuar të ndërhyjë në këtë çështje por ua ka besuar atë profesorëve, që ka rezultuar me efekte gjysmake.

Për më tepër, notimi nuk është i standardizuar dhe zakonisht profesorëve nuk u ipet asnjë udhëzim. Studentët shpesh kanë të bëjnë me profesorë që japin 10-she me skripta 55 faqëshe dhe me të atillë

që kërkojnë shumë libra për të lexuar dhe konsiderojnë që nota mbi 8 është e rezervuar vetëm për ata që dinë sa profesori.

Në shumicën e institucioneve private, për qëllime fitimprurëse, vërehet tendenca për të mos i rrëzuar studentët nga provimet. Një student nga "Dardania" ka deklaruar që notat në këtë institucion merren shumë lehtë, dhe kriteret për të kaluar janë shumë të ulëta (R. B. 2005). Në thelb, janë të njëjtit profesorë të cilët mbajnë ligjëratat dhe provime në të njëjtën mënyrë si në UP, por këtu në një mënyrë më të sjellshme. Është e qartë se ata ligjërojnë pak a shumë të njëjtin material që kanë ligjëruar me vite të tëra, por tani kanë hartuar plan të lëndës (syllabus) dhe mundohen të jenë më të sjellshëm me studentë dhe të shkojnë në ligjëratat me kohë.

Kontrollimi i punimeve dhe testeve ende konsiderohet si një ngarkesë shtesë që nuk mbulohet me pagë të rregullt, kështu që shumë prej tyre përdorin metoda që ua kursejnë kohën siç është metoda e testimit të studentëve me tri pyetje që tërhiqen nga një grumbull. Pasi që UP-ja dhe shumica e institucioneve private u ofrojnë mundësinë studentëve të mbajnë një provim pesë herë në vit, ekziston një nxitje e fortë që ata të mësojnë shumë mirë vetëm një pjesë të vogël të materialit, duke shpresuar që do t'ju qëllojnë tri pyetjet që i dijnë njërën prej herave të shumta që i nënshtrohen provimit, mënyrë kjo e cila nuk kontribuon në kuptimin logjik të materialit të ofruar.

Shumica e studentëve studiojnë për provimet për të cilat ligjëratat i kanë dëgjuar vite më herët.

Një trend tjetër fatkeq është se para se të vendosin për nota, shumica e profesorëve së pari shfletojnë indeksin e notave për të shikuar notat tjera, që gjithsesi ndikon në notim. Si rezultat i kësaj, shumë studentë i janë përshtatur teknikës për të mësuar shumë në vitin e parë, pasi që kjo teknikë ka dëshmuar se është teknikë fitimprurëse në marrjen e notave në vitet vijuese.

Mund të përfundohet që praktikatat e tanishme të notimit edhe më tepër mundësojnë mësimin përmendësh, mbështetjen në fat, plagjiaturën, hyrjen në provim shumë herë duke provuar fatin, apo njoftësitë. Për përmirësim të gjendjes është e domosdoshme që

studentët të mos kenë më shumë se dy afate, dhe dështimi në afatin e dytë nënkupton që studentit duhet të përsërisë vitin. Për më tepër, dy dështime do të duhej që automatikisht ta diskualifikojnë studentin nga mundësia për të fituar bursë.

Profili: Aftësitë kundrejt përmbajtjes

Një nga pengesat më të mëdha në sistemin arsimor të Kosovës është obsesioni me “shkencën e lartë” dhe mospërqendrimin në njohuritë që i nevojiten sektorit të punës apo mësimit gjatë gjithë jetës. Profesorët dhe dekanët e UP-së i shikojnë me përbuzje lëndët

Të diplomuar si % e studentëve të regjistruar		
	Meshkuj	Femra
Filozofik	6%	5%
Mat-Natyrore	7%	5%
Filologjik	11%	11%
Juridik	9%	9%
Ekonomik	22%	21%
Ndër/Arkit	2%	7%
Elektro	3%	2%
Makineri	3%	2%
Mjekësi	12%	7%
Arte	9%	7%
Bujqësisë	5%	8%
Xeh/Metal	7%	8%
Kul Fizike	8%	3%
SHL Ped PR	30%	12%
SHL Eko PE	11%	6%
SHL Tek Mi	8%	1%
SHLP XHD PZ	7%	12%
SHL Ped GJA	24%	15%
SHLP Ske GJI	13%	13%

* Ilogaritur nga të dhënat zyrtare të UP-së

siç është shkrimi, anglishtja apo lëndët që kanë të bëjnë me teknologjinë informative (TI). Qëndrimi i tyre është se aftësitë e tilla ju përkasin “kurseve” (duke kuptuar nivel më të ulët), dhe që edhe nëse duhet të mësohet një gjë e tillë, kjo duhet të bëhet në shkolla private dhe nuk e ka vendin në universitet.

Përshkrimi i rezervuar vetëm për studentët më të mirë: “e tha mësimin si bilbil”.

Pakkush mund të kundërshtojë nevojën për të qenë në gjendje të paktën për të lexuar anglisht (veçanërisht në Kosovë ku ka mungesë të madhe të librave), për të shkruar (që është thelbësore për përvetësim të informatave dhe për zhvillim të mendimit kritik) dhe aftësitë kompjuterike.

Ndonëse suksesi në ekonominë e dijes mund të jetë një cak tejet afatgjatë për Kosovën, ka shumë caqe afatshkurtra që mund të përmirësojnë situatën. UP-ja nxjerr “shkencëtarë”, shumica e të cilëve bëjnë punë sekretarësh, e pak prej tyre punë shkencore (Dika 2006). Duke pasur parasysh që të diplomuarit janë duke bërë punë sekretarie, punëdhënësit e kanë shumë të vështirë që të punësojnë sekretarë të mirë përderisa asnjë institucion nuk arsimon një profil të tillë.

Një aspekt i rëndësishëm i përqendrimin në aftësi është nxitja e studentëve të mësojnë se si duhet mësuar. “Lidhja ndërmjet mësimit gjatë gjithë jetës dhe mirëqenies kombëtare, në dekadën e fundit [’90-ta], është bërë pjesë e politikës kombëtare në shumicën e vendeve të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD)” (Taylor 1999: 122). Edhe pse shumë profesorë përsërisin

moton se nuk kërkojnë “mësim përmendësh”, përshkrimi fjalë për fjalë i ligjëratave të tyre në provim është dëshmuar të jetë teknika më e mirë. Thënia shpesh e cituar “e tha mësimin si bilbil” mbetet vlerësim vetëm për studentët më të mirë.

Në rastin më të keq, universiteti prodhon një armatë të studentëve që kryesisht janë përpjekur që të mashtrojnë sistemin dhe të kalojnë sa më lehtë që të jetë e mundur – në rastin më të mirë ata kanë mësuar përmendësh të njëjtin material dhe nuk kanë aftësi grupore. Ata janë konkurrentë në punë dhe bujarë në të mashtruar, ju mungon zgjidhja e problemeve dhe aftësive praktike dhe kështu janë të dobët në zbatimin praktik. Sipas një artikulli, për shkak të mungesës së aftësive praktike, një i diplomuar mesatar i ekonomikut nuk është në gjendje që të plotësojë një aplikacion bankar apo administrativ, aftësi këto që më mirë zotërohen nga ata që kanë diplomuar në një shkollë të mesme ekonomike (Kadriu 2005: 4). Atyre ju mungon baza teorike por janë të mirë në përdorimin e fjalorit teorik retorik. Për shkak të mundësive të kufizuara për zgjedhje të drejtimit, lëndëve zgjedhore, hulumtimeve të pakta, praktikave apo aftësive të punës grupore, mijëra studentë marrin të njëjtat informata dhe rrjedhimisht zhvillojnë të njëjtat aftësi.

Sa më saktësisht që transmetohen fjalët e profesorit në provim, aq më e lartë nota.

Aftësitë e reja

Aftësitë e vjetëruara apo ndoshta që asnjëherë nuk kanë qenë të nevojshme, të cilat u përmenden më lartë, janë vetëm pjesë e problemit. Mungesa e aftësive teknike dhe udhëheqëse, veçanërisht tek rinia e shumë të papunësuar është serioze dhe duhet të kompensohet me një seri të aftësive që njihen si

Studentët duhet të jenë në gjendje të:

- a. përballojnë dhe kuptojnë materialin e ri
- b. të krijojnë mendim mbi çështjen
- c. të prezantojnë dhe mbrojnë në pikëpamjen e tyre para një eksperti
- d. paraqesin qëndrimin e tyre në mënyrë të argumentuar mirë dhe në punim të strukturuar

...brenda një afati të shkurtër kohor .

“aftësitë e reja themelore”. Observatoriumi i Kosovës për Punësim dhe Trajnim ka potencuar se sot nevojiten aftësi të ndryshme: “Këto aftësi të reja bazike përfshijnë aftësitë komunikuese dhe operacionale që kanë të bëjnë posaçërisht me aftësitë për teknologjinë informative dhe komunikimit. Aftësitë e ndërlidhjes, aftësitë e zgjidhjes së problemeve, ndërmarrësia dhe aftësia e aplikimit të njohurive në vendin e punës. Këto janë aftësi të rëndësishme për punësim sepse ato e rrisin zotësinë në punë” (Observatoriumi i Kosovës për Punësim

dhe Aftësime 2004: 18). Siç sygjeron kjo organizatë “Zhvillimi i aftësive të reja, adaptimi i fuqisë punëtore në një ambient më konkurrues, nevoja për aftësi bazike më të larta dhe

aftësitë e teknologjisë informative nuk shikohen si përgjegjësi e punëdhënësit por si përgjegjësi individuale, e sistemit të arsimimit dhe trajnimit ose qeverisë” (Observatoriumi i Kosovës për Punësim dhe Aftësi 2004: 20).

Një prej aftësive të tilla që duhet të përvetësohet në nivelet para-universitare është njohja e gjuhës angleze. Është një praktikë standarde nëpër Evropë që studentët e vitit të parë pritet të jenë në gjendje që të zotërojnë gjuhën angleze. Fatkeqësisht, edhe pse çdo student ka mësuar anglisht për së paku tetë vite në nivelin para universitar dhe vazhdon të bëjë një gjë të tillë edhe në atë universitar, ata protestojnë nëse u caktohet që të lexojnë në gjuhën angleze. Një profesor që u përpoq t’u japë studentëve material të lëndës në një gjuhë të huaj ka hasur të njëjtin problem madje edhe në nivelin e magistraturës. “I kam 10 studentë në nivelin masters. I kam shtyrë të lexojnë në gjuhë të huaja. Kur i pyeta se sa dinë gjuhë qoftë anglisht, gjermanisht, frëngjisht, italisht, kroatisht, vetëm një nga ata 10 e dinte njëren” (Elezaj 2006). Si rezultat, fakultetit i imponohet që të lejojë përdorimin e gjuhës angleze vetëm në lëndët zgjedhore dhe kur e bën një gjë të tillë këto lëndë mbesin me pak studentë.

Për mësimin e disa prej këtyre aftësive nevojiten fonde shtesë por për disa prej tyre jo. Ndryshimi thelbësor që nevojitet është ndryshimi i qëndrimit kundrejt këtyre aftësive. Kjo së paku do të hapte rrugën për ndryshime që nuk marrin burime shtesë për zbatim. Një shkallë më e lartë e lirisë për profesorët do të hapte rrugën për një varg teknikash të reja. Për shembull, me futjen në përdorim të punës praktike jo vetëm që do të përfitonin studentët dhe punëdhënësit por gjithashtu do të kurseheshin kapacitete të personelit mësimdhënës të universitetit. Praktika e tillë nuk ka nevojë të paguhet, në fund të fundit, kjo shërben për të marrë kredi nga institucioni i tyre arsimor dhe numërohet si lëndë. Shumë studentë eventualisht punësohen në ato institucione ku e bëjnë praktikën por kjo nuk duhet të bëhet kusht apo të pritet një gjë e tillë si obligim, siç ka qenë në vitet e ’80.

Me përparimet teknologjike dhe me lehtësinë e arritjes tek informatat, theksi duhet të ndryshohet në aftësimin dhe pajisjen e njerëzve që të jenë në gjendje që të fitojnë njohuri përgjatë tërë jetës së tyre.

Teknologjia informative

Më keq se me gjuhën angleze qëndron puna me aftësitë kompjuterike të cilat nuk mësohen fare. Nëse profesorët japin detyra me shkrim, ata duhet të pranojnë punime të shkruara me dorë, përndryshe shpejtë do ta kuptojnë se studentët paguajnë për përdorim të kompjuterëve dhe printerëve nëpër *internet caffè* apo kolegët e tyre që t’i shtypin punimet për ta. Disa institucione private ofrojnë kurse pa pagesë për aftësi kompjuterike. Edhe pse kjo nuk llogaritet në kompletimin e kredive ky është një atraksion shtesë për studentët.

Njohja e teknologjisë informative si një fenomen i ri nuk është i kufizuar vetëm në Kosovë. Përdorimi i TI-së është vështirë të zbatohet jo vetëm për shkak të pajisjeve të

shtrenjta që kërkohen por gjithashtu për shkak se shumë profesorë nuk janë entuziastë për një gjë të tillë pasi që ata vetë nuk janë të aftë për të. Madje edhe në botën e jashtme “në përgjithësi studentët zakonisht janë më të dijshtëm sesa mësuesit e tyre kur është në pyetje zhvillimi i aftësive [të TI-së]” (Taylor 1999: 117). Prandaj është e kuptueshme që “Shumë profesorë të Universitetit të Prishtinës nuk e përdorin internetin për nevoja shkencore dhe universitare” (Veseli 2006: 10).

Pa marrë parasysh problemet e gjeneratave me kompjuterë, është e padiskutueshme që TI-ja mund të transformojë natyrën e ligjërimit dhe të mësim-it – t’iu ndihmojë profesorëve që të bëhen katalizatorë dhe studentëve të bëhen studiues të pavarur. Siç është cekur në një studim “Për të garuar në mënyrë të suksesshme në një mjedis shpejt të ndryshueshëm, me informata të bollshme dhe me një teknologji në rritje, studentët duhet të jenë shumë të aftësuar dhe fleksibil në përdorimin e teknologjisë në të gjitha format (Teknologjitë e Mësimi në Shkollat Viktoriane, 1998-2001, 1998: 8).

Duke ndjekur shembullin e “tigrave aziatik” në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar, disa vende kanë bërë përpjekje serioze në bërjen e TI-së dhe arsimit që të shkojnë në dobi të tyre. Shumica e shteteve të mëdha kanë kuptuar se ato duhet të futen në ekonominë e dijes dhe janë duke punuar seriozisht që kjo të ndodhë dhe të sigurojnë investimet për këtë qëllim. Madje edhe shtetet shumë të zhvilluara janë duke u përpjekur që të mbesin konkurrentë dhe shpesh e kuptojnë që kanë humbur për shkak të mos reformimit të sektorëve të arsimit.

Përpjekjet për të fuqizuar shoqërinë dhe rritur nivelet e zhvillimit njerëzor janë të lidhura drejtpërsëdrejti me aftësinë e saj për të përvetësuar një sërë teknologjish dhe përparimesh shkencore për nevojat e banorëve të saj. Përvetësimi i njohurive të reja dhe zbatimi i tyre është thelbësor për zhvillimin ekonomik, kështu që vendet që investojnë pak në arsim do të dobësohen.

Qëndrimi se UP-ja është e rezervuar vetëm për shkencë “të lartë” lë pas dore faktin se pa këto aftësi të “ulëta” studentët nuk mund të fillojnë të zhvillohen profesionalisht për

Drejtimet më të shpeshta:

Shkenca politike: Dardania, FAMA (Prishtinë, Gjilan, Prizren), UBT, UNIVERSUM, Universiteti i Prizrenit, UP.

Drejtësi: AAB, Dardania, FAMA (Prishtinë, Mitrovicë, Gjilan, Prizren), UNIVERSUM, Kolegji i Biznesit, Iliria, Universiteti i Prizrenit, EVU, UP.

Ekonomi: AAB, Dardania, FAMA (Prishtinë, Mitrovicë, Gjilan, Prizren), UBT, Kolegji i Biznesit, Iliria, Universiteti i Prizrenit, EVU, UP.

Administrim biznesi: AUK, AAB, Universiteti i Prizrenit, UBT, (Fakulteti i shkencave të aplikuara të biznesit në Pejë në kuadër të UP-së).

Hoteleri dhe Turizëm: UBT, UNIVERSUM, Pjetër Budi, (Fakulteti i shkencave të aplikuara të biznesit në Pejë në kuadër të UP-së).

Psikologji: Dardania, UBT, UNIVERSUM, ILIRIA, Universiteti i Prizrenit, UP.

tregun e sotëm të punës dhe atë të ardhshëm. Në mënyrë strategjike, Kosova nuk ka nevojë që verbërisht të përqëndrohet në të ashtuquajturën shkencë të lartë por në zbatimin e shkencës të zhvilluar diku tjetër. Mësimdhënia duhet të jetë më tepër e orientuar nga praktika dhe në rend të parë e hartuar që të pajisë studentët më aftësitë që nevojiten në vend të punës, qoftë në Kosovë apo jashtë saj. Mbi të gjitha, Kosova ka nevojë për profesionistë që janë të aftë të zbatojnë detyra të ndryshme dhe ju përket universiteteve që të krijojnë këto profile. Institucionet e arsimit të lartë duhet ta shmangin qëllimin dhe pretendimin për nxjerrjen e “shkencëtarëve me diplomë fakulteti”, por ato duhet të nxjerrin profesionistë që kanë aftësitë themelore në fushën e tyre, kanë aftësi të mjaftueshme analitike dhe problem-zgjidhëse, që kanë pasur përvojë me një punëdhënës si pjesë e studimeve të tyre dhe që do të flisnin rrjedhshëm anglisht krahas njohurisë së një gjuhe të dytë.

Planifikimi i karrierës

Veçmas aftësive të gabueshme që institucionet e arsimit të lartë bartin tek studentët, universitetet nuk bëjnë asgjë për t’u ndihmuar studentëve për të gjetur punë apo për të krijuar marrëdhënie me ish-studentët. Ndodh fare rrallë që institucionet e arsimit të lartë të kërkojnë nga studentët që të shkojnë në praktikë apo të trajnojnë studentët e tyre se si shkruhet një CV apo si shkruhet një letër që shpreh interes për punë apo për studim të mëtuftjeshëm. Kjo tregon që institucionet nuk preokupohen me suksesin e studentëve të tyre pas diplomimit. Në

vendet tjera, në mesin e indikatorëve që përdoren për të vlerësuar dhe renditur një institucion është ajo çfarë arrijnë të diplomuarit e vet, në mes tjerash, sa shpejtë ata gjejnë punë. Një mekanizëm i tillë mund të jetë i pamundur për Kosovën sot ku nuk ekzistojnë as statistikat

Një pamje më e mirë e perceptimeve të studentëve në lidhje me mundësitë për punësim si dhe për fitim, mund të vërehet nga kjo tabelë:

	Konkurrojnë	Pranohen	Dallimi
Filozofik	800	265	535
Shkenca Matematiko-Natyrore	174	330	-156
Juridik	1636	800	836
Ndërtimtari/ Arkitekturë	156	66	90
Inxhen. Elek. dhe Kompj.	198	80	118
Kulturë fizike dhe sport	266	120	146

themelore për numrin e popullsisë. Megjithatë, një mekanizëm duhet të krijohet ku ministria, studentët dhe prindërit e tyre mund të përcjellin të arriturat e universiteteve dhe degëve të veçanta. Sidoqoftë, Kosova është një vend i vogël dhe shpesh fjala e gojës është reklama më e mirë për dikë që përpiket të shesë shërbimet e veta. Me një shtytje më të mirë për t’u përkujdesur për të arriturat e të diplomuarve të tyre, së paku institucionet private mund të shohin një interes në përgatitjen e studentëve të tyre për karrierë. Duke qenë në gjendje për të demonstruar që ata janë duke ja dalë më mirë se mesatarja, ata do të kenë më shumë të interesuar, dhe rrjedhimisht edhe më shumë fitim. Si rezultat të gjithë do të ndaheshin më të kënaqur dhe një lidhje më e mirë me nevojat e ekonomisë do të krijohej.

Përputhja e rezultateve me ekonominë

Trajtuar në pjesën paraprake, profili i studentëve është pjesë thelbësore kur analizohet niveli i përmbushjes së nevojave të ekonomisë nga arsimit të lartë. Nëse punëdhënësit nuk gjejnë aftësitë e duhura tek të diplomuarit në universitete, atëherë sistemi i arsimit të lartë ka dështuar.

Është e padiskutueshme se arsimit i lartë luan një rol thelbësor në zhvillim. Mësime të rëndësishme mund të merren nga vendet si Japonia, Singapuri dhe Korea të cilat kanë zhvilluar ekonominë e tyre duke investuar shumë në arsim. Nuk vihet në dyshim që arsimit të lartë është ndoshta faktori më i rëndësishëm për rritje ekonomike të qëndrueshme. Ngjashëm, tani Kina, India, Brazili, Meksika, Argjentina dhe shumica e vendeve në zhvillim janë duke ndjekur të njëjtin model. Laboratorët e teknologjisë së lartë janë duke u ndërtuar edhe në zona të largëta në mbarë Amerikën Latine dhe Azinë Juglindore duke siguruar qasje në teknologjinë më të avancuar për vendet më të populluara në botë. Të gjitha këto vende kanë filluar me nivele më të ulëta të arsimit sesa ai që ekziston sot në Kosovë por kanë bërë këtë hap pasi që nuk kanë pasur strategji tjetër për të ndjekur. Për më tepër, investimet në arsim janë më të besueshme që do t'a shpagojnë vetën sesa shumica e investimeve tjera, sepse "... më shumë vende të punës kërkojnë arsimim të lartë dhe aftësi të veçanta, si dhe një numër gjithnjë e më i madh i vendeve të punës janë duke u shfaqur në sektorin e shërbimeve" (Persson 2005-2006: 28).

Ekonomia është në gjendje jo të qëndrueshme me përpjekje të përhershme për të ulur shpenzimet e biznesit. Kjo shpie në ndryshime të përhershme të profileve të punës. Në kohë të ndryshimeve të shpejta dhe të pamundësisë për të planifikuar askush nuk është në gjendje që të thotë se çfarë fushash duhet të mësohen. Kur disa vende të punës shihen dhe zëvendësohen me të reja, nuk është e mjaftueshme që të analizohet tregu, por një shkallë e lartë e fleksibilitetit duhet të ndërtohet brenda sistemit për të lejuar përgjigje të shpejta.

Pjesa paraprake ka përshkruar aftësitë që merr një student dhe të cilat vështirë që mund të quhen aftësi të nevojshme për treg. Përderisa fjala magjike në reformën e arsimit të lartë në perëndim ka qenë "arsimim me një qëllim", p.sh. të mësohet çfarë është e nevojshme për tregun e tanishëm dhe atë të ardhshëm, në Kosovë ka qenë që t'u mësohen studentëve aftësitë ekzistuese të profesorëve pa marrë parasysh nëse këto aftësi ju nevojiten pas diplomimit. Një shembull i mirë se çfarë mund të nënkuptojë arsimi me qëllim (e përcaktuar nga tregu) është kantoni i Gjenevës. Institucionet e arsimit të lartë në Gjenevë kanë zgjedhur që në rend të parë të përqendrohen në aftësitë që i nevojiten ekonomisë së zonës së tyre. Si një qendër madhore diplomatike, shtëpi e OKB-së, Kryqit të Kuq Ndërkombëtar, UNHCR-it në mënyrë të natyrshme, arsimit është përqëndruar në përkthim dhe interpretim, studime mbi refugjatët, apo banka për shkak të epërsisë krahasuese të Zvicrës.

Zhvillimi afatgjatë më së miri arrihet kur zhvillimi i arsimit dhe trajnimit është në harmoni me objektivat ekonomike, sociale dhe mjedisore. Mungesa absolute e industrisë në

Kosovë e bën këtë edhe me të vështirë për ata që hapin institucione të reja të arsimit të lartë. Përveç atyre që mbarojnë biznesin, është e paqartë se ku do të kërkojnë punë të diplomuarit tjerë të shumë institucioneve private. Kosova ende nuk ka vizion lidhur me drejtimin që do ta marrë ekonomia e saj në të ardhmen. Dy strategji kombëtare të vendit janë hedhur poshtë dhe e treta është aktualisht duke u hartuar. Si rezultat, studentët nuk janë në gjendje që të gjykojnë se cili profil do të ketë gjasa më të mëdha për zhvillim, kështu që ata shkojnë në drejtime që janë në trend siç është departamenti i shkencave politike që është themeluar rishtazi, psikologjia dhe të ngjashme. Z. Fevzi Berisha, Zv. Ministër i MASHT-it, shton se Kosova ka nevojë për fusha të reja të studimit dhe jo profile si ekonomiku dhe drejtësia që janë të pranishme pothuajse në të gjitha institucionet private. “Kështu, ne kemi nevojë që të përqendrohemi në lëndë të reja që do të ishin të mirëseardhura për ekonominë e Kosovës” (Bojaj 2005: 4). Çdonjëri mund ta vërejë numrin e madh të studentëve që studiojnë drejtësinë dhe ekonominë por as MASHT-i e as tregu nuk munden as përafërsisht të vlerësojnë sasinë dhe cilësinë e trajnimeve që janë të nevojshme në sektorë të ndryshëm.

Trendet aktuale ku universitetet ligjërojnë me kapacitetet ekzistuese pa bërë ndonjë përpjekje për të ri-trajnuar apo punësuar kapacitete të reja duhet që urgjentisht të ndryshojnë. Askund nuk përcaktohet se si analizohet nevoja për lëmi të reja. Siç e pranon Dekani i Fakultetit të Shkencave Matematiko-Natyrore “Ne veç prodhojmë, send nuk dijmë. A shitet a nuk shitet nuk na intereson. Kjo është çështje e Ministrisë së Punës” (Elezaj 2006). Sistemi i arsimit të lartë duhet t’i nënshtrohet një rishqyrtimi të përgjithshëm. Një shqyrtim i tillë nuk duhet të bëhet vetëm nga “ekspertët” por duhet të përfshijë të gjitha palët e përfshira në procesin e arsimit duke përfshirë studentët, prindërit, punëdhënësit, grupet e komunitetit, mësimdhënësit, akademikët, zyrtarët e nivelit lokal dhe qendror... Siç argumenton Peffers, këto ndryshime duhet të përkrahen nga studime të rregullta sistematike të trendeve të tregut të punës për të siguruar një përshtatje më të mirë me nevojat e ekonomisë së tregut që po lindin dhe me nevojat e veçanta të lokaliteteve të ndryshme (Peffers dhe të tjerët 2005: 40). Përveç kësaj, asnjë studim, pa marrë parasysh sa i mirë që të jetë ai, nuk mund të zëvendësojë një proces të vazhdueshëm të bashkëveprimit ndërmjet palëve të ndryshme të përfshira në këtë çështje.

Konkurrenca në arsimin e lartë

Vendet e rajonit kanë pasur përvoja të mira nga të cilat duhet mësuar. Arsimi i lartë në rajon kryesisht është larguar nga byrokracia dhe politikat e centralizuara gradualisht duke u koordinuar me tregun e lirë. Mirëpo, siç ka shkruar "The Economist" për Bullgarinë "Aftësitë e mësimdhënësve janë të vjetruara dhe korrupsioni është i pandalshëm. Si çdokund në Evropën Lindore, mungesa e njerëzve të aftë është kronike. Universitetet në qytetin Ho Chi Minh [Vietnam]... çdo vit nxjerrin më shumë të diplomuar në shkencat kompjuterike sa e tërë Bullgaria (kuptohet që është shumë më e vogël)" (03 dhjetor 05).

Argumenti kryesor për më tepër konkurrencë është se do të nxiste universitetet që të sigurojnë cilësi më të lartë për çmim më të ulët, me pritjen që opcionet e shumta për klientë (studentë) do të rrisnin presionin për konkurrencë në universitete. Siç tregon përvoja ndërkombëtare, përdorimi i (a) zgjedhjes (kur ka më shumë opsione), (b) pagesës së studimeve (c) fondeve të jashtme, do t'u mundësonte studentëve dhe prindërve të tyre që të kërkojnë më tepër cilësi për investimet e tyre. Konkurrenca në arsimin e lartë është debatuar në shumë nivele, nga Bolonja deri të Marrëveshja e Përgjithshme mbi Tregtinë në Shërbime (GATS) nën Organizatën Botërore të Tregtisë (WTO). Në Kosovë, mënyra e vetme në të cilën ka funksionuar konkurrenca ka qenë presioni për të dhënë diploma me përpjekje minimale. Siç ka theksuar ish-Shefi i Departamentit të Shkencave Politike "Ekonomia e tregut ka hyrë në universitet, jo në procesin e përgatitjes së studentëve në fushën e dijes që ata të konkurrojnë në tregun e punës por në procesin e kërkimit të maksimumit të vlerësimit me minimumin e minimumit të dijes" (Zeneli 2003: 8). Në mënyrë që të arrihet përdorimi më i mirë i talentit dhe burimeve, konkurrenca kërkon që studentët e talentuar, mësimdhënësit dhe hulumtuesit duhet të jenë në gjendje që të zgjedhin një shkollë dhe ca fonde duhet të jenë në dispozicion që në mënyrë efektive t'u ipen më të mirëve.

Një numër gjithnjë e më i madh i studentëve janë duke shkuar në institucione private apo jashtë vendit për të kërkuar arsimim të lartë. Hapja e sistemit për arsim privat gjithmonë shpie në shtimin e institucioneve, shumica prej të cilave me cilësi të dyshimtë. Siç tregon

Të diplomuarit 1969-2004	
Juridik	5.873
Ekonomik	5.785
Filozofik	5.106
Mjekësi	3.511
Shk. Mat-Natyrore	2.743
Filologji	2.430
Teknik	1.709
Bujqësi	1.187
Xehetari-Metalurgji	1.115
Ndërtimari/Arkitekturë	815
Elektro	881
Arte	750
Edukatë fizike	607
Makineri	583
Pedagogji	56
SHKL-PR	4.465
SHLE-PE (Ekonomi)	2.682
SHLT MI (Technology)	1.350
SHLP-PZ (Pedagogji)	2.477
SHLP-GJA (Pedagogji)	3.940
SHLP-GJI (Pedagogji)	2.901
SHLT FE (Teknik)	970

Burimi: www.uni-pr.edu

një rast nga India, Shteti Chhattisgarh, me dy universitete publike për një popullatë 21 milionëshe, miratoi një ligj për të lejuar universitetet private. Për 18 muaj mbi 100 institucione të tilla u hapën për biznes, duke kërkuar pagesa të larta. Por shumica prej tyre kanë zhvilluar aktivitetin e tyre në apartamente me qira dhe me pak vlera edukative. Së fundmi, Gjykata Supreme ndërhyri duke i mbyllur shumicën prej tyre” (Moreau 2005-2006: 95).

Shkencat...	Të regjistruar		Të diplomuar	
	shoqërore-humanitare	natyrore-teknike	shoqërore-humanitare	natyrore-teknike
1970/71	7.139	3.229	232	55
1978/79	26.005	10.563	931	417
1989/90	12.319	12.772	1.248	859
1995/96	9.228	4.517	606	396
1998/99			578	247
1999/00	15.009	7.049	1.205	412
2000/01	13.409	6.868	1.696	381
2001/02	14.172	7.026	1.887	488
2002/03	15.397	7.778	2.114	509
Total	112.678	59.802	10.497	3.764
			9,3%	6,3%

Një trend i ngjashëm është duke ndodhur në Kosovë dhe sipas Zv. Ministrit të Arsimit, Fevzi Berisha, shumë nga institucionet private kanë shkelur ligjin në fuqi dhe ato janë themeluar pa asnjë kriter. “Shumë institucione private të arsimit në Kosovë janë hapur kryesisht pas luftës. Hapja e universiteteve private në dy vitet e fundit është bërë çështje biznesi, pasi që çdo i dyti universitet hap fakultete të njëjta, pa kurrfarë kriteresh të caktu-

ara me ligj dhe udhëzim administrativ të MASHT-it” (Rexha 2005: 8). Është për të të ardhur keq që madje edhe kjo hapje e butë e tregut konsiderohet si “profitabile”, “fatkeqe” dhe “problematike” nga zyrtarët e arsimit të cilët kanë mosbesim të thellë nëse paratë do të shërbejnë si “vlera të vërteta”. Siç ka thënë Zv. Ministri “Institucionet arsimore të nivelit pasuniversitar, fatkeqësisht, parësore e kanë vetëm përfitimin material, e jo cilësinë dhe gjithashtu hapin drejtime vetëm në ato degë që janë përfituese...është shumë më e mirë dhe më e levërdishme hapja e drejtimeve të reja, për të cilat ka më shumë nevojë Kosova, por kjo natyrë funksionimi është shndërruar pothuajse në interes komercial, e më pak në atë të vlerës së vërtetë” (Rexha 2005: 8).

Përderisa rritja e numrit të universiteteve private me cilësi të dyshimtë përbën njërin ekstrem, ekstremi tjetër është ekzistenca e vetëm një universiteti publik me mjete financiare plotësisht jo-konkurruese, që kemi tani. Në fakt, është gjendja e mjerueshme e universitetit publik ajo që ka ndikuar në rritjen e numrit të universiteteve private. “Kësaj duket se i ka kontribuar dështimi i reformimit të Universitetit të Prishtinës, që ka qenë dhurata më e mirë që bosët e universiteteve private kanë marrë” (Llapashtica 2005: 15). Mbi të gjitha, sektori privat në rend të parë parapëlqehet nga ata të cilët nuk janë pranuar në UP apo nga të pasurit që nuk dëshirojnë të presin në rend për një provim. Disa dyshojnë dhe janë kritik kundrejt shkallës jashtëzakonisht të lartë të diplomimit (ndosh-

ta të pavetëdijshëm që në shumë vende tjera ky është një tipar pozitiv), shpesh duke kritikuar që tek privatët “kalimi i provimeve është i përfshirë në çmim”.

Fatmirësisht, Kosova ka shumë raste prej të cilave mund të mësojë, të gjitha vendet e Evropës Lindore janë përballur pothuajse më të njëjtën sfidë. Ato kanë përjetuar rritjen e numrit të institucioneve private pas tranzicionit dhe konsolidimin gradual të tyre. Nga frika e dështimit të institucioneve private, MASHT-i i ka detyruar ato që të paguajnë depozita të larta si garanci. Zyrtarë të nivelit të lartë kanë shkuar edhe më tutje duke i paralajmëruar prindërit që mos të rrezikojnë që t'i dërgojnë fëmijët e tyre në institucione

Nëse rritja e universiteteve private me cilësi të dyshimtë është njëri ekstrem, posedimi i vetëm një universiteti publik me mjete jokonkurruese paraqet ekstremin tjetër.

private. “Paralajmërimi publik që prindërit të mos rrezikojnë duke i regjistruar fëmijët në institucionet private pa u njohur se për cilat drejtime i plotësojnë kushtet është përsëritur disa herë” (Rexha 2006: 39). Në vend të planifikimit të mirë të tranzicionit, kontrollimit të cilësisë dhe të vëjje forcata e tregut në shërbim të tyre, institucionet e

Kosovës gabimisht janë vendosur në anën e parregullsive, mospërkrahjes dhe vendosjes së pragut të lartë për sektorin privat.

Kjo lë të nënkuptohet se publiku kosovar ka nevojë që t'i nënshtrohet një debati mbi vlerat e arsimit privat. Në mesin e studentëve të UP-së dhe publikut të gjerë ekziston përshtypja së shumica e studentëve në këto universitete janë fëmijë të VIP-ave, udhëheqësve dhe që studimet në këto universitete janë më të lehta. Ka pasur kritika se “Kuari është më i ulët në universitetet private, numri i studentëve shumë më i madh sesa që kanë kapacitet” (Fetahu 2005). Një raport i brendshëm i revizorit të MASHT-it i ka kritikuar institucionet private se: “nuk mbajnë librat amë të statistikave, nuk mbajnë librin amë të të punësuarve, punojnë në ndërtesa pa leja ndërtimi, reklamojnë departamente për të cilat ato nuk janë të licencuara” (Rexha 2006: 5).

Gjendja e padefinuar në të cilën autoritetet i kanë mbajtur institucionet private i ka penguar ato nga regjistrimi i më shumë studentëve. Për dallim nga ata, ka shumë arsye racionale për t'u regjistruar në UP, e cila ka licencë dhe reputacion. Edhe pse mësimdhënia është më e mirë në institucionet private droja e licencës në universitete private dhe mungesa e reputacionit është arsyeja pse studentët zgjedhin UP-në, jo për cilësi por për emër (Gashi. I. 2005). Pavarësisht diskriminimit të tillë të sektorit privat, shpenzimet në këtë sektor gjatë janë barazuar me ato të qeverisë në sektorin publik.

Mbi të gjitha, konkurrenca duhet të zhvillohet në mënyrë që të rrisë produktivitetin e sistemit në tërësi, që siguron konkurrencë të mjaftueshme për të nxitur ndryshime në universitetin publik në mënyrë që të rritet cilësia dhe të eliminohet byrokracia e tepërt. Kur shkollat “nuk do të kenë klientelë e cila nuk ka zgjidhje tjetër dhe kështu të kenë të sigurt mjetet financiare” sistemi do t'i detyrojë shkollat që të jenë më përgjegjëse kundrejt dëshirave të klientëve dhe në përdorimin më efektiv të burimeve të tyre (Ladd dhe Fiske 2001: 4). Konkurrenca padyshim që do të prodhojë efikasitet, kështu që vetë ky kriter

meriton të përfilllet. Sidoqoftë, kjo nuk do të sigurojë cilësi përderisa punësimi nuk llogaritet si faktor relevant.

Përfundimisht, nëse Kosova nuk mund të konkurrojë në arsimin e lartë me fqinjët e saj, atëherë mund të përfundohet se Kosova do të mbetet me sektorët më joproduktiv të ekonomisë rajonale.

Harmonizimi me sistemin ndërkombëtar

Reformat janë të domosdoshme për një aspekt tjetër të rëndësishëm të arsimit të lartë, harmonizimin me sistemin ndërkombëtar. Me këtë qëllim në mendje ishte bërë edhe lëvizja aq entuziaste drejt skemës 3+2 vite. Harmonizimi ekziston në disa forma dhe në përgjithësi kërkohet për lëvizshmëri të personelit mësimor dhe të studentëve. Tani për tani dy aspektet kryesore janë njohja e diplomave dhe transferi i kredive. Me adoptimin e skemës ECTS të kredive, transferi i studentëve është më i lirshëm, dhe shumë universitete kërkojnë procedura shtesë për kosovarët pasi që nuk ka katalog të lëndëve dhe është shumë vështirë që të kontrollohet përmbajtja e lëndëve. Për më tepër, për shkak të lëvizjes në sistem trevjeçar, shumë programe post-diplomike kërkojnë nga studentët që të ndjekin edhe një vit të studimeve apo që të kalojnë provime të caktuara. Për më tepër, tani është shumë e paqartë se çfarë mund të bëjë një student me titull 'baçelor'. Sipas Destan Halimit, Sekretar në UP, për të dhënë mësim në shkolla të mesme studentët duhet të përfundojnë edhe një vit të studimeve në Fakultet të Edukimit. Në anën tjetër Zv. Ministri i Arsimit thotë se për këtë kërkohet titulli magjistër (Morina 2006: 6). Momentalisht, lëvizshmëria e profesorëve është e kufizuar vetëm për profesorë individualë të cilët janë duke mbajtur disa vende pune në institucionet mësimdhënëse shqipfolëse në Prishtinë dhe Tetovë. Një situatë e tillë qëndron edhe me njohjen e diplomave. Kosova ka arritur një marrëveshje për njohje të dyanshme të diplomave me Shqipërinë dhe diplomat e saj në mënyrë të njëanshme njihen nga Mali i Zi, gjë që ka ardhur si rezultat i një marrëveshje të brendshme. Një protokoll bashkëpunimi ishte nënshkruar me Ministrinë e Arsimit të Maqedonisë, por sipas kritikëve, kjo akoma nuk është duke u implementuar (Hoxha 2006: 12).

Ambienti arsimor i rajonit dhe i Bashkimit Evropian

Më lartë, punimi ka përshkruar shkurtimisht mjedisin e ri ekonomik dhe aftësitë që nevojiten për t'u futur në sektorët më fitim-prurës të ekonomisë. Në këtë aspekt, kjo pjesë ilustron pengesat tjera në zhvillimin e një sistemi arsimor që garon në rajon. Sistemi arsimor është një aspekt i domosdoshëm, por i pamjaftueshëm si i vetëm. Mbi të gjitha, siç e thekson një autor "Vendet që janë të hapura, kosmopolite, meritokratike dhe pragmatike, si dhe vendosin vlerë të lartë në mësim kanë mundësi më të mirë për t'ia dalë mbanë në një ambient ku ata duhet të pozicionohen mirë në rritjen e konkurrencës në ekonominë e dijes" (Loong 2005-2006: 32). Për fat të keq, Kosova ka pak nga këto cilësi.

Shumëçka varet nga arsimit. Madje edhe vendet e zhvilluara evropiane përjetojnë kriza në strategjitë e tyre zhvillimore ku arsimit shpesh është në thelb të këtij debati. “E ardhmja e Evropës në 10 apo 20 vitet e fundit – dikush tundohet të thotë vetë ekzistenca – varet nga aftësia jonë për të marrë pjesë krahas SHBA-ve, Kinës, Indisë dhe të tjerëve në të ashtuquajturën “ekonomi e dijes” ka thënë një ish-Ministër i Financave të Francës, Strauss-Kahn (2005-2006: 22). Për Kosovën, standardet e ulëta të arsimit mund të paraqesin pengesën më të madhe në zhvillim.

Përfundimisht, sistemi i arsimit nuk ka nevojë që të nxjerrë as punëtorë e as akademik në kuptim të plotë të fjalës. Mbi të gjitha, ai duhet të krijojë punëdhënës, persona që kanë ide ndërmarrëse për t’ju krijuar punë vetes dhe të tjerëve.

Standardet ndërkombëtare të arsimit të lartë

Në dimensionin e vet ndërkombëtar, cilësia e arsimit të lartë karakterizohet me: shkëmbim të njohurive, lëvizshmëri të mësimdhënësve dhe studentëve, projekteve hulumtuese ndërkombëtare, etj. (UNESCO 1979). Promovimi i zhvillimit të nivelit më të lartë të mundshëm të dijes është një nga qëllimet e deklaruara në Preambulën e Traktatit themelues të Komunitetit Evropian.

Kompetencat e Bashkimit Evropian në fushën e arsimit janë identike me ato të Komunitetit Evropian. Traktati themelues i Komunitetit Evropian arsimin e lë në kompetencë të shteteve anëtare. Ato “janë përgjegjëse për përmbajtjen e mësimin, organizimin e sistemeve arsimore dhe dallimeve të tyre gjuhësore dhe kulturore” (Traktati i Romës, Neni 149, Par. 1). BE-ja inkurajon bashkëpunimin në mes shteteve anëtare, dhe nëse është e nevojshme përkrah plotëson veprimet e tyre.

Preambula e Traktatit të Romës në mes tjerash vendos si objektivi promovimin e “zhvillimit në nivelin më të lartë të mundshëm të njohurisë për njerëzit e tyre përmes një qasje të gjerë në arsimim dhe përmes përmirësimit të vazhdueshëm të tij”. Ligjet kombëtare nuk mund të harmonizohen me rregulloret e BE-së ashtu siç ka ndodhur në fushën e ekonomisë. BE-ja mund vetëm të përshtatë rekomandimet dhe masat nxitëse që ndjekin politikatat vijuese (siç ceket në nenin 149):

- dimensionin evropian të arsimit, veçanërisht përmes mësimdhënies dhe shpërndarjes së gjuhëve të shteteve anëtare;
- lëvizshmërinë e studentëve dhe profesorëve, veçanërisht përmes inkurajimit të njo-hjeve të ndërsjella të diplomave dhe kohëzgjatjes së studimeve;
- bashkëpunimin ndërmjet institucioneve arsimore;
- shkëmbimin e informatave dhe përvojave;
- shkëmbimin e të rinjve dhe shkëmbimin e pedagogëve socio-edukativ;
- zhvillimin e arsimit nga distanca.

Edhe pse nuk ka kritere për shtetet kandidatë për anëtarësim sa i përket reformës së arsimit (një gjë e tillë nuk është pjesë e kritereve të Kopenhagës për shtetet kandidatë),

të gjitha shtetet anëtare kanë bërë ndryshime në legjislacionin e tyre arsimor në mënyrë që të ndihmojnë realizimin e katër lirive të Tregut të Përbashkët Evropian.

Në rajonin evropian bashkëpunimi më i ngushtë në fushën e arsimit sigurohet përmes kornizës së Këshillit të Evropës dhe të BE-së. Siç është përshkruar më lartë, konventat evropiane kryesisht nuk vendosin standarde të përbashkëta, por kanë për qëllim njohjen reciproke të kualifikimeve nga vendet e jashtme. Sidoqoftë, kjo qasje e kufizuar ishte ndryshuar me fillimin e procesit të Bolonjës që vendos si qëllim të përbashkët për shtetet pjesëmarrëse: krijimin e Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë (EAHE) deri në vitin 2010. Politikat e vendosura nga Deklarata e Bolonjës ishin ndërkombëtarizimi i arsimit të lartë, bashkëpunimi ndërmjet universiteteve dhe industrisë, etj. Duke u përballur me sfida të përbashkëta, të jashtme dhe të brendshme (papunësia e të diplomuarve, mungesa e aftësive në fushat kyçe, ekspansioni i arsimit privat dhe ndërkombëtar, etj.), 29 shtete evropiane (shtete anëtare të BE-së, shtete kandidatë dhe shtete anëtare të Marrëveshjes Evropiane për Tregti të Lirë (EFTA)) u zotuan të reformojnë sistemet e tyre të arsimit të lartë në mënyrë që të krijojnë konvergencë në nivelin evropian.

Procesi i Bolonjës në të vërtetë ka filluar me Deklaratën e Sorbonës që ka theksuar rolin kyç të universiteteve në zhvillimin e kulturës evropiane dhe ka theksuar domosdoshmërinë e krijimit të Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë (EAHE). Deklarata e Bolonjës kërkon që deri në vitin 2010 të krijojë këtë zonë:

- duke ngritur gatishmërinë dhe krahasueshmërinë e titujve dhe diplomave, p.sh. me një diplomë plotësuese;
- duke zhvilluar strukturën e titujve, kryesisht që të formojë dy cikle. Cikli i parë do të jetë së paku tri vite. I dyti përfshin një magjistraturë të shkurtër dhe një doktoraturë më të gjatë. Cikli i parë i titujve duhet po ashtu të jetë i përputhshëm me tregun evropian të punës;
- duke krijuar ECTS-në (Sistemin Evropian të Transferit të Kredive). Kreditë po ashtu mund të mbledhen jashtë kontekstit të arsimit të lartë, nëse institucioni në fjalë i njëj ato studime;
- duke krijuar dimensionin evropian për vlerësim të cilësive, me qëllim të zhvillimit të kriterëve dhe metodologjive të krahasueshme;
- duke larguar barrierat për lëvizshmëri;
- duke zhvilluar një dimension evropian të arsimit të lartë (paragrafi 9)

Konferencat vijuese në Pragë (2001), Berlin (2003) dhe Bergen (2005) shtuan në EAHE karakteristikat e mësimit gjatë gjithë jetës dhe integrimin e aktiviteteve të studentëve.

Për aq sa i përket BE-së, procesi i Bolonjës përputhet me kornizën më të gjerë të objektivave të Lisbonës në krijimin e “ekonomisë së dijes më dinamike dhe më konkurruese në botë, të aftë për rritje të qëndrueshme ekonomike me vende të shumta dhe cilësore të punës, si dhe me kohezion shoqëror më të madh” (Këshilli i Evropës, Lisbonë 2000). Arsimimi është thelbësor në arritjen e këtij qëllimi. Shtetet anëtare të BE-së lirisht përcaktojnë politikat dhe veprimet në mënyrë që të arrijnë qëllimet e Strategjisë së Lisbonës.

Roli i BE-së është koordinimi i hapur i procesit duke përcaktuar dhe shpërndarë praktika më të mira, monitorimi periodik në pajtim me indikatorët përkatës, zhvillimi i rekomandimeve dhe sigurimi i mundësive për mësim reciprok ndërmjet shteteve anëtare.

Në mënyrë që të ndihmohet arritja e qëllimeve të Bolonjës, BE-ja ka bërë disa programe (Socrates, Leonardo, Erasmus Mundus, Tempus, Projekti Jean Monnet “Integrimet Evropiane në Studimet Universitare”) përmes të cilave universitetet marrin rreth një të tretën e mjeteve financiare për hulumtim dhe zhvillim, sikurse edhe përkrahje për trajnim në hulumtim dhe lëvizshmëri (European Research – Associates 2004: 6, 17).

Kjo nënkupton që pjesa më e madhe e problemeve, madje edhe në fazë të konsoliduar të integritimit në BE pritet të zgjidhen nga qeveritë përkatëse. Ndihma, sidoqoftë, mund të ipet përmes disa mundësive financiare, rekomandimeve dhe shkëmbimit të përvojave brenda Strategjisë së Lisbonës. Pasi që buxheti i BE-së për politika arsimore është vetëm 0,5%, pak ndihmë do të vijë nga BE-ja. Kështu, në këtë aspekt Kosova duhet të llogarisë vetëm në kapacitetet e veta.

Për më tepër, cilësitë e ardhshme të Qeverisë së Kosovës do të maten me shkallën e konvergencës dhe përputhjes me ato të BE-së, kështu që fuqimisht rekomandohet që më shpejtësi të lëvizet në përmbushjen e kërkesave që dalin nga Strategjia e Lisbonës. Sipas Grupit Ndërkombëtar të Krizave (ICG) “asnjë nga projektet ndihmëse të BE-së për Kosovën nuk është duke shkuar për arsim”, duke argumentuar se orientimi i ndihmës së BE-së në arsim është problematik sepse institucionet e BE-së “kanë pak përvojë dhe pak kompetenca në arsim” (ICG 2006: 5). Në mënyrë më të veçantë, ndihma e bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë, në veçanti ajo e BE-së, ka nevojë të shkojë më tepër në arsim.

Një numër i burimeve financiare ekzistojnë në nivelin e BE-së, nga fondet strukturore, fondet për zhvillim rajonal e të tjera. Një mundësi tjetër financuese në BE ekziston përmes Bankës Evropiane për Investime (BEI). Kjo përkrah objektivat e njëjta sikurse fondet strukturore, mirëpo jep kredi edhe për sektorin privat dhe atë publik. BEI-ja ofron kamata të volitshme dhe periudha më të gjata për kthim sesa shumë banka komerciale.

Përvojat pozitive

Përveq informatave të errëta për UP-në, ka poashtu edhe oaza të suksesit. Një nga sukseset e UP-së është Universiteti Veror i cili çdo vit tërheq një numër të konsiderueshëm të profesorëve dhe studentëve ndërkombëtarë dhe të rajonit, përfshirë këtu edhe 21 studentë nga Serbia dhe Mali i zi në vitin 2006.

Një rrëfim tjetër pozitiv është Kolegji i Biznesit në Pejë i cili funksionon në kuadër të UP-së. Deri vonë ishte shkollë e lartë dy-vjeçare, tani është shndërruar në sistem tri-vjeçar me diplomë universitare 'baçelor'. Ky kolegji ka katër departamente, njëri nga to në gjuhën boshnjake. Shkalla e "reformimit" të profesorëve është më e lartë se në shumicën e departamenteve të UP-së. Po ashtu ndërtimi i notës (nga aktivitetet e ndryshme) funksionon më mirë se në shumicën e institucioneve private. Pesëdhjetë përqind e notës fitohet përgjatë lëndës së mbajtur gjatë semestrit dhe pastaj është një kohë e kufizuar deri në semestrin tjetër kur studenti ka mundësi të marrë 50%-shin e mbetur nga provimi, pas të cilit duhet të vijojë përsëri lëndën. Studenti ka të drejtë ti nëshetrohet provimit vetëm deri në 3 herë. Një numër i vogël i profesorëve, kryesisht të rinj, të cilët nuk posedojnë libër mësimi, kërkojnë nga studentët të lexojnë materialin e caktuar në gjuhën angleze nga interneti. Për ata që nuk flasin gjuhën angleze, Fakulteti ofron kurse falas që mbahen nga vullnetarë të jashtëm kryesisht nga Shtetet e Bashkuara.

Disa departamente janë më pak tërheqëse për ndërmarrësit privat. Përfitues i kësaj është Fakulteti i Matematikës – Shkenca Natyrore, i cili është punëdhënësi kryesor i 85-90% të personelit të vet të cilët, për shkak të interesit të ulët të sektorit privat, kalojnë shumicën e kohës aty. Profesorët janë të përfshirë në mësimdhënie po aq sa edhe në mentorimin e punimeve të diplomës, dhe çdo profesor ka dy orë në javë takim me studentët për konsultime. Për shkak të shkallës së ulët tërheqëse, në afatin e parë të provimit pranues aplikojnë pak studentë. Zakonisht studentët të cilët aplikojnë në Mjekësi, Juridik, Ekonomi apo Shkenca Politike dhe nuk pranohen konkurojnë në fakultete të ngjashme në afatin e dytë.

Pas një skandali të fundit lidhur me disa libra të përkthyer dhe të botuar si tekste autoriale, UP-ja ka themeluar komisionin për shqyrtim të këtyre librave dhe ka ndërmarrë masa kundër atyre profesorëve.

Strategjia për arsimin e lartë

Është e rëndësishme që shkurtazi të hedhet një vështrim mbi institucionet të cilat janë të ngarkuara për të drejtuar dhe mbikëqyrur qeverisjen në arsimin e lartë. Analiza organizative dhe efikasiteti i MASHT-it nuk janë objekt studimi të këtij punimi, kështu që ky punim përqendrohet në analizimin e strategjisë për arsimin e lartë dhe në një analizë të shkurtër të politikave buxhetore dhe financiare.

Në kuadër të përpjekjeve për të reformuar arsimin e lartë, MASHT-i ka përgatitur një dokument-strategji. Ky dokument paraqet një shtyllë të shkëlqyeshme udhërrëfyese se ku duhet të arrihet dhe duket të jetë shkruar sipas praktikave më të mira ndërkombëtare. Vizioni i MASHT-it për arsimin e lartë është Promovimi dhe zbatimi i idesë për arsimim më të mirë për të gjithë, bazuar në nevojat e individëve dhe të shoqërisë kosovare. Edhe pse dokumenti ofron vizion afatgjatë, për fat të keq, nuk arrin që të përcaktojë ndonjë rrugë drejt arritjes së këtyre qëllimeve.

Ekziston një qëllim i qartë për të bërë legjislacionin sipas standardeve ndërkombëtare. Edhe pse nuk bën diagnostifikim të problemeve, strategjia premtan të përmirësojë problemet e dukshme (si p.sh. mungesën e lëvizshmërisë së studentëve, mungesën e pajisjeve kompjuterike, bursat, etj.). Ekziston një qëllim i qartë për t'a bërë arsimin e lartë një nga prioritetet e zhvillimit për 10 vitet e ardhshme. Për më tepër politikat e arsimit do të ndërtohen dhe zbatohen përmes pjesëmarrjes së të gjitha palëve të interesuara (qeverisë, studentëve, institucioneve të arsimit të lartë, etj.), që është një nga ndryshimet që duhet bërë.

Dokumenti është i mbushur me deklarata pozitive dhe thekson nevojën për më shumë llogaridhënie dhe transparencë si fusha kryesore të identifikuar që kanë nevojë për përmirësim. Në mënyrë që të shmangen trendet negative (si p.sh. plagjiatura, mosparaqitja në ligjërata, mungesa e respektit për kodin etik, etj.), politikat dhe praktikat do të hartohen me pjesëmarrjen aktive të studentëve. Edhe pse cilësia e pjesëmarrjes së studentëve nuk diskutohet, kjo duket lëvizje pozitive pasi që studentët pritet të zbatojnë më mirë rregullat në zhvillimin e të cilave kanë qenë vetë të përfshirë. Strategjia sygjeron që studentët duhet të trajtohen si klientë por raporti i forcave që shihet në dokument sërish i trajton ata si subjekt pasiv.

Strategjia flet për rregullimin e disa probleme serioze që kanë të bëjnë me pabarazinë gjinore, mungesën e diversitetit, si dhe numrin e vogël të të rinjve në institucionet e arsimit të lartë. Fatkeqësisht, përveç që janë përmendur si probleme serioze dhe që do të hartohen politika për t'i rregulluar ato, nuk është dhënë as orientimi më i vogël se si dhe kur do të zbatohen.

Për më tepër, MASHT-i beson se problemet do të zgjidhen me krijimin e zyrave të ndryshme, p.sh. (a) një administratë profesionale e themeluar që në vazhdimësi të trajnojë personelin udhëheqës dhe administrativ, (b) zyrat do të themelohen për të siguruar

cilësi në funksionimin e këtyre institucioneve. Fatkeqësisht, ka shumë pak pika referuese të nxjerra nga dokumenti për rifreskim të vazhdueshëm të institucioneve të arsimit të lartë (p.sh. kufizimi 5 vjeçar për përdorim të librave të njëjtë).


Ekziston një qëllim i qartë për të rritur fleksibilitetin e mënyrës së studimit (p.sh. përmes formave të ndryshme të arsimit të lartë) për t'ju përshtatur nevojave individuale të studentëve por mungon diskutim i veçantë se si do të duken këto programe (p.sh. a përfshin studimi me gjysmë orari ligjërata në mbrëmje për t'u përshtatur me orarin e punës, a do të ketë data të ndryshme të fillimit të semestrave, seanca verore, etj.). Tejet pak flitet për përmirësimin e procedurave të pranimit me një test efektiv të standardizuar. MASHT-i më me dëshirë fokusohet në krijimin e një njësie për administrimin e provimeve pranuese.

Dokumenti pranon që planprogrami dhe programet e studimit duhet të jenë në pajtim me trendet në shoqëri dhe me tregun e punës. Sidoqoftë, një gjë e tillë është trajtuar shkurtazi në strategji dhe nuk janë dhënë zgjidhje konkrete për zgjidhje të problemit. Prapë, kjo është një fushë e preokupimit madhor që duhet të trajtohet më në thellësi dhe mundësisht të caktohet fushë primare që duhet të përmirësohet. Ngjashëm nuk janë dhënë shumë zgjidhje për të përmirësuar as cilësinë e mësimdhënies. Dokumenti përmend promovimin bazuar në merita dhe efikasitet por aty duhet të ketë metoda për të identifikuar cilësinë e mësimdhënësve dhe t'i mbajë ata në institucione publike.

Më tutje, ky dokument nuk arrin të ofrojë ndonjë ide për zbatim. Dokumenti paraqet një listë të parimeve, por nuk cakton prioritete, që është thelbësore për vendimet e politikave kur këto garojnë mes vete dhe kjo ndodh gjithmonë. Për më shumë dokumenti identifikon si prioritet zhvillimin e legjislacionit të nevojshëm, por nuk përmend ligje për këtë qëllim.

Rritja e efikasitetit të burimeve financiare është mënyra e vetme e sigurtë për të përmirësuar institucionet e arsimit të lartë në aspektin afatshkurtër. Nuk ka diskutim të mjaftueshëm mbi metodat për të përmirësuar përgjegjësinë fiskale. Si zëvendësim punimi garanton përmirësim përmes alokimit të fondeve (që në të vërtetë janë të nevojshme). Shpesh, nuk theksohet se nga mund të vijnë fondet shtesë. Dokumenti e pranon nevojën për fonde shtesë, dhe vetë strategjia është zhvilluar duke pasur në mendje rritje të konsiderueshme të fondeve, që nuk janë materializuar në buxhetin e vitit 2007 për arsim të lartë. Kuptohet, MASHT nuk do të mund të përfundojë strategjinë nëse nuk kërkon fonde shtesë. "...Qeveria e Kosovës duhet të caktojë si prioritet rritjen e shpenzimeve publike dhe private në arsim" (Strategjia e MASHT-it 2004: 11). Përdërisa ekziston pajtimi që më shumë fonde duhet të shkojnë për arsimin e lartë, për më tepër punimi përkrah transparencën, shqyrtimin dhe debatin publik për arsyeshmërinë e shpenzimeve të burimeve ekzistuese. Aktualisht kjo nuk është duke ndodhur. Madje edhe institucionet e reja të zgjedhura në krye të UP-së (pas zgjedhjeve në maj 2006) kanë hezituar t'i tregojnë KIPRED-it ndarjen e buxhetit. Për më tepër, për t'i arsyetuar shpenzimet në arsimin e lartë si investim, MASHT-ti duhet të tregojë rezultate, gjë që strategjia nuk e bën. Deri

sa institucionet e arsimit të lartë nuk përmirësojnë aftësinë e tyre për të kontrolluar burimet e tyre financiare në mënyrë të efektshme dhe transparente, ekziston rreziku që fonde të reja mund të humben po ashtu.



Burimi: MEF 2005: 69 -70

Bazuar në një burim të brendshëm të MASHT-it, problemi nuk duket të jetë identifikimi i praktikave të mira si një qëllim afatgjatë. Një prej problemeve kryesore është mungesa e efikasitetit të brendshëm. “Ligjet administrative janë të mjaftueshme për të ndërtuar një efikasitet të brendshëm të sistemit. Korniza ligjore është e mjaftueshme. Sistemi i menaxhimit të brendshëm, orari, planprogrami është problem, misioni i paqartë, detyrat, përgjegjësitë, raportet, procedurat, standardet, nuk janë autonome por problematike. Ne duhet të merremi me planifikim të sistemit të brendshëm. MASHT-i merret vetëm me mbikëqyrjen e financave dhe shkeljet ligjore” (Rexhaj 2005).

Administrata: pengesë për ndryshime

Ky punim nuk është kritikë ndaj politikbërësve që bëjnë thirrje për më shumë mjete financiare. Ata gjithmonë do të bëjnë një gjë të tillë dhe, si në shumicën e sektorëve tjerë në Kosovë, mjetet financiare janë shumë të nevojshme në arsimin e lartë. Siç është theksuar më lartë, problemi është menaxhimi aktual i burimeve. Me një dyshim të tillë në mendje, ky punim është duke ju qasur çështjes së arsimit të lartë duke supozuar nivel të njëjtë të mjeteve financiare. Kjo nuk bëhet për të zhvlehtësuar nevojën për mjete të tjera financiare, por për të theksuar rëndësinë e menaxhimit dhe thithjes së fondeve jo-publike si një mënyrë për të përmirësuar efikasitetin. Ka shembuj të mjaftueshëm kur politik-bërësit ju kanë dhënë organizatave jo-funksionale më shumë para kur në fakt është dëshiruar të reformojnë ato.

Politika publike duhet të ofrojë nxitje strukturore për menaxhim të mirë të arsimit të lartë, sikurse edhe për menaxhim efikas të brendshëm të institucioneve publike dhe private. Në mes tjerash, politikat e MASHT-it duhet të shërbejnë si nxitje për reformim në byrokracinë ekzistuese. Në mes të shumë mangësive, ata do të duhej të mendojnë edhe për kohën që studentët humbasin duke pritur për procedura të panevojshme administrative. Një llogaritje e shpejtë mbi shpenzimet mesatare të studentëve sjell në vlerësim se një student humb rreth 70 orë në vit duke pritur për të hyrë në provim apo për të marrë një fletëparaqitje nga referentët. Për më tepër, pasi që diplomojnë, studentëve u duhet të vrapojnë pas dhjetëra fletëparaqitjeve të cilat ose kanë humbur në ndërkohë ose profesorët nuk i kanë dorëzuar tek administrata fare. Përveç kësaj, procedura e marrjes së diplomës është e gjatë dhe duhen muaj për të mbledhur fletëparaqitjet, shpesh nga profesorë që fare më nuk punojnë aty:

Studentëve u duhet të presin me orë të tëra në radhë të gjata për të kryer shërbimet e zakonshme siç është regjistrimi i semestrit apo provimeve. 'Studentët duhet të presin të marrin fletëparaqitjet e provimit, dhe pastaj duhet të paguajnë 2 euro për çdo fletëparaqitje,' thotë ajo. 'Pastaj, pasi ata të kenë mbushur fletëparaqitjen, duhet të shkojnë në një zyre tjetër për ta dorëzuar atë' (Gashi dhe Limani 2006).

Edhe pse universitetet private janë më efikase në këtë aspekt, është për të të ardhur keq që në vend të adaptimit të një sistemi të reformuar që nga fillimi, ato vetëm kanë kopjuar sistemin tradicional – "indeksin" dhe "fletëparaqitjen" nga UP-ja.

Edhe shumë mundësi tjera nuk janë shfrytëzuar. Një humbje e madhe është mënyra e studimit me korrespondencë. Aktualisht, UP-ja ofron shërbime për dy lloje të studentëve: (a) studentët e rregullt dhe studentët me "korrespondencë". Kjo ndarje është trashëgimi nga e kaluara ku studentët me korrespondencë kanë qenë studentë të punësuar dhe që i kanë ndjekur ligjëratat gjatë mbrëmjeve dhe studimet e tyre kryesisht janë mbështetur në libra.

Edhe pse UP-ja këtë term e përkthen në gjuhë tjera si 'studime me gjysmë orari', studentët 'me korrespondencë' praktikisht sot nuk dallojnë fare nga të rregulltit sa i përket ngarkesës së përgjithshme të studimeve por vetëm nga shuma e të hollave që ata paguajnë për t'u regjistruar. Përderisa në të kaluarën kjo kategori përbëhej nga studentë që kanë qenë në marrëdhënie pune dhe nuk kanë pasur mundësi të ndjekin ligjëratat rregullisht, sot kjo kategori përbëhet nga studentë që nuk mund të pranohen si të rregullt dhe shprejnë të arrijnë sukses të mirë në vit të parë në mënyrë që të fitojnë të drejtën që në vitin e dytë të regjistrohen si studentë të rregullt dhe të paguajnë më pak.

Çuditërisht, çështja përmbledhet në faktin që administrata pret që studentët e dobët të jenë më të pavarur në mësim dhe të kryejnë punë të barabartë si të rregulltit. Natyrisht, kjo rezulton me efikasitet të ulët dhe ka ngritur dyshime në shumë qarqe, duke përfshirë MASHT-in, që mund të jetë duke nxitur korrupsionin.

Situata e tanishme	Të rregullt	Me korrespondencë
Pjesëmarrja	E obligueshme	Opcionale
Ngarkesa e studimeve	100%	100%
Si duhet të jetë?	Me orar të plotë	Me gjysmë orari
Pjesëmarrja	E obligueshme	E obligueshme
Ngarkesa e studimeve	80-120% (4-6 lëndë)	40-80% (2-4 lëndë)
Titulli akademik	3-4 vite	5-6vite

Sot, studentët në marrëdhënie pune nuk regjistrohen me tepër me 'korrespondencë' sesa si të 'rregullt'. Atyre ju duhet fleksibilitetit më i madh dhe për këtë ata janë të gatshëm të paguajnë më tepër sesa

të posa-diplomuarit e shkollave të mesme. Përveç ligjëratave në mbrëmje, atyre do t'ju hynte në punë një fleksibilitet në ngarkesë të studimeve, saktësisht, të mund të regjistrojnë më pak lëndë sesa studime me ngarkesë të plotë, dmth, një, dy apo më shumë lëndë për semestër varësisht nga puna dhe stili i jetesës së tyre. Paaftësia për t'u ofruar atyre fleksibilitet është një tjetër mundësi e humbur për të ngritur fonde nga kjo kategori të studentëve.

Sot do të ishte më e logjikshme nëse kategoria e dytë e studentëve të ishte (a) studentë që studiojnë nga distanca, (b) me gjysmë orari apo (c) studentë të rregullt që ndjekin ligjëratat gjatë mbrëmjeve apo gjatë shkollës verore. Një ndryshim i tillë vetëm kërkon që regjistrimi i të gjithë studentëve mos të matet me vite por me kredi të lëndëve. Një matje e tillë do të duhej të përdorej edhe për pagesën e studimeve.

Një shembull i keq i trajtimit të studentëve është hapja rishtazi e një departamenti për studime magistrature (Gjuhë dhe Letërsi Frënge) në kuadër të UP-së. Pasi që shumica kandidatëve ishin në marrëdhënie pune me orar të plotë, atyre u ishte premtuar (a) një departament i lehtë, (b) ligjëratat në mbrëmje dhe (c) lëndë zgjedhore. Pasi që i bindën studentët që të paguajnë taksën e regjistrimit, drejtuesit e departamentit i shkelën të gjitha premtimet. Studentët përfunduan me (a) shtatë

Në një departament drejtuesi i programit për magistraturë zgjodhi lëndët në emër të studentëve.

lëndë obligative, (b) pa ligjërata në mbrëmje dhe (c) të gjitha lëndët zgjedhore të premtuara dolën që janë zgjedhur nga profesorët e tyre ku lëndët praktikisht u shndërruan në obligative.

Një potencial tjetër i dështuar është shfrytëzimi i efikasitetit të hapësirave të UP-së. Përdorimi i objekteve të UP-së për konferenca dhe promovime të librave do të mund të siguronte të hyra vetanake shtesë për institucionet e arsimit të lartë. Mundësia më e mirë është shfrytëzimi i objekteve gjatë verës dhe dimrit kur UP-ja mbyllet për dy muaj dhe objektet universitare janë të pashfrytëzueshme për tre deri në pesë muaj. Siç edhe e thekson përfaqësuesi i donatorit më të madh të UP-së “Sipas mendimit tim duhet të ketë semestër të III-të dhe të IV-të. Gjatë sezonit dimëror, për një muaj nuk zhvillohet mësimi, kurse gjatë sezonit të verës fakulteti mbyllet për dy muaj të tërë. Pse të mbyllet fakulteti kur kjo kohë mund të shfrytëzohet ndryshe?” (Dedaj 2005).

Një mundësi tjetër e humbur është ajo që pothuajse të gjitha institucionet private kanë përshtatur të njëjtën mënyrë të kategorizimit të studentëve, të rregullt apo me korrespondencë (në thelb, ata nuk janë të obliguar që t'i ndjekin ligjëratat por të gjitha obligimet tjera mbesin të njëjta (p.sh.: Faik Konica, FAMA). Dy institucionet e vetme që kanë një mënyrë ndryshe të organizimit të studimeve të tyre janë AUK-i dhe UBT-ja. Universiteti Amerikan në Kosovë është institucion tipik i stilit amerikan, përderisa UBT-ja ka zgjedhur mënyrën më ekonomike për të sjellë profesorët ndërkombëtar në Kosovë, një sistem modular me një apo me dy ligjërata me kohëzgjatje 2-3 ditëshe për një lëndë dhe dorëzimin e punimeve përmes postës elektronike.

Kjo listë e problemeve tregon që nuk janë problemet akademike ato që e mendojnë më së shumti universitetin. Mosfunksionimi ditë tregon se sa pak presion kanë ata për t'i përdorur burimet e tyre në mënyrë racionale. Një gjë e tillë jo vetëm që është problemi më i madh sot, por ajo ka vendosur në pozita të dobëta çdo reformë konceptuale dhe do të vazhdojë të bëjë kështu edhe në të ardhmen. Siç e vërteton edhe një raport:

nëse një student i drejtohet një organi të Universitetit, cilido qoftë ai, duhet të brehtë me ditë të tëra deri sa të gjejë përgjegjës për ta kryer një punë sado të vogël. Përgjigjet që marrin zakonisht janë: nuk jam përgjegjës; tjetri është kompetent; më fal se jam i zënë; dhe e gjithë kjo të bën të kuptosh se shumica e bartësve të këtyre obligimeve nuk i din detyrat dhe përgjegjësitë e tyre (Mustafa, Kadriu 2006: 4).

Një tregues tjetër i dështimit të mexhanimit bazik është mungesa e higjienës themelore. Një ligjërues në Fakultetin e Elektroteknikës thekson që laboratorët e kompjuterëve ku ai ligjëron “Cisco” pastrohet vetëm pak përpara mbajtjes së Universitetit Veror (kur vijnë studentët të shteteve tjera) apo kur ndodh ndonjë gjë e jashtëzakonshme (Ilazi 2006).

Të gjitha nivelet e administratës në mënyrë të vazhdueshme kanë shkelur kornizën ligjore sikurse edhe mendohet se janë përfshirë në korrupsion. Një nga praktikat joligjore më të përhapura është regjistrimi i më shumë studentëve sesa është paraparë. Pasi që një gjë e tillë paraqet të hyra të konsiderueshme për fakultete, një numër i metodave janë për-

dorur. Shumë profesorë mund t'a konfirmojnë që shumë studentë janë pranuar mbi numrin e planifikuar dhe askush nuk e din se sa. Edhe pse numrat e "indeks"-ave fillojnë nga zero, një numër i profesorëve mund të konfirmojnë që pas disa javëve vijnë studentë me numra shumë më të mëdhenj të indeksit sesa që ka qenë kufiri i pranimi. Po ashtu ka qenë e vështirë që të mësohet numri i përgjithshëm i studentëve kur një gjë e tillë ishte nevojitur për zgjedhjet në UP. Përshtypja për korrupsion është po ashtu mjaft e përhapur. Në mesin e rasteve të vërtetuara është edhe rasti me bufetë e studentëve, të cilat në mënyrë jo ligjore u janë dhënë me qira anëtarëve të familjes të profesorëve. Një gjë e tillë paraqet haptazi shkelje të ligjit për Arsimin e Lartë në Kosovë.

Politizimi

Siç është përkrahur më lartë, që nga themelimi UP-ja është konsideruar mjet për emancipim të gjerë të Kosovës. Si i tillë, UP-ja shpejtë ka marrë ngjyra etnike, me disa politikanë serbë të frikësuar që ky do të fuqizojë shumë shqiptarët. Në anën tjetër, politikanët dhe intelektualët shqiptarë e kanë konsideruar këtë si burim të rilindjes së re kulturore dhe politike për shqiptarët e Kosovës. UP-ja ka ndërtuar kuadro të intelektualëve që gradualisht kanë sfiduar dominimin politiko-administrativ serb në institucione të ndryshme dhe politikën lokale.

Gjatë viteve të '90, UP-ja ka shërbyer si një shtyllë e organizimit shoqëror. Me gjithë pritjet e disave, është e natyrshme që një institucion i tillë nuk mundet që në mënyrë të befasishme ta shohë vetveten në një pozitë tjetër, prandaj ai vazhdon ta konsiderojë vetveten si subjekt më rëndësi politike. Ky punim është i bindur që ka ardhur koha që kosovarët të vetëdijësohen për një rol të ndryshëm që duhet ta ketë universiteti.

Burime të ndryshme kanë interpretuar politizimin në mënyra të ndryshme. Sipas Enver Hoxhaj, UP-ja në të kaluarën, pos funksionit edukativ, ka pasur edhe rolin politik, gjë që, sipas tij, tashmë duhet të ndalet. "Ndikimi i partive politike është aq i madh sa edhe i Lidhjes së Komunistëve para vitit 1989", tha Hoxhaj, duke specifikuar se të gjitha dokumentet bëhen si kompromise për t'u ruajtur pozita personale e atij ose këtij individi (Filipaj 2003: 7). Madje edhe kryesuesi i atëhershëm i Zyrës së SHBA-ve në Prishtinë ka bërë thirrje për arsim, e jo politikë në UP. Gazetarët shpesh kanë trajtuar konfliktin e krijuar për shkak të kontrollit të MASHT-it nga LDK-ja dhe kontrollit të UP-së nga PDK-ja. "Në emër të ligjshmërisë dhe të depolitizimit, Qeveria e Kosovës më 26 korrik 2005 i shkarkoi strukturat udhëheqëse të UP-së, duke caktuar një Këshill drejtues të përkohshëm prej shtatë anëtarëve (tre nga Rektorati dhe katër nga Ministria e Arsimit), si udhëheqje e ligjshme" (Kadriu 2006: 3). Ky rol i ri i UP-së duket qartazi por ndryshimi i praktikave është më vështirë të bëhet sesa të thuhet.

Që politizimi ka qenë problematik është e vërtetë por çështja është shumë më serioze se kaq. Edhe pse një analizë e partive nuk është fushë e studimit të këtij punimi, mjafton që të thuhet se për të gjitha partitë politike në Kosovë dy burimet kryesore të pushtetit që ato kanë janë kontrolli i ekzekutivit dhe dhënia e vendeve të punës dhe pozitave prestigjioze për anëtarët e tyre. Si rezultat, si për organizatat tjera publike, as nga UP-ja nuk mund të pritet që të spastrohet politika. Sidoqoftë, nëse vendosen drejtues të mirë në pozita udhëheqëse, promovohen praktika dhe standarde të mira dhe konkurruese, ajo pak politikë që nuk mund të largohet nga UP-ja nuk do të jetë problem i madh.

Siç është thënë më lartë, politizimi është ekzagjeruar si problem, ndërsa mungesa e menaxhimit, kontrollit të cilësisë dhe politikave të mira janë minimizuar. Për më tepër, punimi argumenton që marrëdhëniet ndërqeveritare duhet të përmirësohen, ashtu siç duhet të përdoren edhe mjetet financiare dhe mjeteve tjera jo-ndërhyrëse për të ndikuar në politika.

Përcaktimi i cilësisë

Më lartë është ilustruar shkalla e cilësisë në UP dhe në institucionet private. Kjo pjesë përqendrohet në politikat ekzistuese me qëllim të ngritjes së cilësisë. Kosova dështon në një nga faktorët thelbësorë për cilësi në mësimdhënie, në përpjestimin e studentëve me profesorët. Jo vetëm që Kosova arsimon më pak nxënës se vendet e rajonit, por këtë e bën edhe me më pak personel.

Nisma kryesore për kontrollimin dhe rritjen e cilësisë është themelimi mjaft me vend i Agjencisë Kosovare të Akreditimit (AKA). Një nga problemet ka qenë diskrecioni i ministrit në emërimin e anëtarëve të bordit si dhe mungesa e kriterëve në legjislacionin që duhet të përdoret për akreditim. Problem tjetër është edhe shpresa tejet e madhe në AKA-në. Përderisa forcat në treg nuk paraqesin një shkallë më të lartë të cilësisë, ku AKA-ja do të përbente vetëm një filtër të hollë shtesë, nuk do të ketë rritje të ndjeshme të cilësisë. AKA është vetëm një institucion i domosdoshëm i cili duhet të krijojë një nivel minimal nën të cilin asnjë institucion i lartë nuk mund të bie.

Madje vonesa e deritanishme u pa si problematike vetëm për shkak se diplomat private nuk janë verifikuar. "Vonesa e theme-limit të kësaj agjencie ka bërë që kuadrot që përfundojnë studimet në sektorin privat dhe atë publik të arsimit të mos i nënshtrohen një kontrolli të mirëfilltë të dijes me të cilën pajisen... Sipas zv. ministrit Berisha, mungesa e AKA-së ju ka krijuar teren të përshtatshëm institucioneve private të arsimit, të cilat sipas tij më shumë po përpiqen të përfitojnë materialisht sesa të ofrojnë cilësi... (Kupina 2005: 4). Një qëndrim i tillë është mjaft i pavend për arsye se nxjerr në pah iluzionin e Ministrisë që beson se sektori publik po ecën mirë.

Vendi	Përpjestimi student/mësi mdhënës
Moldavi, Rep. e Sllovakisë	12
Bullgari, Lituani	13
Bellorusi	15
Shqipëri, Estoni, Ukrainë	16
Rusi, Ukrainë	18
Sloveni	19
Rumani	21
Letoni, Poloni	22
Maqedoni	23
Kroaci	26
Kosovë	39

Burimi: Qendra Evropiane për Arsim të Lartë

Në përgjithësi, të dyja krijimi i duhur i AKA-së dhe i mjeteve tjera duhet të jenë pjesë e një kornize të: politikave të duhura, pajtueshmërisë me standardet e BE-së, reformave dhe konkurrencës.

Shtytja që institucionet të orvaten vetë për cilësi

Është thelbësore që mandati i AKA-së dhe standardet e akreditimit janë të njëjta për të dy sektorët si në atë publik ashtu edhe në atë privat. AKA-ja poashtu duhet të ngarkohet me vlerësimin e programeve të reja, të krijojë komisione të përhershme të ekspertëve

me standarde dhe indikatorë të përcaktuar dhe të krijojë një sistem informativ për programet dhe institucionet e akredituara. Shtë poashtu e rëndësishme që autoritetet të janë në pajtim me trendet ndërkombëtare dhe jo të tentojnë ta mbingarkojnë me rregulla përmbajtjen dhe përgatitjen e arsimit detalisht, diç që është relaksuar në Evropën perëndimore mjaft kohë më parë.

Edhe pse akreditimi është obligim ligjor, MASHT-i duhet të krijojë legjislacion që nuk rritë byrokracinë, por të përdorë qasje të “shkopit dhe karrotave.” Për shembull, një institucion që nuk arrin të akreditohet humb të drejtën për të marrë subvencione nga shteti. Institucionet që mbesin të paakredituara për 5 vite nuk gëzojnë të drejtën për kurfarë fonde publike. Siç u cek më herët, MASHT-i duhet të përdorë mjete të cilat ndikojnë rregullat e lojës në atë mënyrë që të nxisë institucionet e arsimit të lartë të shquhen për konkurrencë të hapur. Këto mekanizma kategorizohen përgjatë tri instrumenteve themelore të politikave: (a) normative: korniza ligjore për të siguruar autonomi dhe llogaridhënie, (b) kontrolluese: sistemi për akreditim dhe vlerësim, dhe (c) ekonomike: shpërndarja e burimeve dhe promovimit të konkurrencës.

Kontrolli i brendshëm nga institucionet përkatëse

Në përgjithësi, vetëm një lloj vlerësimi i brendshëm bëhet në universitet, nga vetë studentët në lëndët ku vetë profesorët e marrin nismën. Derisa një vlerësim i tillë në UP ose nuk bëhet ose nuk merret parasysh, në disa institucione private kjo merret parasysh shumë. Mirëpo ka brenga se ky mekanizëm nuk mund të përdoret si i vetëm. Sipas But Dedaj, “Profesorët që kërkojnë më së paku, për studentët janë të mirë ndërsa ata profesorë që kërkojnë shumë prej studentëve, humbasin gjatë vlerësimit të tyre” (Dedaj 2005). Sidoqoftë, akoma nuk janë publikuar rezultate të tilla nga UP-ja, dhe as që janë zhvilluar mekanizma për marrjen e masave më pas. Fatkeqësisht, ky mekanizëm gjysmak mbetet vlerësimi i vetëm në institucionet arsimore të larta. Trupi më i lartë në UP për çështjet akademike, Senati ka zyrtar për politika akademike të cilët marrin honorar për vlerësim. Fatkeqësisht, kontrolli pothuajse nuk ekziston fare.

Një mekanizëm tjetër që i mungon Kosovës është mungesa e krahasimit të institucioneve, që pamundëson shndërrimin e studentëve në klientë të informuar dhe të dijnë se ku janë duke investuar kohën dhe resurset e tyre. Një mekanizëm i tillë do të mundësonte informata më të mira që do të nxiste konkurrencën dhe do të rriste cilësinë.

Kuptohet që nuk ka as vlerësim të jashtëm të cilësisë apo vlerësim profesional në fakultete. Në vendet tjera, shumica e profesorëve vazhdimisht iu nënshtrohen vlerësimeve, lidhur me botimet, për teknologjitë apo shkathtësitë e reja që kanë mësuar, teknikat e përdorura dhe kjo është vetëm minimumi i asaj që kërkohet për ta mbajtur vendin e punës. Një çështje tjetër është frika që shumë tituj akademik janë dhënë padrejtësisht dhe se shumica e ligjëruesve në UP mund të jenë posedues të kualifikimeve të tilla. Para se të bëhej rektor, Enver Hasani shprehi dyshimin se plagjiatura ishte shumë e përhapur në UP, “janë një grup profesorësh mashtrues brenda UP-së që përfituan brenda natës nga

titujt e falsifikuar akademik duke krijuar karriera akademike falso”, deklaroi Hasani për Balkan Insight. “Asnjë nga tezat e tyre të doktoraturës...nuk gjenden as në bibliotekat UP-së, sepse janë punuar shkel-e-shko pa cilësi të duhur akademike” (Gashi dhe Limani 2006).

Arsimi i lartë i komuniteteve dhe Universiteti i Mitrovicës

Universiteti i Mitrovicës, mundësia e vetme për serbët në Kosovë, padyshim që është në gjendje më të keqe sesa UP-ja. Universiteti i Mitrovicës është zhvendosur nga Prishtina në vitin 1999 kur drejtuesit e vendosur nga regjimi i Millosheviqit nuk ishin të gatshëm që të praninin kthimin e shqiptarëve në këtë institucion duke u zhvendosur në veri, në të vetmen zonë urbane ku serbët janë shumicë. Sipas Grupit Ndërkombëtar të Krizave (ICG), Universiteti në veri të Mitrovicës ka vuajtur në aspekt të “ritmit të mësimdhënies, i cili tash është i organizuar vetëm një herë në muaj, kur ligjëruesit nga universitetet e Beogradit, Nishit dhe Novi Sadit kontraktohen të ligjërojnë deri në gjashtë orë brenda një apo dy ditëve”. ICG-ja citon një burim tjetër që thotë se ky organizim qesharak i universitetit ishte produkt i qeverisë së Serbisë për të mbajtur Universitetin e Prishtinës me çdo kusht (ICG 2006: 22). Puna akademike nuk është serioze, duke u motivuar vetëm nga pagesa e lartë.

Mbi të gjitha, serbët e Kosovës kanë nivelin më të lartë të shkollimit, pasuar nga shqiptarët. Sa i përket komuniteteve tjera më shkollimin më të ulët qëndron komuniteti rom-ashkali-egjiptash (RAE) dhe trend i njëjtë ekziston edhe për shkollimin e mesëm. Vetëm në arsimin primar shqiptarët radhiten më lartë (HDR 2004: 29).

Analiza demografike dhe arritjet në arsim

Përqindja e njerëzve 15 vjeçar e përmbi, sipas arsimit

	Pa shkollë	Më pak se shkollë fillore (1-3vite)	Më pak se shkollë fillore (4-7vite)	Shkollë fillore	Më pak se shkollë të mesme (9-10 vite)	Shkollë të mesme (11-12)	Shkollë të lartë	Universitet e më lartë
Shqiptarë	0.82	1.9	11.5	30.82	7.34	37.87	8.15	1.6
Serbë	1.5	2.36	7.89	13.62	5.41	56.87	10	2.36
REA	5.49	10.02	19.33	37.95	5.25	20.53	1.43	0
Të tjerë	0.94	1.88	15.95	34.71	6.94	30.59	7.88	1.13
Rural	0.97	2.25	12.98	33.7	7.2	36.04	5.91	0.94
Urban	0.95	1.88	9.46	24.14	7.01	43.15	10.94	2.47
Meshkuj	0.57	1.6	7.52	20.77	8	48.21	10.99	2.33
Femra	1.35	2.57	15.25	37.95	6.22	30.31	5.42	0.94

Burimi: HDR 2004: 120

Mbi të gjitha, institucionet aktuale të arsimit të lartë nuk i përmbushin nevojat e të gjitha komuniteteve. Komunitetet joserbe janë duke studiuar në UP. Në tërësi në vitin 2004/2005 kanë qenë 125 studentë boshnjakë të regjistruar në të gjitha vitet, 114 turq dhe 25 tjerë që tregojnë një regjistrim të ulët krahasuar me numrin e popullsisë së tyre. Bashkësitë serbe dhe boshnjake “mund të arsimohen në gjuhën e tyre vetëm përmes strukturave paralele apo edhe në Shkollën e Biznesit në Pejë apo Fakultetin e Pedagogjisë në Prizren, të cilat ofrojnë mësim edhe në gjuhën boshnjake” (Këshilli i Evropës 2006: 29).

Këmbëngulësia në “shkollimin paralel” financiar nga Ministria Serbe e Arsimit dhe Sportit dhe bërë sipas planprogramit serb ka ruajtur një sistem të ndarë të arsimit. Këshilli i Evropës e pranon që një gjë e tillë paraqet një sfidë serioze për unifikimin e sistemit arsimor (Këshilli i Evropës 2006: 27). Duke ditur gjendjen e rëndë politike dhe nevojën për arsim të lartë adekuat në veri, një numër i zgjidhjeve janë dhënë deri më tani. “Një alternativë do të mund të ishte financimi i fakulteteve të veçanta në Universitetin ekzistues të Mitrovicës. Universiteti i shërben një rajoni të gjerë në Serbi, duke përfshirë Novi Pazarin dhe Nishin. 10.000 studentë janë të regjistruar, ku 1.500-3.000 studentë janë të rregullt apo që jetojnë në afërsi” (Langdon 2006: 8). Sidoqoftë, pasi që Universiteti i Mitrovicës udhëhiqet nga njerëz të pandershëm, propozimi ka lëvizur drejt një institucioni tre-gjuhësor “me mjete financiare të marra nga organizata të njohura ndërkombëtare”, që në masë të konsiderueshme është modeluar sipas Universitetit të Evropës Juglindore (UEJL) në Tetovë, Maqedoni.²


Për më tepër “duhet të ndërmerren hapa shtesë për të zgjidhur çështjen e integritetit të gjitha segmenteve të shoqërisë kosovare në sistemin e ri arsimor. Kjo duhet të bëhet sidomos për komunitetet serbe dhe rome të Kosovës të cilat janë të izoluara në enklava të ndara nëpër pjesë të ndryshme të Kosovës” (HDR 2002: 8). Duhet të krijohen kuota të pranimit për komunitete tjera, siç janë turqit, boshnjakët, romët dhe goranët si dhe mekanizma shtesë për të inkurajuar ata që të aplikojnë si dhe të diplomojnë.

² Se një institucion i tillë është i dobishëm është vërejtur nga analistë të demokratizimit (për një analizë interesante të ndikimit të një institucioni të tillë shih: Mason 2005: 20-23).

Pjesëmarrja dhe pagesat

Siç ilustron punim, shkalla e pjesëmarrjes së kosovarëve në arsimin e lartë është më e ulët krahasuar me vendet e rajonit. Shkalla e ulët e regjistrimit (veçanërisht duke pasur parasysh cilësinë e ulët) ia pamundëson Kosovës për të bërë ekonominë e saj konkurruese për investime fitimprurëse.

Sa i përket numrit të studentëve të regjistruar në arsimin e lartë Kosova renditet në mesin e vendeve më nivelin më të ulët. Për vitin 2002/2003 Kosova është radhitur nën Shqipërinë, krejt në fund të listës (shih grafikonin). Siç argumentohet më vonë në punim, numri i personave të arsimuar brenda popullatës është një indikator i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik, dhe ishte pjesa më e rëndësishme e strategjive zhvillimore të vendeve si Singapuri, Koreja e Jugut. “Që nga viti 1960 Koreja e Jugut ka trefishuar numrin e të diplomuarve, në krahasim me popullatën e përgjithshme, duke u ngritur nga vendi i 21-të në të 3-tin në radhitjen e Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD)” sa i përket vijueshmërisë së arsimit pas mbarimit të shkollës së mesme (Schleicher 97).



Burimi: Të dhënat nga Byroja Amerikane e Regjistrimit të Popullsisë, UNESCO dhe ESK për Kosovë .

Gjatë vitit akademik 2000/2001, 20.227 studentë ishin regjistruar në UP përfshirë fakultetet dhe shkollat e larta, prej të cilëve 14.596 (72%) të rregullt dhe 5.681 (28%) me korrespondencë. Këto të dhëna paraqesin rreth 10% të popullatës së përgjithshme të Kosovës të moshës 19-25 vjeçare (HDR 2002: 56).

Pasi që regjistrimi nuk nënkupton domosdoshmërisht numrin e të diplomuarve, ky i fundit është një indikator edhe më i mirë. Përsëri, edhe në këtë aspekt Kosova është në fund të listës, me vetëm 0,12% të diplomuar në krahasim me popullatën e përgjithshme në vitin 2001/2002 dhe me 0,13% në vitin 2002/2003. Në tërësi, sipas faqes elektronike të

UP-së, në Kosovë nga viti 1969/70 deri më 2004 kanë diplomuar 33.151 studentë në fakultete dhe 18.785 studentë në shkolla të larta profesionale. Shifra e parë përbën vetëm 1,66% (të numrit të popullatës për vitin 2005), aq sa dalin nga Sllovenia për dy vite. Një anketim i bërë nga Enti i Statistikës së Kosovës ka treguar që ndërmjet 7,2% në vitin 2001, 6,3% në vitin 2002 dhe 7,4% në vitin 2003 të njerëzve me moshë prej 15-64 posedojnë “tituj të shkallës së tretë” (duke përfshirë edhe tituj të lartë profesional). Të dhëna të ngjashme dalin nga një anketim i bërë me numrin më të madh të të anketuarve të bërë ndonjëherë në Kosovë (rreth 7%). Të pyetur rreth viteve të shkollimit që kanë ndjekur, përvoja tregon që shumë nga të anketuarit kanë ndjekur 16 vite shkollim por kurrë nuk kanë marrë diplomë. Duke pasur parasysh që vetëm të rriturit janë anketuar, atëherë del që përqindja e përgjithshme e të diplomuarve brenda shoqërisë është diku rreth 3-4%.

Shteti	Nr i studentëve për 100.000 banorë
Kosova	1.387
Shqipëria	2.2
Maqedonia	2.537
Sllovakia	2.756
Rumania	2.856
Moldavia	2.87
Bullgaria	2.929
Kroacia	3.341
Bjellorusia	3.43
Hungaria	4.034
Federata Ruse	4.51
Polonia	4.843
Estonia	4.86
Lituania	4.954
Ukraina	5.12
Sllovenia	5.229
Letonia	5.504

Burimi: Qendra Evropiane për Arsim të Lartë.

like – të gjitha vendet më të cilat e kemi krahasuar Kosovën, kanë shfrytëzuar sektorin privat në një shkallë më të lartë sesa Kosova, dhe një pjesë më e madhe e parave të saj shkojnë për arsimin e lartë. Shumica e këtyre vendeve shumë kohë më përpara kanë filuar të pranojnë studentët me pagesë.

Në Universitetin e Prishtinës studentët me korrespondencë paguajnë 500 euro për semestër, studentët e rregullt 50 euro, ndërsa 250 euro paguajnë studentët me vetë-financim. UP-ja për çdo vit jep një numër të konsiderueshëm të bursave për studentë të

Fatkeqësisht, për vitet e ardhshme, trendet për të rinjtë janë edhe më negative. Kosova është shumë larg vendeve tjera sa i përket shkallës së pjesëmarrjes në arsimin e përgjithshëm të personave të moshës prej 14-19 vjet: me 44%, krahasuar me mbi 60 të Maqedonisë (ESK 2001: 55). Padyshim, çështja nuk ka të bëjë vetëm me numrin e të arsimuarve, por gjithashtu edhe me cilësinë që diskutohet në këtë punim. Por numri është një indikator i rëndësishëm për konkurrencën rajonale. Dallime të tilla mund të vërehen qartazi, “përderisa 82% e rinisë së moshës universitare në SHBA vazhdojnë universitetin, në Indi vetëm 7% e bëjnë një gjë të tillë (prej numrit të përgjithshëm 10 milionësh” (Moreau 2005-2006: 94).

Rritja e pjesëmarrjes mund të tingëllojë për disa lexues si një argument për rritjen e menjëhershme të shpenzimeve të qeverisë. Ky punim nuk përjashton një mundësi të tillë, por ekzistojnë mekanizma të ndryshëm për të rritur pjesëmarrjen pa rritur shpenzimet e qeverisë. Mbi të gjitha Kosova shpenzon në arsimin njësoj si shumica e vendeve tjera (si përqindje e BPK-së) por nxjerr më pak fitim nga kjo. Prandaj, çështja nuk ka të bëjë me shpenzimet publike

rregullt (që janë më të subvencionuarit), të cilët janë regjistruar në vitin e dytë, kanë notën mesatare mbi 9 dhe nuk kanë përsëritur vitin. Për më tepër, në bazë të nenit 27.4 të Ligjit të arsimit të lartë në Kosovë, Senati i UP-së ka marrë vendim që studentëve të UP-së që nuk financohen nga fondet publike, por që arrijnë rezultate të shkëlqyera në mësim, mund t'iu ofrohet një vend studimi i cili financohet nga fondet publike, por që arrijnë rezultate të shkëlqyera në mësim nga viti i dytë i studimeve, ose në vitin pasardhës të studimit (Bojaj 2005: 7).

Në vitin 2006, 6.825 maturantë kanë konkurruar në Universitetin e Prishtinës, prej të cilëve 1.636 në Fakultetin Juridik (po ashtu fusha më e preferuar edhe në një numër institucionesh private). Prej tyre, 1.577 kanë aplikuar për 400 vende të financuara me fonde publike, dhe vetëm 22 për 200 vendet e reja me vetëfinancim.

Në vjeshtë të vitit 2006, UP-ja ka pranuar 4.676 studentë të rregullt (që paguajnë 60 euro për semestër), 880 për ata me korrespondencë që paguajnë kështu të ndryshme për fakultete të ndryshme varësisht nga çmimet e tyre (350-560 euro për semestër), dhe 1.269 studentë me vetëfinancim që paguajnë rreth 250-1000 për semestër. Këtë vit, UP-ja ka pranuar edhe 107 studentë për pakicat jo-serbe, 257 nga Shqipëria, Mali i Zi, Serbia dhe Lugina e Preshevës.

**Pagesat në Universitetin e Prishtinës
Pagesat për regjistrim për të gjithë studentët:**

a. PAGESA PËR REGJ. (TË RREGULLT)	30
b. PAGESA PËR REGJ. (ME KORRESPONDENCË)	30
c. PAGESA PËR REGJI STRIM PËR STUDENTËT JO - KOSOVAR	30

Pagesat për shkollim të studentëve kosovarë:

a. PAGESA PËR SHKOLLIM (SEMESTËR/ TË RREGULLT)	50
b. PAGESA PËR SHKOLLIM (SEMESTËR/ME KORRESPONDENCË)	150
c. PAGESA PËR SHKOLLIM (SEMESTËR/PASDIPLOMIKE)	400
d. PAGESA PËR MBROJTJEN E MAGJISTRATURËS	800
e. PAGESA PËR MBROJTJEN E DISERTACIONIT TË DOKT.	1000

PAGESA PËR SHKOLLIM PËR STUDENTËT JO - KOSOVARË:

a. PAGESA PËR SEMESTËR (TË RREGULLT JO-KOSOVAR)	80
b. PAGESA PËR SHKOLLIM (SEMESTËR/ME KORRESPONDENCË)	240
c. PAGESA PËR SH KOLLIM (SEMESTËR/ PASDIPL.)	600
d. PAGESA PËR MBROJTJEN E MAGJISTRA - TURËS	1000
e. PAGESA PËR MBROJTJEN E DISERTACI - ONIT TË DOKT.	1500

Tjera:

a. PËR PROVIM	2
b. PËR PROVIMIN E STUDIMEVE PASDIPLOMIKE	40
c. PËR CERTIFIKATË TË NOTAVE	5
d. PËR INDEX	10
e. PËR PRANIM TË PROVIMIT	10
f. PËR DIPLOMË/NDËRRIM TË FAKULTETIT	50

Këto shifra përputhen me vlerësimin e rektorit të ri që “pagesa është shumë e lartë krahasuar me arsimimin që ofrohet” (Kadriu A, E. Gojnovci 2006: 4). Duke vërejtur që fakultetet në mënyrë individuale kanë ngritur disa nga pagesat, rektori Hasani është përpjekur që të centralizojë shpenzimet e studentëve.

Regjistrimi në arsimin e lartë		
Viti	Nr. i studentëve	Regjistrimi në arsimin e lartë (%)
1970/1971	10.368	15,2
1980/1981	43.321	20,6
1990/1991	29.016	10,9
1995/1996	21.632	11,6
2000/2001	20.277	7,5
2002/2003	21.175	5

Burimi: Të dhënat për vitin 1970 deri në vitin 2001 janë marrë nga KEC, “Disa aspekte të efikasitetit në arsimin e lartë në Kosovë, 2002. Të dhënat për vitin 2002/2003 janë marrë nga ESK, “Statistikat sociale: Arsimi i lartë në Kosovë” 2003.


për shumë studentë duke paguar pjesërisht studimet e tyre” (Schleicher 2005-2006: 97). Ngjashëm, përderisa numri i studentëve të financuar nga shteti ka mbetur i njëjtë në Bullgari, numri i atyre me “fonde të veta” është rritur nga 10.401 në vitin 1991 në 120.321 në vitin 1997, më tepër se gjysma e atyre nën “financim nga shteti” (Brunner 1999).

Në vend të pagesës së një shume të caktuar drejt institucioneve për të siguruar arsim të lartë, shumica e këtyre vendeve kanë përshtatur teknika të ndryshme për t’u ndihmuar studentëve për regjistrim në arsimin e lartë, p.sh. duke ju ofruar studentëve kredi me kamata

tejet të volitshme. Për më tepër, në vendet tjera shumë studentë mund të kryejnë punë të ndryshme për të marrë rrogë, si punë në bibliotekë apo të ngjashme, gjë që në Kosovë nuk është praktikuar as në institucionet private.

Përderisa Kosova, krahasuar me fqinjët e saj ka arsimuar më pak studentë, në të njëjtën kohë e ka parë të arsyeshme që të ndihmojë financiarisht shumicën prej tyre. Si rezultat, do të ishte më e dobishme që këto fonde të shpërndahen tek sa më shumë studentë që të jetë e mundshme.

Ekzistojnë disa mënyra për të rritur nivelin e regjistrimit. Rritja e financave publike është e vështirë dhe jo domosdoshmërisht e nevojshme. Përderisa ka mjete financiare për më të mirët dhe për ata që kanë nevojë, fondet private duhet të shfrytëzohen më tepër. “SHBA-të dhe shumë vende tjera anglofone, sikurse edhe Japonia dhe Koreja e Jugut, kanë hapur arsimin të lartë



Burimi: Llogaritjet e bëra në bazë të të dhënave të papërpunuara nga www.uni-pr.edu

Një rreze e vogël shprese është sektori privat i arsimit. Themelimi i shkollave të tilla është argument se ekzistojnë burime të pashfrytëzuara nga vetë studentët që dëshirojnë të paguajnë për arsimimin e tyre, qoftë se ata nuk mund të pranohen në ato universitete ku ofrohet arsimim i subvencionuar apo sepse kanë gjetur cilësi më të mirë.

Përderisa cilësia është diskutuar përgjatë punit, kjo pjesë shkurtazi hedh një vështrim mbi pagesat që bëhen në këto shkolla. Për një kohë të gjatë në shkollën e vetme të gazetarisë në Kosovë “Faik Konica” pagesa ka qenë 1.000 euro (në vitin 2002/2003), 1.150 euro (në vitin 2003/2004) dhe 1.500 euro (në vitin 2004/2005). Në KASHS (FAMA) çmimi është 1.300. Në universitetin AAB çmimi është 900 euro për fakultetin ekonomik. Në Rezonancë çmimi për të studiuar fizioterapinë është 5.000 për një vit (pa përfshirë librat), ku përfshihet uniforma, një shujtë ditore dhe një udhëtim jashtë vendit. Pothuajse në të gjitha institucionet private të arsimit të lartë lejohen pagesa me këste (3-4 këste në vit) (me efekte të dyshimta në rigozitetin akademik).

Sektori privat në vazhdimësi ka tërhequr një numër të konsiderueshëm të studentëve. Siç tregon pjesa tjetër e punimit, në aspekt të shpenzimeve individuale të klientëve, shpenzimet në sektorin privat shpejt do ta arrijnë shpenzimet e sektorit publik. Ky argument lehtë mund të shndërrohet në argument ideologjik. Dallime të mëdha mund të vërehen ndërmjet SHBA-ve dhe Evropës. Siç edhe thekson një autor:

Shpenzimet mesatare qeveritare për një student në arsimin e lartë në Bashkimin Evropian janë më të ulëta se në SHBA. Evropa akoma tenton të bllokojë universitetet nga përdorimi i pagesave për mësim, me mendimin që duke i detyruar studentët që të paguajnë do të dëmtojë të varfrit. E vërteta është që shpenzimet për arsimin e lartë në Evropë janë regresive, ku fëmijët e klasës punëtore janë skajshmërisht të nën-përfaqësuar (Schleicher 2005-2006: 97).


Problemi është që edhe me mjete të njëjta financiare, numri i të regjistruarve është në konflikt të drejtpërdrejt me cilësinë që ofrohet. “Fakti që në vitin akademik 2005-2007, është pranuar një numër enorm i studentëve përkundër dëshirës së mirë që të rritet numri i studentëve, është një e metë tjetër e UP-së, e cila vetëm sa i rëndon dhe vazhdon të rëndojë edhe më tej kushtet e studimit” (Kadriu 2006: 4).

Për vjeshtën e vitit 2006, UP-ja ka pranuar 4.676 studentë të rregullt (që do të paguajnë 60 euro për semestër, 880 me korrespondencë (me orar të plotë por pa paraqitje) që do të paguajnë shuma të ndryshme varësisht nga fakulteti (350-560 euro për semestër), dhe po ashtu 1.269 studentë me vetëfinancim që do të paguajnë 250-1000 euro për semestër. Këtë janë pranuar edhe 107 studentë nga pakicat jo-serbe, 257 nga Shqipëria, Mali i Zi, Serbia dhe Lugina e Preshevës.

Politika financiare

Siç është përshkruar përgjatë punimit, problemet janë të shumta. Një numër i problemeve burojnë nga politikat financiare të reja dhe të trashëguara kundrejt arsimit të lartë. Edhe pse qëndrimi i këtij punimi është se shumica e ndryshimeve që sugjerohen nuk kërkojnë shumë para, zgjidhja e disa prej tyre përfshin shpenzime financiare serioze dhe nuk mund të pritet që të përmirësohen pa fonde shtesë të shpërndara në mënyrë konkurruese.

Një problem në këtë aspekt është rënia e arsimit të lartë si prioritet. Në të kaluarën, arsimi është konsideruar si mjet shtet-formues, shpesh kryesori. Me realizimin e një funksioni tjetër të arsimit të lartë, në vend të ngritjes së financimit, shumë vende kanë ndaluar financimin. Vendet në tranzicion janë përballur me një situatë të pasuksesshme, me krizë të burimeve sikurse me një rënie të vëmendjes kushtuar arsimit të lartë si mjet shtet-formues. Ky punim vetëm analizon politikat e Kosovës kështu që analiza e sistemit para-prak nuk trajtohet këtu.



Në përgjithësi, buxheti ndahet për këto programe: institute, arsim me nevoja speciale, dhe për Bibliotekën Kombëtare dhe administratën qendrore (Ministria e Ekonomisë dhe Financave “Buxheti për vitin 2005”, f. 70). MASHT-it me buxhetin e vitit 2005 i është ndarë një shumë mjetesh prej 7.777.390 euro për projekte kapitale. Ndonëse buxheti i Kosovës për arsim në Kosovë në vitin 2001 ishte vetëm 3% të BPK-së së saj, kjo shifër u rrit për më tepër se dy herë në vitin 2003, duke e radhitur Kosovën në mesin e shpenzuesve më të mëdhenj në terma relativ. Shpenzimet publike në arsim përbëjnë rreth 25% të buxhetit të përgjithshëm të Kosovës, ku rreth 80% shpenzohen për rroga të mësuesve (raporti buxhet/rroga është i krahasueshëm me vendet tjera të Evropës Juglindore).

Është e rëndësishme që të theksohet që edhe pse Kosova shpenzon më shumë se shumica e vendeve tjera (në terma relativ si % e BPK-së së saj), ajo regjistron dhe diplomon me pak studentë sesa vendet tjera. Njëjtë sikur vendet tjera të regjionit, Kosova vazhdon

të financojë institucionet publike të arsimit të lartë pa marrë parasysh cilësinë e tyre, efikasitetin, përputhjen me standarde të ndryshme, numrin e profesorëve me orar të plotë, numrin e mbajtësve të titullit doktor i shkencave, në mënyrë që të përmbushin kriteret e akreditimit. Kjo metodë e financimit iu ndihmon të gjitha institucioneve që të mbijetojnë, sidoqoftë, ajo ka një mangësi të madhe,

“krijon një mjedis statik për sektorin publik, jo stimulues, dhe të udhëhequr nga plogështia. Ato nuk garojnë për financime, nuk kanë stimulum për t’u bërë më produktiv dhe nuk japin efikasitet të duhur, nuk vlerësohen e as që kanë për të prodhuar “vlerë publike për para publike” (Brunner, 1999: 22).

Në krahasim me numrin që regjistrohen, vetëm 10% diplomojnë për një vit. Për një universitet publik që arsimon shumicën dërmuesve të studentëve me fonde publike, një shkallë e diplomimit prej 10% është një indikator që tregon se sa keq janë duke u shpenzuar paratë publike.

Shumë studentë kanë përshtypjen se pagesa e tyre vjetore prej 100 eurosh (për studentët e rregullt) mbulon arsimin e tyre, kjo shifër tregon shkallën në të cilën arsimit i lartë subvencionohet nga fondet publike. Kjo tregon që madje edhe studentët që paguajnë më së shumti (studentët me korrespondencë dhe ata me “participim”) paguajnë shumë më pak se kostoja reale për një të diplomuar. Një politikë e arsyeshme ka qenë rregulla e re që ata

	Të diplomuarit në arsimin e lartë (%)	Të diplomuar /popullësi - 2001
Kosovë (2001)	11	0.13
Kosovë (2003)	10	0.13
Shqipëri	12	0.14
SMZ**	9	0.18
Maqedoni	9	0.2
Kroaci	13	0.34
Gjermani	13	0.36
Rumani	16	0.41
Greqi	8	0.42
Rep. Çeke	15	0.43
Hungari	18	0.61
Bullgari	22	0.66
Sloveni	14	0.7
Danimarkë	20	0.73
SHBA	14	0.79
Zvicërr	34	0.79
Poloni	24	1.19

Burimi: Të dhënat nga UNESCO dhe ESK për Kosovë

me vetëfinancim mund të kthehen në studentë të rregullt (me fonde publike) pas një viti nëse e kanë notën mesatare mbi 8, por kjo stimulon vetëm këtë kategori tejet të vogël. Nëse gjykojmë sipas kriterit të koston së diplomës, madje edhe të huajt që studiojnë në Prishtinë subvencionohen pjesërisht.

Një mjet për vetë-financim dhe financimit në bazë të performancave ka qenë financimi konkurrues duke e marrur si kriter numrin e studentëve të regjistruar. Siç ka thënë ish-shëf i Departamentit të Shkencave Politike në UP “Ekziston një garë kush me marrë më tepër studentë (ka implikim në të ardhura)” (Zeneli 2003). Kjo doli shpejt jashtë kontrolli sa që vende-vende u pranuan më tepër studentë se sa që lejohej, ku askush nuk e dinte se sa studentë studiojnë në UP. Në këtë fazë çdo skemë vetë-financuese për UP-në është e paimagjinueshme. Z. Ibrahim Gashi, zëdhënës i rektoratit të UP-së pretendon që UP-ja nuk mund të jetë financiarisht e vetë-qëndrueshme. Edhe pse të hyrat e tij nga studen-

tët janë të konsiderueshme, shumica e mjeteve financiare akoma ipen nga MASHT-i. “Vetëfinancimi është një përparim i dukshëm që e rrit autonominë por edhe përgjegjësitë e UP-së në menaxhimin e aspekteve jo vetëm financiare por edhe akademike. Nga kjo presim ‘zgjimin’ e energjive të shumta kreative në UP” (Rexha 2005: 39)

Është mirë që “përfitimet nga arsimimi gjithnjë e më shumë po shikohen si private sesa publike, veçanërisht në sektorin e arsimit jo të obligueshëm” (Taylor 1999: 120). Kur është e vështirë që të rriten taksat, ka pak hapësirë që të rishpërndahen shpenzimet dhe e vetmja mundësi mbetet të mbështetja në sektorin privat.

Pasi që nuk kemi arritur që ta marrim një buxhet të hollësishëm nga UP-ja, llogaritjet tona ofrojnë disa të dhëna të përafërta. Duke shumëzuar numrin e studentëve të rregullt të llojeve të ndryshme me taksat përkatëse (taksën e diplomës, paraqitjet e provimeve) ne jemi përpjekur që t’a bëjmë një llogaritje.

Të rregullt	25.126 studentë * (100 euro pagesë vjetore + përafërsisht 30 euro shpenzime për provime)	3,266,380
Me korrespondencë	3.706 studentë me korrespondencë * 1.000 pagesë vjetore	3,706,000
Të diplomuar	3.013 studentë të diplomuar * rreth 100 euro pagesë për diplomim	301,300
	Totali (euro):	7,273,680

* llogaritur nga KIPRED bazuar në të dhëna të përafërta

euro, shpenzimet e përgjithshme sillen rreth 19-20 milion euro. Ndarë sipas numrit të studentëve të diplomuar, çmimi për diplomë është mbi 6,000 euro dhe çmimi për një student të regjistruar rreth 650 euro. Me rritje të numrit të studentëve me pagesë, të hyrat do të vazhdojnë të rriten gjithnjë e më shumë.

Problemi është se kjo ndihmë financiare fikse dhe e garantuar apo të hyra tjera opsionale janë më së paku të përshtatshme për të nxitur kualitet apo kuantitet. Është problem që kriteret për ndihmë financiare nuk marrin në konsideratë proporcionin student/profesor dhe efikasitetin e personelit për të rialokuar shpenzimin. Në aspekt të BPK-së shpenzimi i përgjithshëm për arsim është rritur me një sektor privat që po arrin shkallën e shpenzimeve publike në arsimin e lartë.

Dallimet publike-private	UP	Sektori privat
Çmimet për diplomë	6,187	?
Çmimet për regjistrim të studentëve	647	2007

* llogaritur nga KIPRED bazuar në të dhëna të përafërta

Një krahasim i dobishëm është krahasimi me institucionet private. Duke pasur parasysh që shumica e institucioneve të arsimit të lartë janë të reja, asnjë statistikë e dobishme nuk mund të bëhet lidhur me nivelin e diplomimit. Një numër i statistikave të marra nga

anketimet e IKS-it mbi numrin e studentëve në secilin institucion privat dhe pagesat që kërkojnë ato, tregojnë për të hyra rreth 7.455.460 euro për vit (Anketimi i institucioneve private nga IKS-i). Ndarë sipas numrit të studentëve, çmimi për student të regjistruar është mbi 2000 euro. Mbetet të shihet se çfarë shkalle të diplomimit do të ketë vitet e ardhshme. Nëse është vetëm tri herë më mirë sesa në UP ($10\% * 3 > 30\%$), atëherë një shifër paradoksale do të shfaqej duke treguar që arsimi privat është më i lirë.

Mund të përfundohet që duhet të bëhen investime dhe reforma të mëdha. Shumë mjete janë të gatshme dhe ato do të shtjellohen më vonë. Një mënyrë për ta rritur numrin e të regjistruarve është ofrimi i kredive për studentët, qoftë për universitet private qoftë për ato publike. Shumë vende të zhvilluara kanë pasur një rritje të vakuimit në mes të asaj se çfarë mund të ofrojnë studentët dhe çmimet e arsimit të lartë. Përgjigja më e mirë në këtë ka qenë huadhënia publike dhe private.

Se a është arsimi i lartë një e drejtë njerëzore dhe në çfarë shkalle duhet të paguajë shteti për të, është një debat pafund dhe ky punim nuk përpiqet që ta zgjidhë këtë çështje. Sidoqoftë, është e padiskutueshme që Kosova ka nevojë që të ngrit nivelin e pjesëmarrjes së të rinjve dhe të rriturve. Pasi që Kosova shpenzon më shumë në arsimin e lartë (si % e BPK-së) sesa fqinjët e saj e vetmja mënyrë për ta rritur nivelin e regjistrimit është regjistrimi i më shumë studentëve me pagesë, qoftë në universitetet private apo në ato publike. Siç është treguar më lartë, momentalisht Kosova financon studimet e të gjithë të të regjistruarve, duke përfshirë edhe ata që paguajnë tarifa të larta. Pasi që nevojitet që të rritet shkalla e pjesëmarrjes, MASHT-i duhet të zhvillojë një sistem ku studimet financohen plotësisht për më të mirët dhe për ata që kanë nevojë, dhe për të tjerët krijon plane me financim të pjesshëm. Momentalisht, një gjë e tillë nuk është duke ndodhur. Në vend që të ipen të gjitha financat në formë të granteve, pjesë të financave duhet të ipen si kredi, të cilat studentët do të mund t'i kthenin kur ata të punësoheshin. Disa teknika janë përdorur. Studentët më të suksesshëm marrin bursa, tanimë një stimulim i mirë. Një skemë për bursa sugjerohet më poshtë:

Një problem madhor është që për shkak të jo-efikasitetit të sektorit publik në arsimin e lartë, çmimi i plotë për studentë është shumë më i lartë sesa në universitetet private. Kështu që, po të krijohej kategoria e studentëve me vetë-financim në këtë fazë do të nënkuptonte që shumica e studentëve do të shkonin në universitete private.

	10% më të mirët	10% më të varfërit	20% më të mirët; /varfërit	20%	20%	20% më të dobët
bursat	bursë e plotë për shkollim	bursë e plotë për shkollim	70% të shkollimit	50% të shkollimit	30% të shkollimit	
kreditë	kredi për shpenzimet e jetesës dhe aktivitetet profesionale	kredi për shpenzimet e jetesës dhe aktivitetet profesionale	për 30% të shkollimit dhe shpenzimet e jetesës	për 50% të shkollimit	për 70% të shkollimit	për 50% të shkollimit

MASHT-i do të duhej të bënte një analizë se sa do të ishin në gjendje që të paguanin studentët potencial. MASHT-i duhet të gjejë një formulë për ti ndarë studentët në kategoritë siç është ilustruar në tabelën e mëposhtme. Po ashtu, një rritje e ndarjes së fondeve për institucionet duhet të mas efikasitetin, numrin e studentëve që regjistrohen dhe cilësinë.

Një skemë e sugjeruar për financimin e arsimit të lartë

	Studentët e rregullt (plotësisht të financuar, me një taksë prej vetëm 50 eurove)	Studentët me vetë financim	Me korrespondencë (400 euro për semestër)	Studentët me asistencë të pjesshme
2003/2004	91% (24.584)	I parëndësishëm	9% (2.324)	Asnjë
Rekomandohet	20%	20%	Kalim me gjysmë orari dhe nga distanca	80% me nivel të ndryshueshëm të asistencës varësisht nga merita dhe nevoja

Për më tepër, MASHT-i teorikisht mund të financojë pjesërisht studentët (në formë të bursave). Është e kuptueshme që pjesë të financimit duhet të vazhdojnë të ipen drejtpërdrejt tek institucionet, por duhet që gradualisht të zvogëlohen në mënyrë që të forcohet konkurrenca. Siç ka treguar përvoja në vendet tjera, universitetet që janë të akredituara duhet të marrin fonde shtesë, përveç subvencionit të përgjithshëm. Për më tepër, një buxhet i caktuar duhet shpërndahet sipas efikasitetit.

Përvoja nga vendet tjera tregon që ata të gjithë ose janë përballur ose janë duke u përballur me vendime të vështira. Përderisa Bullgaria pothuajse e ka bërë këtë ndryshim, vendet tjera të zhvilluara, për arsye të ndryshme, ideologjike, politike apo tjera, janë duke pasur akoma debate të njëjta.

Në një artikull të kohëve të fundit nga Shqipëria është thënë:

...është e pamundur që universitetet publike të mbahen financiarisht dhe të modernizohen vetëm nëpërmjet buxhetit të shtetit. Diçka e tillë ka qenë e pamundur edhe për shtete të zhvilluara europiane...është e vështirë të kuptosh arsyet se përse një shtet me burim financiare kaq të kufizuara sa ky i ynë shpenzon që të ofrojë arsim falas edhe për ata studentë të cilët janë të një niveli tepër të ulët apo me vështirësi kalojnë klasën (Kajsiu 3).

Në Francë po zhvillohet i njëjti debat:

Ne (Francë) ne kemi një sistem universitar që pothuajse tërësisht financohet nga fondet publike dhe ne mburremi më këtë. Së paku ishim kështu para se kinezët të fillojnë rangimin botëror të universiteteve. Ne kemi zbuluar se universiteti më i mirë në Francë doli i 51 apo i 52 në listën e tyre. Çdonjëri në Francë do të thoshte: "Por si është e mundur kjo? Po shkollat tona të famshme? Por Franca investon vetëm 1,2% të BPK-së së për universitet e saj, krahasuar me 3% në SHBA. Edhe nëse lehen mënjane financat private, shifrat në SHBA janë akoma 1,4%. Kështu që ne jemi shumë krenar për një sistem për të cilin ne realisht nuk investojm (Strauss-Kahn 2005-2006).

Më poshtë vijon një skemë e sugjeruar si të fillohet gradualisht me grante në baza meritore

	Faza e I-rë	Faza e II-të	Faza e III-të	Faza e IV-të
Konkurenca	Brenda institucioneve publike	Brenda Kosovës	Regjionale	Evropiane dhe globale
Bursat dhe ndihma financiare	5% të fondeve si vauçerë për përdorim vetëm brenda institucioneve publike	5% të fondeve si vauçerë për përdorim vetëm brenda institucioneve publike; 5% për institucione të akredituara brenda Kosovë	Përveç atyre në fazën e parë dhe të dytë, 5% për përdorim kudo në botë.	15% për institucione publike; 15% për kudo në Kosovë; 5% për kudo në botë
Bashkërendimi i bursave	T'ju dyfishohen bursat dhe donacionet të gjitha institucioneve publike të arsimit të lartë aq sa mund të nxjerrin ata nga burime tjera.	T'ju ipen institucioneve private 50% e bursave dhe donacioneve që ata nxjerrin nga burime tjera.	T'ju dyfishohen bursat dhe donacionet të gjitha institucioneve të arsimit për aq sa nxjerrin nga burimet tjera.	Asnjë
Ndihmat financiare nga qeveria (për lëndë të reja, hulumtime, etj.)	Grante (mësimdhënie, lëndë të reja, etj.) me vlerë 2-3% të tërë buxhetit që ipen me konkurs të hapur për institucionet publike	Grante me vlerë 4-5% të buxhetit të përgjithshëm të arsimit të lartë ku institucionet brenda Kosovës aplikojnë (1-2% rezervuar për ato publike)	Grant në vlerë prej 6-7% të buxhetit të përgjithshëm të arsimit të lartë në konkurrencë ku mund të aplikojë çdo institucion brenda Kosovës	
Kreditë	Kredi me kamata të përshtatshme për shumicën e studentëve që studiojnë në institucionet publike dhe nuk marrin bursë	Gradualisht të hapen skema kreditore për të gjithë studentët kosovarë	Të ipen kredi për studentët kosovarë që studiojnë jashtë	
Subvencionet institucionale	20% e shpenzimeve të arsimit të lartë si grant vjetor	10% si grant vjetor + 10% për institucionet e akredituara	7% si grant vjetor + 8% për institucionet e akredituara + 7% për rezultate	5% si grant + 5% për institucionet e akredituara + 10% për rezultate

Tregjet nxisin institucionet për të hapur departamente dhe fusha të reja, prej të cilave disa mund të jenë të rëndësishme strategjike e disa mund të mos jenë mjaftë fitimprurëse për të qenë atraktive për investitorët privat që t'i hapin ato. Një pjesë e financave duhet që çdoherë të ruhen për këto objektiva strategjike por jo-fitimprurëse në aspektin afatshkurtër. Për më tepër, politikat aktuale të trajtimit ndryshe dhe me kritere shumë më të larta të institucioneve private të arsimit të lartë janë kundër produktive. Një gjë e tillë jo vetëm që mbrohet një sistem jo efektiv por edhe humb çdo vit mundësinë e trajnimit të më shumë studentëve dhe ofron një de-stimulim për reformim të UP-së.

Rekomandimet

Arsimi është ndoshta arma kryesore për ndryshime rrënjësore të shoqërisë në afat të gjatë. Siç kanë bërë shumica e vendeve në rajon dhe siç tregojnë ky punim, “është i nevojshëm të rikoncepohet i tërë sistemi i arsimit të lartë si në raport me përfituesit, pra studentët, ashtu edhe në raport me shtetin” (Kajsiu 1). Fakti që shpërblimet nga përmirësimi i arsimit vijnë pas disa mandateve politike, pak politikanë i hyjnë si duhet këtij problemi dhe sytë i kanë tek një lëmi tjetër ku mund të tregohen shpejtë. Sidoqoftë, pas analizës ky punim ofron një sërë rekomandimesh se çfarë duhet bërë me arsimin e lartë.

Mbi të gjitha, arsimi i lartë duhet të vendoset lartë në agjendën e qeverisë dhe të shoqërisë civile për të rritur mundësinë e zgjedhjes për klientët dhe që gradualisht të stimulohen institucionet e arsimit të lartë për të përdorur kualitetin për të konkurruar për studentët. Reformat nuk duhet të kuptohen si proces tranzicional por si një proces që nuk përfundon kurrë, që lëviz me udhërrëfyes shumë të qartë kundrejt qëllimeve të pakuptueshme afatmesme dhe afatgjata. Dialogu gjithëpërfshirës është i domosdoshëm sepse vetëm në këtë mënyrë mund gjenden zgjidhje kreative dhe angazhim i përbashkët në veprime bashkëpunuese.

Rekomandimet e përgjithshme:

1. Oferta e planprogrameve të jetë përgjegjëse ndaj tregut. Ofrimi i lëndëve dhe hartimi i planprogramit duhet të jetë më përgjegjës ndaj forcave të tregut sesa që është tani. Mirëpo, kur ka mungesë të informatave, tregjet nuk do të ofrojnë disa nga profilet që nevojiten. Në raste të tilla, strategjia e zhvillimit të përgjithshëm kombëtar dhe marrëdhëniet dinamike në lidhje me ndryshimet e shpeshta në ekonomi duhet të tregojnë se ku duhet intervenuar dhe të përkrahen aftësi të veçanta.
2. Në mënyrë më aktive të ndjeket barasvlera ndërkombëtare e titujve dhe diplomave jo vetëm për arsim të lartë, por çka është edhe më e rëndësishme edhe për arsimin para universitar. Ndërkombëtarizimi i arsimit duhet të bëhet qëllimi kryesor i politikës arsimore në Kosovë. Kjo nuk mund të bëhet sipërfaqësisht siç është bërë deri më tani. Duhet të bëhet një rishqyrtim i përgjithshëm i të gjitha lëndëve dhe të reformohen ato sipas një plani se çfarë shkathtësi ju duhen studentëve për secilin profesion. Qeveria po ashtu duhet të promovojë praninë e universiteteve të vendeve tjera, praninë fizike të tyre apo programe nga distanca.
3. Seriozisht të shqyrtohet mundësia e provimeve pranuese të të standardizuar dhe me pyetje logjike.
4. Kriteret për kontroll të cilësisë dhe për akreditim duhet të jenë të njëjta si për UP-në po ashtu edhe për institucionet private.
5. Të analizohet mundësia e ndarjes së UP-së në katër universitete: Mjekësi, Teknik, Shkenca Natyrore dhe Shkenca Shoqërore dhe Humane.
6. Njohja e gjuhëve të vendoset si parakusht për arsim të lartë. Në vend të përk-

- thimit dhe obligimit të profesorëve për të bërë libra të tyre, politika kryesore duhet të jetë që t'u mësohen studentëve gjuhë të huaja dhe tu mundësohet atyre që të kenë qasje në një literaturë më të gjerë.
7. Të ndërmerret një studim afatgjatë me indikatorë të matshëm për zhvillimin e reformës në arsim. Një politikë e tillë duhet të monitorohet fuqishëm;
 8. Të zhvillohen politika të ndryshme për të promovuar konkurrencën. Në mes tjerash MASHT-i mund të krijojë një Fond Konkurrues që funksionon në parim të bashkëfinancimit duke favorizuar institucionet që kanë përshtatur mekanizma që garantojnë kualitet. Gjithashtu duhet të ofrohen grante bazuar në cilësi për libra të rinj, lëndë të reja, departamente të reja, profesorë të rinj, profesorë vizitorë, konsulentë të jashtëm, pajisje për qëllime të mësimdhënies, biblioteka moderne, vizita studimore afatshkurta jashtë vendit, projekte hulumtuese.
 9. Të përmirësohet shkalla e diplomimit me anë të stimulimit të studentëve që mbarojnë me kohë dhe de-stimulimit për ata që vonohen.
 10. Të kërkohet menaxhim i bazuar dhe i planifikuar në bazë të rezultateve si për nga sasia ashtu edhe për nga cilësia.
 11. Ministria apo donatorët duhet të nxjerrin një punim që vlerëson potencialin e Kosovës për sukses në konkurrencën gjithnjë e më të fortë për talent dhe të analizohet sa nga të diplomuarit tanë janë të kalibrit ndërkombëtar. Gjithashtu duhet të bëhet një analizë e nevojave të Kosovës sipas fushave, bazuar në kriterin e nevojës dhe të epërsisë krahasuese. Kjo mund të shpie që disa drejtime që nuk ekzistojnë të paraqiten si të arsyeshme p.sh. përkthimi dhe interpretimi në Prishtinë dhe/apo në Mitrovicë.

Të gjitha institucionet e arsimit duhet të...

12. fillojnë programin e praktikës për shumicën e departamenteve si një kërkesë të obligueshme dhe që kreditë të epen si pjesë e planprogramit të rregullt. Po ashtu rekomandohet që çdo departament ku ka praktikë, ajo të ketë vlerën e kredive të së paku një lënde (më së shumti dy). Praktika e tillë nuk dtth që të paguhet, tek e fundit, ajo përdoret për qëllime të marrjes së kredive nga institucionet e tyre arsimore. Shumë studentë mund punësohen në institucione, por kjo nuk ka nevojë që të bëhet si kërkesë apo si pritje siç ka qenë gjatë viteve të '80.
13. përqendrohen në mësimdhënien e shkathtësive/aftësive. Strategjikisht, Kosova nuk ka nevojë të fokusohet në të ashtuquajturën shkencë e lartë por në praktikë të mirë. Mësimdhënia duhet të jetë e orientuar më shumë në praktikë dhe e hartuar në mënyrë të atillë që në rend të parë t'i pajis studentët me aftësi që nevojiten në vend të punës, qoftë në Kosovë apo jashtë saj. Kjo gjithashtu do të haptë rrugën punësimit të shumë profesionistëve që të vijnë në mësimdhënie me gjysmë orari. Ardhja e tyre gjithashtu do të ishte një tërheqje shtesë për studentët që punojnë të cilët kërkojnë zhvillimin e shkathtësive të tyre praktike.
14. Praktikrat e mësimdhënies. Duhet të ndryshohet praktika e mësimt: (a) pjesë-marrja në ligjërata të bëhet e obligueshme, (b) më shumë detyra, punime dhe kol-

- lokfiume, (c) përqendrim në aftësi kundrejt mësimit përmendsh, (d) të ulet mesatarja e viteve që duhen për diplomim, (e) të promovojë mësimsdhënien dhe përdorimin e teknologjisë informative.
15. Pagesa nuk duhet të bëhet për vit por për lëndë (sipas kredive). Pasi që vetë-financimi ka hyrë si praktikë, tani duhet që pagesa të bëhet sipas lëndëve që do të mundësonte studimet me ngarkesë jo të plotë.
 16. Qendra për Mësimdhënie dhe Studime të Përsosura duhet të bëhet funksionale dhe pjesëmarrja e profesorëve në modulet e kësaj qendre duhet të jetë e obligueshme. Universitetet Private duhet të përpiqen që të krijojnë një qendër të përbashkët për këtë qëllim.
 17. Institucionet private duhet të themelojnë një Asociacion të Institucioneve Private të Arsimit të Lartë. Kjo do t'u mundësonte atyre që të bashkojnë forcat në: (a) vlerësimin e zhvillimin e tregut të punës, (b) të organizojnë një panair të punës, (c) Të themelojnë një bibliotekë të përbashkët të cilën do të mund ta shfrytëzonin të gjithë në mënyrë që t'i bëjnë investimet e tyre më të arsyeshme, veçanërisht nëse kjo do të bëhej për një bibliotekë elektronike.
 18. Të rritet numri i të regjistruarve dhe mbledhja e taksave. Të sjellet një numër i elementëve që do të mund të inkurajonin pjesëmarrjen e më shumë studentëve: ligjërata gjatë mbrëmjeve të përshtatshme për studentët që punojnë, data fleksibile të fillimit të studimeve (dth. studentët mund të fillojnë studimet e tyre në vjeshtë dhe në pranverë, dhe të fillojnë lëndët verore si mënyrë për të shfrytëzuar racionalisht lokalet si dhe mundësi për të përcjellë lëndë nga ata që punojnë. Gjithashtu studentëve duhet t'ju mundësohet të punojnë në institucion, gjë që e ul çmimin e shkollimit dhe në të njëjtën kohë, institucioni do të ketë nevojë për më pak personel me pagesë.

Bibliografia

Librat:

- José Joaquín Brunner. 1999. Higher Education: Policy Design and System Management. [Arsimi i lartë: Hartimi i politikave dhe menagjimi i sistemit], http://mt.edu-carchile.cl/archives/HE_Bulgaria_1999.PDF
- Koliqi, Hajrullah. 1995. *Mbijetesa e Universitetit të Prishtinës 1991-1994*. Prishtinë, Kosovë: Universiteti i Prishtinës.
- Milanovic, Vujadin. 1995. *Mbijetesa e Universitetit të Prishtinës 1991-1994* (cituar në Hajrullah Koliqi). Prishtinë, Kosovë: Universiteti i Prishtinës.
- Victorian Departement of Education. 1998. *Learning Technologies in Victorian Schools, 1998-2001*. [Mësimi i teknikave në shkollat viktoriane, 1998-2001]. Melburn: Victorian Department of Education.

Gazetat:

- Berisha, Shqipe. 2005. "Si do të jetë participimi në UP?". *Bota Sot*, 23 nëntor.
- Eddy, Kester. 2006. "Enthusiasm varies across eastern Europe". [Entuziazmi ndryshon përgjatë Evropës lindore]. *Financial Time*, 11 shtator.
- Epoka e re*. 2005. "Rektorati paralajmëron masa ndaj profesorëve me shumë vende pune". 26 dhjetor.
- Filipaj, Gjergj. 2003. Statuti i Universitetit vlerësohet si i keq. *Koha Ditore*. 23 shtator.
- Hasani, Enver. 2006. "S'ka profesorë me dy punë" *Express*. 2 korrik.
- Hoxha, M. 2006. "Thellohet bashkëpunimi, por dipomat e UP-së ende nuk njihen". *Bota Sot*, 16 shkurt.
- Kadriu A, E. Gojnovci. 2006. "UP-në do ta kthej aty ku e ka vendin" [Intervistë me Enver Hasanin] *Lajm Plus*, 5 gusht
- Kadriu, Mustafa, B. 2006. "Injorimi dhe papërgjegjësia ne universitetin publik". *Lajm Ekskluzive*, 11 janar.
- Kadriu, Anita. 2005. "Profesori dënohet në minutën e 16-të". *Lajm ekskluzive*. 22 dhjetor.
- Kadriu, Anita. 2006. "Diploma e përgatitjes së çoroditur". *Lajm Ekskluzive*, 06 janar..
- Kadriu. Anita. 2006. "Fundi i akademizmit, fillimi i politizimit". *Lajm ekskluzive*. 15 shkurt 2006.
- Kupina, Bekim. 2005. Uversiteti në kërkim të identitetit të humbur". *Koha Ditore*. 14 shkurt.
- Kupina, Bekim. 2006. MASHT-i pret që zyrat diplomatike t'ia sjellin ekspertët!. *Koha Ditore*. 12 shkurt.
- Llapshatica, Jeton. 2005. "U vihat Dryni?". *Express*, 17 nëntor.
- Rexha, Valentina. 2005. "IAP në duart e Veliut". *Kosova Sot*, 25 nëntor.
- Rexha. Valentina. 2005. "Mentaliteti, pengon reformat në arsim". *Kosova sot*. 31 dhjetor 2005, 01, 02,03 janar 2006.
- Rexha. Valentina. 2005. "Një profesor në katër institucione". *Kosova Sot*. 22-23 tetor.

- Shala, Leonora. 2005. "Studentët, në vitin e ri me lidhshëm të moqëm". *Focus*, 23 dhjetor.
- Surroi, Flaka. 2006. "Saga për UP-në – pjesa dytë". *Koha Ditore*, 13 maj.
- The Economist. 2005. "Blowing hot and cold [Fryn nxehtë, fryn ftohtë]". 3 dhjetor.
- Veliu, Agim. 2006. "Kosova ka vetëm një ardhmëri: Universitetin e Prishtinës dhe pavarësinë e vendit". *Koha Ditore*, 08 janar.
- Veliu, Agim. 2006. "Universiteti i katandisur". *Lajm Ekskluzive*, 7 janar.
- Veseli, Blerina. 2006. "S'ka internet në Kosovë, s'iu duhet profesorëve". *Epoka e Re*, 17 janar.
- Zeneli, Bernard. 2003. "Ku dhemb dhëmbi do shkojë gjuha: apo do i prishim dhëmbët që të dhembë gjuha". *Java*, 25 dhjetor.

Revistat periodike:

- Gazeta Zyrtare. 1969. Ligji mbi Themelimin e Universitetit të Prishtinës. Gazeta Zyrtare e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Nr. 33, Prishtinë (XXIV).
- Gerstner, Louis V. Dhjetor 2005 – janar 2006. "Sputnik Was Nothing". ["Sputnik nuk ishte asgjë"]. *Newsweek* botim i veçantë.
- Ladd, Helen and Edward B. Fiske. Korrik 2001. "Does Competition Generate Better Schools? Evidence from New Zealand". ["A prodhon konkurrenca shkolla më të mira? Rasti i Zelandës së Re"]. Terry Sanford Institute of Public Policy, Duke University, Working Papers Series SAN01-16.
- Leutloff, Carolin and Elmar Pichl. 1999. The State of Education in Kosovo after the Cease-fire in June 1999. [Gjendja në arsimin e Kosovës pas mbarimit të konfliktit në qershor të vitit 1999].
- Loong, Lee Hsien. Dhjetor 2005 – janar 2006. "The Singapore Way". ["Mënyra e veprimit të Singaporit"]. *Newsweek* botim i veçantë.
- Mason, Terrence C. 2005. "Building Citizenship in the Midst of Ethnic Conflict". [Krijimi i qytetarisë në mes të konfliktit etnik]. *Democracy At Large*, Vol. 1, Nr. 4.
- Moreau, Ron and Sumeet Chatterjee. dhjetor 2005 – janar 2006. "The Unemployable Masses [Masat e papunësuar]". *Newsweek* botim i veçantë.
- Schleicher, Andreas. Dhjetor 2005 – janar 2006. "A Classless Act [Një ligj pa klasa]". *Newsweek* botim i veçantë.
- Schwab, Klaus. Dhjetor 2005 – janar 2006. "The Tipping Point [Pika e vlimi]". [Newsweek botim i veçantë].
- Strauss-Kahn, Dominique. Dhjetor 2005 – janar 2006. "On a Modern Path [Në rrugë moderne]". *Newsweek* botim i veçantë.
- Taylor, Peter G. 1999. "Information Technology Skills Development and the New Problematic". [Zhvillimi i aftësive të teknologjisë informative dhe problematikat e reja] *Pedagogy, Culture & Society*, Vol. 7, Nr. 1.

Raportet:

- Enti i Statistikave të Kosovës. 2005. Statistikat e Arsimit të lartë në Kosovë 2002-2003, <http://www.ks.gov.net/esk/esk/pdf/shqip/sociale / Statistikat Arsimit 02 03 .pdf> (qasur me 11 shkurt 2006).
- Iniciativa Evropiane për Stabilitet (ESI). 2006. Cutting the lifeline: Migration, Families and the Future of Kosovo. [Këputja e “idares”: Migrimi, familjet dhe e ardhmja e Kosovës], www.esiweb.org
- Asociacioni i Universitetit Evropian. 2002. University of Mitrovica [Universiteti i Mitrovicës]. Raporti i EUA-së, 10-13 dhjetor 2002, http://www.see-educoop.net/education_in/pdf/uni_mitrovica_report_eua-kos-enl-t05.pdf
- Gashi, Krenar dhe Zana Limani. 2006. “In depth: Pristina University Stumbles Deeper into Crisis”. [Universiteti i Prishtinës zhytet edhe me thellë në krizë]. BIRN, Balkan Investigative Reporting Network, Balkan Insight, http://www.birn.eu.com/insight_38_7_eng.php (qasur me: 9 qershor 2006)
- ICG. 2006. “Kosovo the Challenge of Transition”. [“Kosova sfida e tranzicionit”]. Raport për Evropë Nr.170 http://www.crisisgroup.org/library/documents/europe/balkans/170_kosovo_the_challenge_of_transition.pdf (qasur me 24 shkurt 2006).
- IKS. 2006, 6 shkurt, “takim me Fehmi Krasniqin –arsimi privat”.
- Irwin, Colin. ““Coming to Terms with the Problem of Kosovo: The Peoples’ Views from Kosovo and Serbia [Duke u ballafaquar me problemin e Kosovës: Këndvështrimet e njerëzve në Kosovë dhe Serbi]”. [Raport] http://www.cdsee.org/pdf/kosovo_serbia_short_report.pdf
- Hyseni, H, J. Salihaj, D. Pupovci, B. Shatri, F. Bylykbashi, Q. Hoxha. 2002. Disa aspekte të efikasitetit në arsimin e Kosovës. Prishtinë, Kosovë: KEC, <http://kec-ks.org/botimet.htm> (qasur me 22 dhjetor 2005).
- MASHT. 2004. Strategjia e Zhvillimit të Arsimit të Lartë në Kosovë.
- MEF. 2005. Buxheti i vitit 2005.
- Observatoriumi i Kosovës për Punësim dhe Aftësi. 2004. “Në rrjedha me Evropën: strategjia për arsimimin e të rriturve në Kosovë (2005-2015)”.
- Finlandë, Ministria e Arsimit. 2001. “An International Strategy for Higher Education”, [Strategjia ndërkombëtare për arsimin e lartë] http://www.minedu.fi/export/sites/default/OPM/Julkaisut/2001/liitteet/opm_511_strategy.pdf (qasur me 28 korrik 2005)
- Peffer, Jack, Euan Reid, Fani Stylianidou, Paddy Walsh and Micheal Young, 2005 - 22 korrik. “The National Curriculum in Kosova – a review of its first steps” [Planprogrami i Kosovës – pasqyrë mbi hapat e parë]. London: Institute of Education, University of London.
- Qeveria e Kosovës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Prill 2004. “Raporti vjetor mbi Punën dhe Punësimin – 2003” (draft).
- Qeveria e Kosovës, Ministria e ekonomisë dhe Financave. 2005. Buxheti vjetor 2005, <http://www.mfe-ks.org/English/mefwww/lajmet/FinancialStatements2005.pdf>

- United Nations Development Programme. 2002. Human Development Report 2002 [Raporti i zhvillimit njerëzor 2002]. United Nations Development Programme: Prishtinë, Kosovë.
- United Nations Development Programme. Human Development Report 2004 [Raporti i zhvillimit njerëzor 2004]. United Nations Development Programme: Prishtinë, Kosovë.
- Learning Technologies in Victorian Schools [Teknologjitë e Mësimi në Shkollat Viktoriane], 1998-2001, 1998: 8).

Intervistat personale:

- Dedaj, But (Drejtor i WUS-it). Intervistë personale. 21 nëntor 2005, Prishtinë, Kosovë.
- Dedushaj, Isuf (Dekan i fakultetit të mjekësisë). Intervistë personale. 20 korrik 2006, Prishtinë, Kosovë.
- Dika, Artan (Kirurg nga Shkupi). Intervistë personale. 16 janar 2006, Prishtinë.
- Dugolli, Ilir (Ligjërues në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Prishtinës). Intervistë personale. 13 shkurt 2006, Prishtinë.
- Ejupi, Burim (Student i studimeve postdiplomike në UBT). Intervistë personale. 13 dhjetor 2005, Prishtinë, Kosovë.
- Elezaj, Isa. Intervistë personale. 03 korrik 2006, Prishtinë, Kosovë.
- Fetahu, Skënder (Kryetar i Organizatës së Re Studentore, ORS). Intervistë personale. 21 nëntor 2005, Prishtinë, Kosovë.
- Gashi, Edmond (Kryetar i Asociacionit të Studentëve të Shkencave Politike). Intervistë personale. 22 nëntor 2005, Prishtinë, Kosovë.
- Gashi, Ibrahim (Shef i Departamentit të Shkencave Politike në Universitetin e Prishtinës). Intervistë personale. 11 nëntor 2005, Prishtinë, Kosovë.
- Gashi, Yll (Student në FAMA). Intervistë personale. 11 nëntor 2005, Prishtinë, Kosovë.
- Hoxha, Sejdi (Kryetar i Unionit të Pavarur të Studentëve të UP-së, UPS). Intervistë personale. 21 nëntor 2005, Prishtinë, Kosovë.
- Ilazi, Besim. (Profesor i Elektros). Intervistë personale. 24 shkurt 2006, Prishtinë, Kosovë.
- Osmani, Liridon (Student në Fakultetin e Gazetarisë Faik Konica). Intervistë personale. 19 tetor 2005, Prishtinë, Kosovë.
- R. B. (Student në Universitetin DARDANIA). Intervistë personale. 27 shtator 2005, Prishtinë, Kosovë.
- Rexhaj, Xhavit (Drejtor i Departamentit të Edukimit). Intervistë personale. 17 nëntor 2005, Prishtinë, Kosovë.
- Salihu, Florentina (Studente në Rezonancë). Intervistë personale. 21 nëntor 2005, Prishtinë, Kosovë.
- Tahiri, Lindita (Koordinatorë e TEMPUS-it). Intervistë personale. 23 nëntor 2005, Prishtinë, Kosovë.
- Thaci, Jusuf (Kryetar i Asociacionit të Studentëve të Psikologjisë në Universitetin e Prishtinës). Intervistë personale. 22 nëntor 2005, Prishtinë, Kosovë.

Tjera:

Qendra Evropiane e Arsimit të Lartë. Statistical Information on Higher Education in Central and Eastern Europe 2003-2004,

http://www.cepes.ro/information_services/statistics_04.htm

Komisioni Evropian. 2004 dhjetor. Projects in Economics of education [Projekte në ekonomi të arsimit], Vëll. 1/6.

www.uam.es/europea/financiacion%20educ.%20superior.volumen1.pdf

shkruar nga European Research – Associates (EU-RA)

European Council. 2000. Presidency conclusions of Lisbon European Council,

http://www.europarl.eu.int/summits/lis1_en.htm

UNESCO. 1979. The Convention on the Recognition of Studies, Diplomas and Degrees concerning Higher Education in the States belonging to the Europe Region.

Para. 9 of the Preamble of Treaty of Rome [Konventa mbi njohjen e studimeve, diplomave dhe titujve që kanë të bëjnë me arsimin e lartë në shtetet e regjionit të Evropës. Paragrafi 9 i Preambulës së Traktatit të Romës],

http://europa.eu.int/eurlex/pri/en/oj/dat/2002/c_325/c_32520021224en00010184.pdf

UNESCO. 2005. Arsimim për të gjithë (EFA) Raporti i Monorimit Global,

[http://portal.unesco.org/education/en/ev.php-](http://portal.unesco.org/education/en/ev.php-URL_ID=35939&URL_DO=DO_TOPIC&URL_SECTION=201.html)

[URL_ID=35939&URL_DO=DO_TOPIC&URL_SECTION=201.html](http://portal.unesco.org/education/en/ev.php-URL_ID=35939&URL_DO=DO_TOPIC&URL_SECTION=201.html)

Byroja e Regjistrimit e SHBA-ve. 2005. IDB Summary Demographic Data, <http://www.census.gov/ipc/www/idbsum.html> (qasur me: 03 shkurt 2006)

Kajsiu, Blendi. "Teza për një Reformë të Djathtë në Universitetet Publike" (dorëshkrim).

Katalogimi në publikim - (CIP)
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

378.4.014(496.51)

Qeverisja dhe konkurrenca në arsimin e lartë / Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave. -Prishtinë : KIPRED, 2007. - IV, 83 f. ; 21 cm. - (Seria e kërkimeve politike : STUDIMI ; 7)

Bibliografia : f. 78-82

ISBN 978-9951-14-026-3

Për KIPRED-in

Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave ka për qëllim të përkrahë vlerat demokratike në Kosovë përmes trajnimeve dhe analizave të pavarura të politikave publike.

Trajnimet kryesisht fokusohen në zhvillimin e partive politike përmes Internet Akademisë për Demokraci, e zhvilluar në bashkëpunim me Qendrën Ndërkombëtare Olof Palme nga Suedia.

Kërkimet fokusohen në botimin e analizave të pavarura në fusha si qeverisja e mirë, administrata, zhvillimi i partive politike, bashkëpunimi rajonal, politika ekonomike dhe qeverisja lokale.

KIPRED-i financohet nga fondacioni suedez “Olof Palme International Center” dhe nga fondacioni amerikan “Rockefeller Brother’s Fund”.
KIPRED

Kodra e Diellit, Rr. III, Ll. 39
Prishtinë, Kosovë (UNMIK)
Tel/Fax: +381 (0) 38 555 887
Info: info@kipred.net
www.kipred.net

Përkrahur nga:



Rockefeller
Brothers Fund
Philanthropy for an Interdependent World